**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Kuvendi i Komunës Rahovec***
*Skupština Opština Rahovac/Municipality of Rahovec*

**01 Nr. 04/25**
**Rahovec, 18.4.2025**

Ftohen anëtarët e Kuvendit Komunal që të marrin pjesë në mbledhjen e **katërt (4),** e cila do të mbahet më **29 prill 2025 (e martë),** me fillim në orën **10:00**, në sallën e KK Rahovec.

Për këtë mbledhje, propozoj këtë:

**R E N D  D I T E**

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Pyetjet, përgjigjet dhe diskutimet e kuvendarëve;
3. Shqyrtimi i raportit financiar, janar – mars 2025;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i draft-rregullores për transparencë në Komunën e Rahovecit;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për caktimin e komisionit për përzgjedhjen e drejtorit/eshës dhe zëvendësdrejtorit/eshës së institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese të arsimit parauniversitar (IEAA-AP);
6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale, P-08152-0, ZK-Rahovec;
7. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale, P-08152-0, ZK-Rahovec;
8. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për dhënien e pëlqimit për dhënie të pronës me qira, P-01496-0, ZK-Retijë;
9. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për formim të komisionit për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale, P-01496-0, ZK-Retijë;
10. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për shpallje me interes të përgjithshëm publik, P-08994-0, ZK-Rahovec;
11. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për konstituimin e të drejtës së kalimit (servitutit sendor);
12. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë (99) vite të pronës komunale stacionit policor në Rahovec;
13. Shqyrtimi dhe miratimi i vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për nevojat e Agjencionit të Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV);
14. Shqyrtimi i informatës mbi implementimin e projektit të mirëmbajtjes dimërore dhe verore të rrugëve në Komunën e Rahovecit, për vitin 2024-2025.

**KRYESUESI I KUVENDIT**

**Arbër Zenuni**

# PROCESVERBAL

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më **28.03.2025,** me fillim në orën **10:00.** Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit, **z. Arbër Zenuni**. Në fillim kryesuesi konstatoi se kuorumi për mbajtjen e mbledhjes ekziston. Në fillim të mbledhjes, nga 31 anëtarë, të pranishëm kanë qenë 23.

**Kryesuesi: Fillimisht,** ju lus për një minutë heshtje për të gjithë të rënët për liri... Lavdi! Përshëndetje për të gjithë! I nderuar Kryetar i Komunës, **z. Smajl Latifi**, Nënkryetar **z. Fatmir Iska**, të nderuar anëtarë të Kuvendit Komunal, drejtorë të drejtorive komunale, zyrtarë komunalë, përfaqësues të KFOR-it, medie, të nderuar qytetarë të komunës së Rahovecit. Për këtë mbledhje të **tretë** me radhë të vitit 2025, së bashku me kryetarin, kemi vendosur për këtë rend dite:

## REND DITE

1. **Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
2. **Pyetjet, përgjigjet dhe diskutimet e kuvendarëve;**
3. **Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për themelimin e Muzeut Etnografik në Drenoc;**
4. **Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga viti 2023 dhe 2024 në vitin 2025;**
5. **Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për miratimin e vendimit paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatshkurtër personave fizik dhe juridik, P- 00320-0 ZK-Radoste;**
6. **Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës P-00320-0 ZK-Radoste;**
7. **Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për dhënien e pëlqimit paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës personave fizik dhe juridik, P- 02240-81 ZK-Rahovec;**
8. **Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës P-02240-81-0 ZK-Rahovec;**
9. **Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për miratimin e vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për nevojat e Agjencionit të Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV);**
10. **Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për shpalljen me interesi të përgjithshëm publik të parcelës P-71510057-00095-6 në Zonën Kadastrale Rahovec;**
11. **Shqyrtimi i informatës mbi listën e pronave komunale dhe menaxhimin e tyre;**
12. **Shqyrtimi i informatës rreth menaxhimit të aseteve komunale;**
13. **Shqyrtimi i informatës rreth hotel "Park plaza" - Rahovec;**
14. **Shqyrtimi i raportit rreth fatkeqësive natyrore për vitin 2024.**

**Shtesë: Vendimi për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës – Hotel, Park Plaza.**

**Kryesuesi:** Të nderuar anëtarë të kuvendit, ju informoj që pika e 13-të, ndryshohet dhe bëhet: **Vendim për dhënien e pëlqimit për hotelin Park Plaza.** Gjithashtu edhe pika e 14-të, ndryshohet dhe bëhet: **Miratimin e raportit të komisionit komunal të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrëre dhe fatkeqësitë tjera.** Të nderuar anëtarë, i kemi edhe dy pika shtesë: Pika e parë ka të bëjë me Rregulloren për Transparencë në Komunën e Rahovecit dhe pika e dytë është vendimi për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës – Hotel, Park Plaza.
**Nënkryetari:** Faleminderit i nderuar kryesues! Rregulloren për Transparencë për Komunën e Rahovecit, po e tërheqim dhe po e bartim për seancën e muajit prill.
**Kryesuesi:** Faleminderit nënkryetar! Atëherë, e vendosim në votim vetëm pikën e dytë shtesë. Kush është "për"?... Kundër?... Votohet unanimisht (23) pika shtesë. Tani e vendosim në votim rendin e ditës të plotë. Kush është "për"?... Kundër?... Votohet unanimisht (23) rendi i ditës për seancën e sotme.

**1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar:**

Kryesuesi: A ka dikush ndonjë vërejtje rreth procesverbalit nga mbledhja e kaluar? Nëse jo, e vendosim në votim. Kush është "për"?... Kundër?... Unanimisht votohet pika e parë e rendit të ditës.

**2. Pyetjet, përgjigjet dhe diskutimet e kuvendarëve:**

**Vlora Vuçiterna – Çmega:** Përshëndetje për të gjithë! I nderuar kryetar, nënkryetar, kryesues, drejtorë të drejtorive, asambleistë, media. Unë zakonisht nuk dal këtu në foltore, por sot vendosa të dal, sepse është një arsye më ndryshe. Meqenëse ia nisëm me dhurata, po e vazhdojmë njëjtë. E kam një dhuratë të vogël për Drejtorinë e Shëndetësisë. Është një dhuratë e cila nuk ka vlerë të madhe, 25-30€, por meqenëse Drejtoria e Shëndetësisë e kishte të pamundur që këtë ta ndante nga buxheti për QKMF-në, vendosa ta dhuroj unë. Pas reagimeve të fundit që i kemi pasur në rrjete sociale me QKMF-në, supozoj që drejtori i QKMF-së nuk do ta pranonte dhe unë po ia dhuroj drejtoreshës së Shëndetësisë. Dhurata është aparat inhalator, i cili duhet të vendoset në dhomën e veçantë për fëmijë dhe mundësisht kohë pas kohe të ndërrohet pjesët, ashtu siç e do edhe procesi i inhalimit. Meqenëse jam këtu, një pyetje tjetër e kam edhe për drejtorin e Arsimit: Drejtor, sa jeni duke mbajtur takime me mësimdhënëse nëpër shkolla? Kohëve të fundit kam pranuar disa mesazhe nga disa mësimdhënës, që kanë dhunë psiqike nga drejtori. Po e citoj njërin nga mesazhet: " E nderuar, shpresoj që jeni mirë. Jam mësimdhënëse në njërën nga shkollat e komunës sonë. Shumë mirë që po e ngrisni zërin për keqmenaxhimin në shëndetësi, kërkoj nga ju që të dukeni pak edhe në shkolla, meqenëse edhe në arsim ka keqmenaxhime. Në shkollën (nuk e potencoj) drejtori ushtron dhunë psiqike ndaj mësimdhënësve. Drejtor, kërkoj nga ju që ta hulumtoni këtë gjë!
**Sejfullah Sejfullahu:** Faleminderit kryesues Arbër Zenuni! Përshëndetje kryetar, nënkryetar, drejtorë, kolegë asambleistë, vëzhgues. Pyetje për Drejtorinë e Arsimit. Drejtor, në mbledhjen e fundit të këshillit të shkollës, drejtori në Krush të Madhe u ankua për çështjen e buxhetit. Është shqetësuese, sepse pothuajse buxheti ishte i njëjtë sikur për një fshat me 1 mijë banor, sikur për një fshat me 6 mijë banorë. Një kërkesë tjetër që e kam përmendur disa herë është edhe instalimi i kamerave në shkollë. Te Drejtoria e Shëndetësisë: Atë ditë që ishim për të dhuruar gjak, e vërejta që renovimin që e kanë bërë menjëherë ka filluar të dëmtohet dhe nuk e di nëse ka garancion. I kemi bërë disa fotografi, të cilat nuk i kemi publikuar sepse kam dashur t'i them këtu. Është mirë që ftohet operatori për sanim, sa nuk është dëmtuar më shumë. Për Drejtorinë e Shëndetësisë, kam edhe një kërkesë të veçantë: të shikoni mundësinë për vendosjen e pemëve dhe luleve në hapësirën përreth QKMF-së, sepse aty punojnë motra dhe mjekë, si dhe është një vend që duhet të jetë i rregulluar dhe i këndshëm për të gjithë, ashtu siç do ta kishte bërë edhe Fahredin Hoti.
Nëse nuk ka mundësi financiare, atëherë le të mblidhemi vetë dhe t'i rregullojmë ato hapësira. Mendoj që për këtë gjë, dikush është i ngarkuar me tender dhe duhet ta bëjë.

**Burim Krasniqi:** Përshëndetje për kryetarin, për ekzekutivin, për kryesuesin e kuvendit, kolegët asamblistë dhe qytetarët. Unë kam disa pyetje, dy prej të cilave janë përsëritur disa herë prej seancave të kaluara. Një ka të bëjë me kontratën për furnizim me pelet për shkolla, për shkak të çmimit të lartë.
Po ashtu, për tri kontratat që janë përmendur disa herë në këtë kuvend – nga auditimi del se operatorët që kanë fituar kontratat, kanë marrë vetëm 20% të pikëve përmes planit dinamik.
Kërkoj nga ju që të bëhen publike kontratat, të hyhet në faqen e prokurimit dhe të shihet sa janë vlerësuar këta operatorë. Në fund të kontratave thuhet që kanë fituar me bazë vetëm 20% të pikëve përmes planin dinamik. Nëse ka qenë kriter, atëherë le të jepet publikisht edhe pse është kështu?!
Kryetar, drejtorë – kërkoj nga ju këtë informacion më të detajuar. Nuk mendoj që është sekret. Për sheshin qëndror, kemi folur më herët. Në formë vizuele e kemi parë pak projektin, shumë i betonuar drejtror. Kurdo që e vlerësoni, të kërkoj zyrtarisht që të kem çasje në dokumente zyrtare dhe ta kemi në CD projektin e sheshit, që ta shoh realist se cili është projekti i sheshit qëndror në qytetin e Rahovecit.
**Melinda Oruqi Iska:** Faleminderit kryesues! Përshëndetje për ju, për kryetarin, nënkryetarin, drejtorët e drejtorive, kolegët asamblistë, si dhe për të gjithë të pranishmit në sallë. Unë kam një pyetje për drejtorin e Shërbimeve Publike. Drejtor, nuk e di se sa herë është që kam kërkuar nga ju, që të rregullohet rruga "Xhafer Nurkasa". Jo vetëm që nuk është rregulluar, por as përgjigje nuk kam marrë. Bëj thirrje për mediat, sidomos për "Rahovec n'Fokus", që ta publikojnë një video, për të treguar gjendjen reale të asaj rruge, sepse më shumë po i jepni rëndësi "Rahovec nFokusit" sesa këtij kuvendi. Po ashtu, te e njëjta rrugë, "Xhafer Nërkasa", pranë shkollës "Isa Boletini", është vendosur një shenjë për rrugë njëkahëshe. Tani ajo shenjë është hequr – nuk e di nga kush, por shenja e komunikacionit që tregon për rrugën një kahëshe, tani nuk ekziston. Automjetet po parkohen dhe nuk po respektohet njëkahshmëria e rrugës, duke rrezikuar jetën e nxënësve që frekuentojnë shkollën. Një pyetje për drejtorin e Arsimit. Cila është gjendja në çerdhen "Tulipanët", sepse gjysma e stafit po vjen nga ora 07:00 deri në 11:00 në punë, e gjysma tjetër nga 11:00 deri në 16:00, ndërsa të gjithë marrin pagë të plotë? Nëse ekziston ndonjë ligj ose nen që e lejon këtë gjë, na tregoni edhe neve, sepse në QKMF jemi të stërmbushur me punëtorë, ndoshta edhe ne të shkojmë vetëm 4 orë në punë.
**Burim Krasniqi:** Kryesues, unë dua të propozoj që në një nga seancat e ardhshme të hartojmë një rregullore komunale për komunikim publikun në Komunën e Rahovecit, që i përfshin edhe këshillat e fshatrave dhe i bashkon të gjitha praktikat dhe standardet e komunikimit që kemi deri tani. Kemi pasur praktika që kur e ka përfunduar një drejtori, nuk e ka dorëzuar fejsbukun e drejtorisë te drejtori pasues. Ka këshill të fshatrave qe e ka pasur një faqe në emër të këshillit të fshatit dhe kur e ka përfunduar mandatin, faqen e njëjtë nuk e ka dorëzuar kryetarit tjetër. Pra, rrjetet sociale të dorëzohen prej mandatit në mandat, të barten në mënyrë ligjore te personi tjetër përgjegjës dhe jo të ndodh që të fshihet kur të përfundon mandati. Propozoj te sekretaria, që ta kemi një rregullore të tillë, para se të përfundojë ky legjislacion.
**Merisa Sharku:** Përshëndetje për të gjithë! Në Rahovec është një numër i madh i personave me probleme mendore dhe dita e ditës ata po bëhen më agresivë. Këta janë problem dhe rrezik për qytatarët dhe sidomos për fëmijët, të cilët e frekuentojnë shkollën, apo edhe luajnë në lagjet e tyre. Është mirë të kontaktoni me QPS-në apo me organet kompetente dhe të bëni zgjidhj, që këta persona të vendosen në strehimore. Dikush duhet t'i trajtojë këta persona që mos të bredhin rrugëve dhe të shfaqin rrezik për qytetarët e Rahovecit.
**Defrim Kafexhiu:** Përshëndetje për të gjithë! I nderuar nënkryetar, kryesues, drejtorë, kolegë anëtarë të kuvendit komunal, përfaqësues të LMT-së, media. Në seancën e kaluar, pavarësisht debatit që është bërë, nuk doja ta komentoja rezultatin e zgjedhjeve të kaluara nacionale. Në këtë seancë është e pashmangshme që t'i vazhdoj disa diskutime që kanë ndodh në seancën e kaluar, duke marrë parasysh që po shkelet një e drejtë e një anëtari të kuvendit – e një përfaqësuesi të qytetarëve që kryetari e ka zakon t'i thotë: "e ka një grusht vota". Ky "grusht votash" mjafton që ta shpërfaq qasjen e juaj diktate ndaj çdo institucioni tjetër, por edhe ndaj qytetarëve të komunës së Rahovecit. Përmes kryesuesit, i cili pashmangshëm gjatë seancave bie pre e ndikimit të kryetarit. Në seancën e kaluar, kryetari dhe

kryesuesi nuk ma dhanë një të drejtë, sikurse në shumë seanca të tjera. Kjo është duke ndodhur që një kohë të gjatë, qysh nga shkarkimi im prej pozitës së kryesuesit. Nëse ekzekutivi dhe kryesuesi i ri, e kanë lexuar rregullore, aty e shohin se si e kanë të përcaktuar formën e organizimit të seancës së kuvendit komunal dhe ndarjen e minutazhës. Në këtë seancë dua t'i kërkoj kryetarit, i cili deri sa nuk e ka parë rezultatin e këtyre zgjedhjeve, nuk e ka besuar që opozita mund ta dëmtojë elektoralisht. Kryetari i komunës nuk e ka besuar që drejtorat e dënuar prej gjykatave mund ta dëmtojnë atë elektoralisht. Ai më thoshte që "ju me këtë politikë nuk mund të shkoni as deri te rrasat". Meqenëse kryetari nuk është aty, dëshiroj ta pyes nënkryetarin, a jeni të tretit apo të katërtit, pas certifikimit të rezultatit në komunën e Rahovecit? Nëse kryetari mendon t'ia ndalë fjalën dikujt në këtë formë, paramendoni çfarë qasje mund të ketë me një qytetar të thjeshtë. Kjo formë është e rrezikshme. E ftoj kryesuesin që mos të bie pre e kryetarit në organizimin e seancave. Në momentin kur një anëtar i kuvendit e ka replikën, nuk mund t'i mohohet. Nuk është debat, që vetëm nëse mundem, nuk ia jap fjalën dhe në anën tjetër e kam fituar debatin. Debatet mund t'i fitoni, por zgjedhjet dyshoj që në këtë form mund t'i fitoni. Besoj që do të shihemi përsëri nëpër zgjdhje dhe nëpër sfida të tjera dhe do t'i shohim rezultatet, në bazë të kësaj politike që është duke e zhvilluar Smajl Latifi.
**Lirigzon Kastrati:** Faleminderit kryesues! Të nderuar anëtarë të ekzekutivit, kolegë anëtarët ë kuvendit të komunës, media, qytetarë. Gjithashtu, në këtë seancë dua të flas për rin-destinimin e një rruge. Kjo rrugë shkon deri te stacioni i autobusëve dhe është quajtur Ibrahim Rugova, propozoj që emri "Ibrahim Rugova" të mbetet për këtë rrugë, pasi ka lidhje me historinë dhe figurën përkatëse. Po ashtu, komuna ka vazhduar me aktivitete të qështjeve të rrugëve fushore, mirëpo ende nuk ka ndërmarrë hapa konkretë në fshatin Hoçë e Vogël dhe në fshatin Brestoc. Dua të di nga ekzekutivi: a ka ndonjë plan për rregullimin e rrugës zonëa operative Pashtriku, që lidh fshatin Hoçë e Vogël me Retijë? A është planifikuar që kjo rrugë të rregullohet, qoftë edhe me zhavorr ose siç është paraparë në plan?
**Hasan Përboqi:** Faleminderit kryesues, përshëndetje kryetar, kolegë asamblistë, drejtorë të drejtorive, ju monitorues të kësaj seance, media të pranishme. Unë e mora fjalën, sepse më shqetësuan disa diskutime që u bënë më herët. E mora fjalën gjithashtu për të sqaruar dhe relativizuar pak situatën, por edhe për të bërë një pyetje. Po jetojmë në të njëjtën planet, në të njëjtin realitet sikurse ju, sepse ndonjëherë nga mënyra si diskutoni duket sikur nuk jemi në të njëjtin vend. Disa nga kritikat që u drejtuan ndaj ekzekutivit ishin krejtësisht të pabazuara. Po krijohet një përshtypje sikur në këtë komunë, veçanërisht në këtë qytet, asgjë nuk është bërë ndër vite, veçanërisht prej qeverisjes së Smajl Latifit. Po dëshirojnë ta krijojnë përshtypjen që vetëm këta e paraqesin dritën për qytetarët. Ka njerëz që po e paraqesin veten si shpëtimtar, sikur të gjitha gabimet i kanë bërë të tjerët dhe vetëm ata e kanë zgjidhjen. Në realitet, shumë projekte janë realizuar gjatë këtyre viteve, sidomos gjatë dy mandateve të kryetarit aktual. Edhe pse ka ende nevoja, shumë punë janë bërë e po bëhen. Për shembull, dua të ndalem shkurt te një projekt konkret – website-i i lansuar së fundi nga Drejtoria e Arsimit. Po ndalem këtu, sepse i takoj këtij profesioni dhe besoj që kam të drejtë të flas. Ky është një hap i rëndësishëm drejt digjitalizimit të arsimit, është uebsajti "School me", një proces që duhet të bëhej në nivel shtetëror, por që për shkak të mungesës së iniciativës në nivel qendror, e ka marrë përsipër komuna jonë. Është një uebsajt që ndihmon shumë në përmirësimin e procesit mësimor dhe sidomos në ndihmën për mësimdhënësit dhe për nxënësit. Gjithashtu, dua të theksoj se është në rregull të adresohen kritikat. E kemi sheshin qëndor. Mirë është të ketë debat dhe kritikë konstruktive, por një numër i caktuar i asamblistëve kanë votuar kundër këtij projekti në kohën kur është buxhetuar, ndërsa tani kërkojnë llogaridhënie për një projekt që e kanë kundërshtuar. Kjo nuk është e arsyeshme. I Përmenda vetëm dy projekte, por ka shumë të tjera që janë duke u realizuar, pavarësisht pengesave që ndonjëherë vijnë nga ata që nuk ia duan të mirën qytetit tonë, sipas bindjes sime. Jam i bindur që këto projekte nuk do të ndalen dhe do t'u shërbejnë qytetarëve. Gjithashtu, e dimë që nevojat janë më të mëdha sesa ato që realizohen. Mendoj që me kapacitetet ekzistuese po punojnë për t'i përmbushur këto nevoja. Gjithashtu, besoj që të gjitha zotimet dhe premtimet që janë dhënë do të realizohen dhe ato që nuk mund t'i realizojmë tani, besoj që në mandatin e ri do t'i realizojmë në plotni.

**Burim Krasniqi:** Nuk e di nëse është shkollë politike dhe që funksionon me duartrokitje dhe nuk bën të kritikosh. Kjo nuk funksionin te LDK-ja. Kryetari i LDK-së nëse është, asambleistët e LDK-së nuk e duatrokasin nëse bën punë të këqija. Nëse keni urdhër vetëm të duartrokasim, shprehuni dhe ju bëjmë qejfin. Po flas edhe si inxhinier. Mos harroni që sheshi, nëntokë i ka krejt karrigat e stadiumit, që është shkelje e ligjit mbi mbrojtjen e mjedisit – mbi mbrojtjen e dheut. Aty ka betonë të armuar, gjë që përbën shkelje të ligjit për mbrojtjen e mjedisit dhe tokës. Sa është ruajur balanci ekologjike në këtë rast?
A jemi në qendër të qytetit? A do të urbanizohet qyteti? A e përballon thithjen e gazrave që lirohen në qytet? Sheshi i Tiranës ka marrë çmim kryesor, vetëm përshkak të gjelbrimit që e ka. Ky shesh duhet ta ruajë balancin ekologjik. Nuk janë këto vetëm fraza politike dhe kemi të drejtë ta kërkojmë atë që na duhet. Nuk votoj diçka, të cilit ia keni shtuar buxhetin 3-4 herë dhe keni kërkuar 3-4 herë t'ia ndërroni parcelat dhe i cili nuk ka projekt detal. Po pres të kem qasje në projekt dhe ta dëshmoj që atë që e kam thënë është ashtu siç po them. Nuk qëndron ajo që nëse dikush jep vërejtje, ia don të keqen qytetarëve, jo ia don të mirën dhe kërkon përgjegjësi. D.m.th dikush qenka "delja" e zezë dhe dikush "engjulli" mbrojtës. Pranojeni vëretjen dhe jini më konstruktiv. Të mos lejohet gjuha përtej normales, por për që është 370€ toni i peletitm, këtë e dinë të gjithë dhe në anën tjetër në Gorenje ka pasur ofertë 180€ 2 tonë. Fakti i dytë është që për shkak të kësaj gjendje, të gjitha shkollat janë në krizë financiare dhe nëse prishet një "qeshmë" nuk ka mjetet për ndërrim. Ti je i fushës së arsimit, të paktën këtë duhet ta thuash dhe të pajtohesh që gjendja është keq. Pse janë dhënë tri kontrata 2.5 milionë me 20% të poenave, për shkak të planit dinamik (ai që e kryen më shpejt) dhe në fund është nënshkruar kontrata 3 vjeçare. Këtë e ka auditori të shkuar dhe ose qëndron ashtu, ose auditori ka manipuluar në raport. Nuk është në gjuhë time, por kjo është shkelje e rëndë ligjore. Besoj që dikush duhet të merret seriozisht me këtë çështje. Po e përsëris në fund, nëse ka nevojë të duatrokasim non-stop, LDK-ja sa herë ta merrni fjalën do t'ju duatrokas.
**Hasan Përboqi:** Tani t'i dëgjojmë këtu interpretuesit ligjorë, këta drejtora asnjëri nuk është dashur të jenë këtu, duke përfshirë kryetarin, ndoshta pak nënkryetarin e kanë kursyer. Në çdo seancë, minimum i thuhet një drejtori 2-3 herë, ti je shkelës, ti je hajn (me ndonjë kuptim tjetër). Me i dëgju këta, sot komplet drejtorat nuk është dashur të jenë këtu, por ja që interpretuesit ligjorë dhe ata që marrin vendime të drejta janë tjerët.
**Melinda Oruqi Iska:** Hasan, cilat janë ato kritika të pa baza që i kemi bërë? Nëse don, shkojmë bashkë t'i shohim, nëse janë të pa baza ose të vërteta. Ju jeni për lëvdatë veç që i keni punësuar familjarët, tjetër lëvdatë qeveria juaj nuk ka.
**Defrim Kafexhiu:** Para se ta komentoj këtë që tha Hasani, e kam një pyetje për drejtorin e Arsimit. Drejtor, në institucionet arsimore në komunë të Rahovecit, a është mundësia që dikush të punojë pa kontratë aktive? Qysh e merrë pagën dikush që nuk ka kontratë aktive ose e ka kontratën e skaduar? Për atë që tha Hasani që 12 drejtorat janë këtu. Drejtorat do të jenë këtu deri në fund të mandatit. Këta nuk shkojnë, nuk i marrin në burg, por ndonjë dënim iu japin. Për ata juristat që the nëse marrin vendime të drejta, besoj edhe unë që janë vendime të drejta dhe dy prej tyre i kanë marrë. Drejtorin dhe kryesuesin këtu e ke, por këta e vuajnë dënimin dhe më së shumti e vuani krejt ju bashkë, sikur në zgjedhjet e kaluara që ju pyeta, a dolët të tretit apo të katërtit në zgjedhje? Ky është dëmi, qytetari është bërë jurist sot. Ai ta vlerëson punën, kush punësohet, çfarë vendimet po marrin gjykatat, kush merr pagë pa kontratë në komunë të Rahovecit dhe ata te kutia ju japin dënimin e merituar, se juve nuk ua ndien për vendimet e gjykatës. Nëse po, këto njëmend nuk do të ishin këtu, sepse do të kishin dhënë dorëheqje.
**Hasan Përboqi:** Nuk e pata personale me askënd. Ne i njohim institucionet e drejtësisë. Shkojmë ju përgjigjemi prokurorisë dhe gjykatës, por edhe na takon e drejta ashtu siç e ka paraparë hierarkia e ankimimin në nivele më të larta. Besoj që kjo është e drejtë elementare që i takon çdo qytetari. Në këtë komunë kemi fituar 3 herë në zgjedhje lokale, 2 herë të tjera në zgjedhje qëndrore dhe është bërë "kijamet" që tani kemi dalur në vend të tretë, e as rezultati që na pret.

**Drilon Mustafa:** Përshëndetje kryesues, nënkryetar, drejtorë, të nderuar asamblistë dhe gjithë të pranishëm. Nëse është një një projekt që të gjithë duhet ta duartrokasim, është për sheshin qëndror. Besoj që është një nga sheshet më të mira në Kosovë dhe është një projekt ndërkombëtar.
Ka çështje të tjera që ndoshta personalisht nuk pajtohem me ekzekutivin, por tani është puna te sheshi, që është ndër më të mirët në Kosovë dhe duhet ta përkrahim, si dhe duhet ta përshëndesim kryetarin, që ka gjetur mënyrën për ta financuar dhe për ta ekzekutuar këtë shesh. Sa i përket asaj se a ka gjelbrim, a ka beton, është një shprehje që thotë: Arkitektit dhe inxhinierit nëse ia qeshim betonin, është njëjtë sikur fëmijët t'ia qeshim nutellën. Kështu që, i them kryetarit të degës së LDK-së, që pa beton gjërat nuk bëhen. Më duket që është ruajtur edhe parku, po ka edhe gjelbërim. Në atë shesh i kemi edhe heronjtë dhe besoj që duhet të bëhemi bashkë dhe sa më shpejt ta kryejmë këtë projekt dhe ta gëzojmë.
**Lirigzon Kastrati:** Kryetari i LDK-së nuk është këtu, por të përgjigjem unë. Je kontravers, the që është sheshi më i mirë në Kosovë, mirëpo s'pajtohem. Nëse është i mirë, për cilat çështje s'pajtohesh ti?
**Sejfullah Sejfullahu:** Faleminderit kryesues! shkurt, e dëgjova Hasanin mirë, u mundua ta relativizojë. Hasani tha që një pjesë nuk e kanë votuar sheshin, nuk më kujtohet nëse e kam votuar ose jo, por ne që nuk e kemi votuar a nuk do ta gëzojmë atë shesh a? Gjerave të mira duhet t'u duatrokasim dhe shpresojmë që bëhet sheshi më i mirë në Kosovë, ashtu siç po planifikohet. Ndonjëherë i bijmë edhe "pishman", Albini ka qenë kundër Rambujesë, kundër shpalljes së Pavarësisë dhe kundër flamurit, por sot Albini i ka 51%, 42 deputetë – 60 deputetë dhe po e gëzon edhe ai.
**Nënkryetari:** Faleminderit i nderuar kryesues! Të nderuar kuvendarë, drejtorë, të pranishëm. Sefë, ne duhet m'u gëzu ka pak, dikush në nivelin lokal, dikush në atë qëndror. Ish kryesuesi është gëzuar me fitoren e VV-së, siç ne jemi gëzu në nivel lokal, ka pak gëzimin ta ndajmë bashkërisht. Për pyetjet e parashtruara, përgjigjet do t'i merrni me shkrim në afatin ligjor dhe për çdo paqartësi ju ftoj që komunikimin me drejtorë mund ta bëni secili. Për të gjitha ato shkelje dhe paqartësi që ju si subjekt politikë mendoni që është bërë, ju ftoj që t'u drejtoheni organeve kompetente. Te kufizimi i fjalës në kuvend, nëse ka ndonjë rregullativë apo zbraztirë ligjore në MAPL, mund t'i drejtoheni atyre, duke bërë ankesë për kryesuesin e kuvendit. Në fund, te dhurata e asambleistes Vlora. Sot është dita e fundit e deklarimit të pasurisë. Besoj që drejtoresha e ka bërë deklarimin e pasurisë dhe dhurata është më pak se 50€, e kemi pranuar me qejf. E ftoj secilin asambleist që nëse ka dhurata të tilla, unë i pranoj në vend të drejtorit dhe kudo bashkërisht, atë që ne nuk mund ta bëjmë me buxhetin e komunës, të kërkojmë donacion.
**Merisa Sharku:** Sa i përket sheshit qëndor, besoj që të gjithë qytetarët i gëzohemi ndërtimit të sheshit, por çdo herë e kam cekë që është shumë e rëndësishme që puna të bëhet në nivel të duhur, si dhe detajet e fundit të ekzekutohen në mënyrë profesionale. Në park apo rrotull betonimit gjelbërimi të jetë me nivel pak më të lartë

**3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për themelimin e Muzeut Etnografik në Drenoc:**

**Afrim Dina:** Faleminderit, kryesues! I nderuar nënkryetar, kolegë drejtorë, të nderuar anëtarë të kuvendit. Para jush e keni propozim-vendimin e kryetarit të komunës për themelimin e Muzeut Etnografik në Drenoc. Objekti ku aktualisht ruhen artefaktet është objekti i shkollës së vjetër në Drenoc, ku një numër i madh i artefakteve ruhen në mënyrë të përkohshme. Janë 815 artefakte dhe 330 fotografi, të cilat një mësimdhënës shumë i respektuar, për një periudhë prej 25 vitesh radhazi, është munduar që të mbledhë artefakte të shumta me nxënësit dhe me banorët e fshatit Drenoc. Unë e pashë që materiali, kur ju ka ardhur, materiali dhe skanimi i fotografive kur është bërë ka humbur paksa pamjen. Ku besoj që, në objektin e shkollës së vjetër në Drenoc, shumica prej nesh e ka vizituar të paktën një herë dhe ka parë një numër të madh artefaktesh. Qëllimi i themelimit të Muzeut Etnografik në Drenoc, është ruajtja, mbrojtja dhe konservimi i materialeve të cilat aktualisht janë aty. Selia e këtij muzeu do të jetë pikërisht aty në Drenoc dhe objekti ekzistues ku është. Pas aprovimit apo votimit nga kuvendi, aty ka nevojë të intervenohet pak edhe në pjesën e brendshme, në mënyrë që të ruhen më mirë artefaktet aty.

**Burim Krasniqi:** Faleminderit drejtor për prezentimin. E kemi edhe një shtëpi muze në Drenoc që e kemi shpallë më herët. Nuk e diskutoj këtë çështje, që ta vlerësoj a duhet të votohet apo jo, sepse është komisioni që e ka vlerësuar. Sa është punuar në zhvillimin e muzeut të parë? A parashihet buxhet? A ka përkujdesje? A është pjesë e një doracaku për vizitorë? Mendoj që vendimet duhet të zhvillohen prej ekzekutivit që të arrijnë qëllimin që kanë. Muzeu duhet t'i ketë elementet e brendshme, po ashtu edhe personin për informim, njëjtë sikur Muzeu i Masakrës në Krushë të Madhe. Kërkoj që kjo punë të zhvillohet tutje dhe jo të mbetet vetëm një vendim i asamblesë.
**Lirigzon Kastrati:** Shefi i grupit të LDK-së i ngritit çështjet. Ne i përkrahim këto lloj propozimesh. Në Rahovec e kemi Sahat-kullën, që është në gjendje jo të mirë të mirëmbajtjes. Nuk e di nëse nxënësit e shkollave kanë qenë ndonjëherë në vizitë në këto monumente. Te drejtori i arsimit propozoj që të organizojë vizita për nxënësit, që të njihen me vlerën e këtyre monumenteve historike që i ka komuna jonë. Po ashtu, të ketë mirëmbajtje dhe të caktohet edhe një orar për vizitat, që të jetë i qasshëm.
**Afrim Dina:** Po, në lidhje me çështjen e muzeut të UÇK-së në Drenoc, kemi një kompani që e menaxhon pastrimin e hapësirave të jashtme dhe objektit në brendësi. Sa i përket ciceronit, kemi kërkuar nga ministria që kemi nevojë për zyrtarë të cilët duhet të punësohen nëpër muzetë ku i kemi, njëjtë sikurse në Krushë të Madhe, Irfon Ramadanin. Fatkeqësisht, nuk kemi marrë përgjigje konkrete. Atëherë, mundohemi sa herë ka kërkesa për vizita në muze, si në atë të UÇK-së në Drenoc, të ndajmë ndonjë zyrtar që kemi në dispozicion dhe ta dërgojmë atje për të dhënë informacionet e nevojshme. Për muzenun që po e themelojmë, rolin i ciceronit e ka kryer vetë mësuesi Nazmi Berisha.
Sa i përket pyetjes tjetër, për Sahat-kullën, mirëmbajtja e monumenteve bëhet, por nuk kemi zyrtarë që qëndrojnë aty. Kemi viyita nga shkollat – nxënësit, por mësimdhënësit na thërrasin neve dhe kërkojnë një orar për të shkuar atje, ku gjithashtu e dërgojmë ndonjë zyrtar për shpjegim. Kjo gjendje vjen si pasojë e mungesës së personelit, sepse nuk kemi mundësi t'i kemi të gjithë zyrtarët për çdo muze. E njëjta vlen edhe për kompleksin memorial në Gradish – vizitorët vijnë, por nuk kemi askënd që të jetë çdo herë aty. Nuk e kemi as në Kullën e Heronjve Toni e Mici. Kemi shumë vende dhe për këtë arsye kemi kërkuar vitin e kaluar nga ministria që të na lejohet punësimi i së paku katër zyrtarëve për muze. Kjo trashëgimi është vërtet pasuri e komunës sonë, por në anën tjetër kemi vështirësi të tilla që nëse vjen ndonjë turist, apo grup turistësh, të kenë dikë për t'i informuar
**Kryesuesi:** Faleminderit drejtor! Nëse nuk keni diçka tjetër, e vendosim në votim! Kush është "për"?... Me 21 vota "për" votohet pika e tretë e rendit të ditës.
**4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga viti 2023 dhe 2024 në vitin 2025:**
**Afrim Limani:** I nderuar kryesues, i nderuar nënkryetar, të nderuar asamblistë, të gjithë të pranishëm.
Të bazuar në nenin p, pika 4.7 të ligjit të financave publike dhe përgjegjësive, para juve e paraqesim një dokument – propozim për bartjen e mjeteve nga viti 2023 dhe 2024 në vitin 2025. Shuma e ndarë për këtë bartje është prej 679.543€. Para jush i keni dy dokumente, e keni edhe një dokument shtesë që ne kemi t'ju thjeshtësojmë procedurat dhe ta kuptoni më mirë bartjen e mjeteve dhe në cilat projekte do të barten. Te kompleksi sportiv, faza e tretë, rregullimi i tribunës, shtegu i atletikës dhe elemente të tjera – 50,000 euro; Rregullimi i hapësirave të ish objekteve të AKP-së dhe funksionalizimi i objekteve lolake afarsite – 65,743 euro; Ndërtimi i çatisë së amfiteatrit në Denjë – 30,000 euro; Ndërtimi i qendrës përkujtimore të UÇK-së në Retijë – 50,000 euro; Ndërtimi i rrethojave të oborreve të shkollave – 55,000 euro; Ndërtimi i rrugëve lokale – 60.000€; Rregullimi i çatisë në palestrën sportive Mizahir Isma – 50,000 euro; Restaurimi i muzeut dhe objekteve përkujtimore – 55,000 euro; Përmirësimi i infrastrukturës rrugore të vendbanimeve të komuniteteve joshumicë – 30.000€; Projekte me bashkëfinancim, 65.000€. Gjithashtu, e kemi ndarë edhe një pjesë të mallrave dhe shërbimeve në kuadër të Drejtorisë së Kadastrës, për shkak të projektit të digjitalizimit të kadastrës dhe një pjesë e kemi ndarë për subvencione në kuadër të Drejtorisë së Bujqësisë. Kërkoj nga ju që ta votoni këtë pikë të

rendit të ditës, sepse kemi një shumë të përcaktuar në kuadër të drejtorisë, që duhet të rikategorizohet përmes bartjes së mjeteve në vlerë prej 670,543 euro.

**Burim Krasniqi**: Kam disa pyetje konkrete. E para, a është vetëm si titull "bartja e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga vitet 2023, 2024 dhe 2025. Në vitin 2023 a ka mjete të mbetura të pashfrytëzuara? Nëse po, sa ka qenë shuma dhe pse kanë mbetur, duke pasur parasysh që në fund të vitit i kemi 1 milion euro fatura të papaguara të vitit 2024?

E dyta, renovimi i çatisë në Dejnë! Drejtor, më duket që është shpejt që ajo çati të riparohet! Tjetër, riparimi i çatisë në palestrën Mizahir Isma, do të ndodh përsëri, apo thjesht është borxh që është akumuluar prej riparimit të çatisë prej vitit të kaluar? Nëse do të riparohet përsëri, është shqetësuese. E fundit, nën programi për shërbime publike, mbrotje civile - emergjencë dhe infrastrukturë publike, bartja është 60.000€. Drejtor, zjarrfiksat a kanë nevojë të investojnë diçka, sepse nuk e pashë askund të ruhet për zjarrfiksa, meqenëse përfshihen emergjencat? Apo janë emergjenca në infrastrukturë që i përkasin Drejtorisë së Urbanizmit?

**Defrim Kafexhiu:** E kam një pyetje për drejtorin! A ka ndonjë mundësi që prej buxhetit, qoftë prej këtyre të ndarjes së mjeteve, një shumë të ndahet për çështjet e shpronësimit. Një pyetje tjetër për drejtorin e Shërbimeve Publike për çështjen e trafos në rrugën "Vëllezërit Frashëri" dhe a është e mundur që Komuna e Rahovecit ta ndanë një shumë mjetesh për çështjen e shpronësimit nga këtu, nga bartja e mjeteve?

**Sejfullah Sejfullahu:** Po e shoh kodin 53790, për ndërtimin e rrugës Rahovec – Xërxë –Opterushë– Krushë e Madhe – Gexhë – Kramovik - Hoçë. A mundeni konkretisht të na tregoni se cila rrugë lidhet me cilën në këtë projekt? Krushë me Gexhë e Opterush nuk lidh asgjë. Te riparimi i terreneve sportive, Krushë të Madhe, Xërxë, Pataqan, Noshpallë, Fortesë – a bëhet fjalë për një borxh, apo për një ndërhyrje të re në terrenet sportive? Kryesisht më shumë më intereson për rrugë, sepse në Krushë rrugët janë katastrofë. Më intereson të dij se cila rrugë do të ndërtohet?

**Lirigzon Kastrati:** Dua të diskutoj për të njëjtën çështje që e ngriti z. Sejfullahu, sepse për mua ka rëndësi të di sakt se për cilat rrugë konkretisht bëhet fjalë. Gjithashtu, në programin për kulturë, rini dhe sport, në pjesën e shërbimeve kulturore të Rahovecit, te pika e katërt 2.7.4, për riparimin e monumenteve kulturore në Krushë të Madhe – Hoçë e Vogël, Rahovec, kodi 53799 me shumën prej 55.000 euro. Çka është paraparë me këto mjete? Çfarë riparimesh do të bëhen konkretisht në Hoçë të Vogël?

**Afrim Dina:** Faleminderit, kryesues! Sa i përket pjesës së kulturës, për pyetjen që u bënë – e keni te materiali në pjesën e dytë. Sa i përket pyetjes së z. Krasniqi, për rregullimin e çatisë së amfiteatrit në Dejnë. Nuk është riparimi i çatisë së amfiteatrit aty ku është skenda, sepse është mirë, por e kemi planifikuar që për shkak të reshjeve atmosferike, jemi përpjekur që përmes tendave t'i sigurojmë qytetarët që të mos lagen nga shiu dhe kemi marrë vendim që ajo pjesë e hapur ku është planifikuar të mbahet aktiviteti të rregullohet, përfshirë edhe rregullimin hapësirës jashtë. Për këtë arsye kemi quajtur projektin: "Rregullimi i çatisë së amfiteatrit në Dejnë" dhe jo "riparimi i çatisë së skenës së amfiteatrit në Dejnë". Për rregullimin e çatisë së palestrës sportive "Mizahir Isma". Vitin e kaluar e kemi pasur një kontratë ku kemi bërë mirëmbajten e objekteve sportive dhe në një pozicion me një buxhet 3000€ jemi munduar t'i sanojmë problemet që i kemi pasur rreth rrjedhjes së çatisë. Jemi munduar shumë, por nuk po mundemi ta sanojmë çatinë 100% që gjatë të reshurave mos të pikojë uji në parket. Kemi për qëllim të bëjmë punë shtesë në çati dhe të mos kemi më probleme të tilla. Po ashtu, kemi paraparë që përmes kësaj, do të bëhet rregullimi i mbi 120 karrigave që i kemi të dëmtuara, si dhe rregullimi i disa pjesëve të nyjeve sanitare. Te pyetja e Lirigzonit, riparimi i monumenteve kulturore, Krushë e Madhe, Hoçë e Vogël, Rahovec. Ne e kemi një kod të tillë në mënyrë që mos të hapim kode të reja, e kemi bë në kuadër të këtij kodi. Te restaurimi, z. Sejfullahu bëri pyetje: Një prej këtyre është edhe muzeu etnografik, por kemi edhe muze tjerë që kanë probleme me çati dhe kanë nevojë për lyerje dhe për elemente të tjera. Sefë, ne jemi duke punuar në rregullimin e terreneve sportive dhe do të vazhdojmë tutje. Kemi edhe pak obligime për terrenet sportive që i kemi përfunduar në vitin 2024. Me rregullime do të vazhdojmë edhe këtë vit.

**Burim Krasniqi:** Drejtor, nuk po e kontestojmë bartjen e mjeteve. Është e paarsyeshme me thënë që, po e lëmë i suficit këto mjete. Vetëm po diskutojmë më detajisht. Te çështja e sheshit qëndror, tregu i gjelbërt ku është? Nëse nuk është në të njëjtën hapësirë, pse duhet t'ia japim të njëjtës kompani? Tregu i gjelbërt nuk besoj që është në sheshin qëndror dhe mendoj që këtu nuk e ka vendin, sepse tregu i gjelbërt llogaritet të bëhet diku tjetër. E fundit, kërkoj që projekteve me bashkëfinancim t'ia heqim nga 25.000€ dhe t'i bartim në terrene sportive dhe tribunat në fushë të sportit në Xërxë t'i përfundoni. Kanë mbetë keq, tifozët duhet të përdorin shkallë aty, që janë bërë rrezik edhe për fëmijët. Është kërkesa e parë që e bëjë ndaj ekzekutivit, sepse jam shumë i kursyer në këtë drejtim.
**Bejtullah Deliu:** Faleminderit kryesues! I nderuar zv. kryetar, drejtorë të drejtorive, kolegë asambleistë, media dhe të gjithë të pranishmit. Drejtor, desha të kyçem lidhur me një përgjigje që e dhatë për palestrën sportive, që është duke rrjedhë uji. Kjo problematikë, me sa di unë, ka ndodhur ende pa u pranuar as pranimi teknik, e jo në vitin e kaluar që e cekët ju. Tash është interesante të dihet a është kjo problematikë që ka vazhduar për vite me radhë, do të thotë dëmi, është shkaktuar ose është bërë edhe më i madh dhe çfarë është më interesante, a është e pranuar kjo palestër teknikisht? Nëse nuk është e pranuar teknikisht dhe zyrtarisht që është në rregull, atëherë pse duhet tash komuna mjetet vetanake me i dhënë për ato dëme? Ndoshta ekziston ndonjë mundësi që kompania që nuk e ka dorëzuar siç duhet, nuk është bërë pranimi teknik, duhet ata ta rregullojnë, jo të shkojnë financat nga taksat tona komunale të ndërtojmë diçka që është ende valide, që një kompani e caktuar nuk i ka kryer punët si duhet, ose të shikohet se ku është faji! Po zhvillohen aktivitete të ndryshme pa pranim teknik me sa e di unë. Atëherë, nëse është kështu, ligjërisht nuk jemi në rregull dhe duhet që dikush të japë llogari këtu.
**Merisa Sharku:** Cila formë është përdorur për shpërndarjen e mjeteve nëpër këto dikastere? Çka i duhen kadastrës 50.000€? Ndoshta, këtë bartje do të ishte më mirë t'ia japim sheshit, sepse ka një kosto mjaft të madhe.
**Afrim Dina:** Faleminderit, z. Deliu. Përurimi i palestrës është bërë më 2019. Aty janë zhvilluar edhe lojëra të mëdha ndërkombëtare. Realisht, një pranim në heshtje ka qenë edhe nga nivelet e larta, por pranim teknik nuk ka. Te çatia ka pasur probleme kur ka pasur reshje me erë. Në 2022 kur kam ardhur unë si drejtor e ka vërejtur këtë gjë. Përveç zyrtarëve Xhabir Hajrullaga dhe Arsim Kastrati, gjithashtu edhe unë personalisht natën vonë kam ardhur dhe e kemi parë që në dysheme ka pasur shumë ujë. Tutje, jemi mundur që përmes pozicioneve të mirëmbajteve t'i sanojmë këto probleme. Tani, nuk qëndon kjo situatë, por gjithashtu nuk është 100% e kompletuar dhe na nevojitet që të bëjmë ndërhyrje komplet në çatinë e palestrës.
**Afrim Limani: Afrim Limani:** Do t'ju përgjigjem ashtu siç i keni parashtruar pyetjet me rend. Burim, sipas ligjit të finanvave publike dhe përgjegjësive, nëse eventualisht nëse edhe një cent ka mbetur për bartje, atëherë duhet të jetë ky përshkrim. Në këtë rast, ne i kemi informatat e sakta, 83.279€ janë mjete nga viti 2023 që kanë ngelur që duhet t'i bartim dhe 15.000 janë që kanë mbetur nga viti 2024, si dhe pjesa tjetër janë rritje e planifikimit të të hyrave. Propozove që, t'i bartim nga projekti me bashkëfinancim rreth 25.000€. Në fillim të vitit 2025 ne i kemi lidhur disa kontrata me ministri dhe organizata të ndryshme dhe e kemi parë që mjetet e planifikuara në buxhet janë të pamjaftueshme t'i mbulojnë këto kontrata dhe për këtë arsye të paktën 65.000€ po i bartim. Defrim, sipas ligjeve nuk kemi të drejtë të blejmë tokë, apo të bëjmë shpronësim. Shpronësimi lejohet sipas projekteve ekzistuese. P.sh. nëse ndërtohet një park, nuk është pronë e jona dhe ne e blejmë, e bëjmë shpronësimin dhe e bëjmë projektin për ndërtimin e parkut. Nuk kemi të drejtë të japim para drejtpërdrejt. Merisë, forma e shpërndarë e këtyre mjeteve ka rrjedhur në bazë të planit të prokurimit, i cili kam marrë formën përfundimtare në fund të dhjetorit. Te Kadastra e bëre një pyetje, kontrata aty ka të bëjë me digjitalizimin e kadastrës dhe vlera është rreth 100.000€. I kemi 30.000 dhe 50.000 tjera po i bartim për mbulimin e kësaj kontrate, sepse kjo kontratë duhet të ekzekutohet brenda këtij viti fiskal.
**Burim Krasniqi:** Drejtor, nuk ma dhe këtë përgjigje për tregun e gjelbërt, a është pjesë e sheshit apo e dikujt tjetër? E dyta, kryesues, të kërkoj që ta vendosësh në propozim, prej 65.000 eurove në kodin 53782, të barten 25.000 në kodin

48175 për finalizimin e tribunave të stadiumit në Xërxë, ose nëse drejtori i Financave ka një propozim tjetër për bartje prej një kodi tjetër. Ka nevojë për këtë gjë, sepse për moment është keq dhe rrezik, sepse është edhe shkolla e futbollit.
**Hasan Përboqi:** Të gjitha diskutimet e kanë bazën e shëndoshë, duke u bazuar në kërkesa. Ky buxhet nuk është aq i madh dhe gjatë diskutimeve që kemi pasur ne si grup, drejtori ka pasur kërkesë që të përkrahen këto projekte dhe të bëhen këto bartje. Kërkojmë edhe nga asambleistët të tjerë që t'i përkrahim këto propozime, ashtu siç kanë ardhur nga ekzekutivi.
**Kryesuesi:** Të nderuar anëtarë, jemi duke e diskutuar pikën e katërt ku Burim Krasniqi ka dhënë një propozim, të cilin e vendosim në votim. Kush është "për"?... Kundër?... Abstenim?... Me 13 vota "për", 1 votë kundër dhe asnjë abstenim, kalon propozimi i Burim Krasniqit. Të nderuar anëtarë, tani e vendosim në vitim pikën e katërt së bashku me propozimin. Kush është "për"?... Kundër?... Abstenim?... Me 16 vota "për", asnjë kundër dhe 1 votë abstenim, votohet pika e katërt.
**5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për miratimin e vendimit paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatshkurtër, personave fizikë dhe juridikë, P- 00320-0, zk – Radostë:**
**Afrim Oruqi:** Faleminderit kryesues! I nderuar nënkryetar! Kemi vendim për dhënien e pronës me qera për 15 vjet, 7 ari e 70 $m^2$ në zonë kadastrale në Radostë.
**Defrim Kafexhiu:** Cili është interesi i komunës së Rahovecit që t'i japim këto 7 ari dhe cili qëllimi i dhënies në shfrytëzim të kësaj prone?
**Burim Krasniqi:** Drejtor, kjo pronë është te rruga "Ali Shabani", sipas gjeoportalit. Në hyrje të Radostes, para se të futemi te xhamia në drejtim të Ratkocit, në krahë të djathtë goxha largë prej rrugës kryesore. Janë disa shtëpi aty afër, a ka ndonjë kërkesë nga dikush, sepse është shumë thellë që të jetë në interes të zhvillimit të komunës, ose të rritjes së vlerës së pronës?!
**Afrim Oruqi:** Është pronë e komunës, është në rrugën "Ali Shabani". Është afër parcelave që qytetarët në këtë komunitet kanë shprehur interesim ta marrin me qera dhe ta trajtojnë për nevojat e veta për bujqësi.
**Kryesuesi:** Faleminderit drejtor! Nëse nuk kemi pyetje tjera, e vendosim në votim. Kush është "për"?... Kundër?... Abstenim?... me 14 vota "për", një abstenim dhe asnjë kundër, votohet pika e pestë.
**6. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës, personave fizikë dhe juridikë, P- 00320-0, zk – Radostë:**
**Afrim Oruqi:** Po marrim vendim që të formojmë komision që t'i zhvillojmë procedurat për parcelën e njëjtë. Komisioni i ka pesë anëtarë, 2 nga ekzekutivi, 2 nga kuvendi dhe 1 nga shoqëria civile.
**Hasan Përboqi:** AAK, propozojmë Feriz Thaqin.
**Vlora Vuçiterna:** LVV, propozojmë Leonard Morinën.
**Kryesuesi:** Atëherë, LDK dhe PDK nuk patën propozime, nga kuvendi janë Feriz Thaqi AAK, Leonard Morina LVV. I vendosim në votim, kush është "për"?... Kundër?... Abstenim?... Konstatoj që unanimisht votohet përbërja e komisionit.
**7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për dhënien e pëlqimit paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës, personave fizikë dhe juridikë, P-02240-81, zk – Rahovec:**
**Afrim Oruqi:** Po marrim vendim për pronë të komunës në sipërfaqe prej 2 ha e 80 ari. Saktësisht kjo parcelë gjendet në rrugën Rahovec-Malishevë, në anën e djathtë, pak më tutje se shtegu i ecjes së Majës së Shkodranit. Propozohet që kjo pronë të jepet në shfrytëzim afatgjatë për 50 vjet me qëllim zhvillimi të aktivitetit biznesor. Propozimi përfshin që çmimi fillestar të bazohet në rregulloret në fuqi dhe pagesa e qirasë të fillojë pas 24 muajsh. Ftoheni të votoni këtë vendim.

**Burim Krasniqi:** Drejtor, vetëm një pyetje: kjo parcelë për 50 vjet për biznes – a ka të bëjë me vendimin për vendosjen e Agjencionit të Ushqimit dhe Veterinës? Është parcela 2240-81. A ka mundësi të sqarohet pak më shumë?
**Afrim Oruqi:** Kjo parcelë ka 3 hektarë. Ditëve të fundit kemi marrë kërkesë për vendimin e dhënies së saj për një investim në fushën e veterinarisë dhe ushqimit, ku parashihet një investim prej 700,000 eurosh për ndërtimin e një institucioni profesional në këtë fushë. Nga kjo parcelë do të shfrytëzohen 2 hektarë për projektin. Kjo është marrëveshja e propozuar dhe kërkohet miratimi i kuvendit. Është e njëjta parcelë me të njëjtin numër dhe që ta ndajmë një parcelë të komunës na duhet një vendim i kuvendit, si dhe pas ligjshmërisë kjo parcelë në të ardhmen do t'i ketë 2 ha e 80 ari.
**Burim Krasniqi:** Drejtor, kur ka raste të tilla është mirë që t'i kemi koordinatat në start. Të jemi në dijeni se cila pjesë prej të njëjtës parcelë po jepet për shfrytëzim biznesor dhe cila pjesë për Agjencionin e Ushqimit dhe Veterinës.
**Kryesuesi:** Atëherë, nëse nuk kemi pyetje të tjera. E vendosim në votim pikën e shtatë, kush është "për"?... Kundër?... Absteim?... Unanimisht (19) votohet pika e shtatë.
**8. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës P-02240-81-0 ZK-Rahovec:**
**Afrim Oruqi:** Po marrim vendim që të formojmë komision që t'i zhvillojë procedurat për parcelën e njëjtë. Komisioni i ka pesë anëtarë, 2 nga ekzekutivi, 2 nga kuvendi dhe 1 nga shoqëria civile.
**Hasan Përboqi:** AAK, nuk kemi propozim.
**Burim Krasniqi:** LDK, propozojmë Lirigzon Kastratin.
**Melida Iska Oruqi:** PDK, propozojmë Sejfullah Sejfullahun.
**Merisa Sharku:** LVV, propozojmë Defrim Kafexhiun.
**Kryesuesi:** Atëherë, duhet t'i vendosim në votim veç e veç kandidatët e propozuar.
**Merisa Sharku:** Atëherë, tërhiqet Defrim Kafexhiu.
**Kryesuesi:** Faleminderit! Atëherë, nga kuvendi pjesë e këtij komisioni janë: Lirigzon Kastrati LDK, Sejfullah Sejfullahu PDK. Dy përfaqësues do të jenë nga ekzekutivi dhe një nga sektori joqeveritar. Këtë përbërje e vendosim në votim, kush është "për"?... Konstatoj që, unanimisht votohet përbërja e këtij komisioni.
**9. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për miratimin e vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për nevojat e Agjencionit të Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV):**
**Afrim Oruqi:** Në dalje të Rahovecit, rruga Rahovec – Malishevë, parcelën me numër 2240-81 po e ndajmë, duke ia këputur 20 ari me qëllim të ndërtimit të institucionit të veterinës dhe të ushqimit. Kjo parcelë do të ketë numër të ri dhe sipërfaqe të re, si dhe do t'i jepet në shfrytëzim Drejtorisë së Bujqësisë.
**Kryesuesi:** Nëse nuk kemi pyetje rreth kësaj pike, e vendosim në votim. Kush është "për"?... Kundër?... Unanimisht me 19 vota "për", votohet pika e nëntë e rendit të ditës.
**10. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për shpalljen me interesi të përgjithshëm publik të parcelës P-71510057-00095-6, në Zonën Kadastrale Rahovec:**
**Afrim Oruqi:** Në lagjen e epërme të komunitetit joshumicë, me numër të parcelës 95-6, po e shpallim me interes të përgjithshëm këtë parcelë. Kërkoj nga sekretariati që ta përmirësojë sipërfaqen, nga $55m^2$ në $28m^2$. Qëllimi i këtij vendimi është që kjo parcelë kufizohet me rrugën publike dhe pas këtij vendimi duhet ta këmbejmë me qëllim të vetëm që ta zgjerojmë rrugën publike.
**Burim Krasniqi:** Drejtor, parcela 95-6 nuk është e kufizuar me rrugë publike, kjo parcelë është prapa një shtëpie – objekti! E kam në hartë këtu përpara. Ku llogaritet të zgjerohet rruga publike nëse shpronësohet kjo? Kjo parcelë mund ta hap një rrugë për një parcelë tjetër, por të zgjerojë rrugë publike jo. Kjo parcelë mund ta hap një rrugë për parcelën me numër 94-0. E kujt është kjo parcelë mund ta kuptojmë, por nëse zotëriu dëshiron t'i hap rrugë vetes, le ta blen vet, ashtu siç e kam blerë edhe unë dhe jo komuna t'ia hap rrugën. Në vitin 2000, 1.5 ari e kam blerë 6500€, për të hapur rrugë individuale.

**Afrim Oruqi:** Faleminderit, asambleist Burim Krasniqi! Duke mos dashur t'ju ngarkoj për shkak të arsyeve që i kemi të gjithë, për shkak të muajit të shenjtë të Ramazanit. Kjo parcelë e propozuar kufizohet me prona dhe rrugë komunale. Kjo që është e hijezuar me të kuqe, me vija të ndërprera me nr. 94-0 është pronë e komunës, parcela 95-4 është pronë private dhe të gjitha parcelat përreth nuk kanë dalje, si dhe nuk kanë kanalizim. Ky është terren i vështirë. Këta i përkasin komunitetit joshumicë, por janë njerët sikur ne dhe kanë nevojë dhe me të drejtë kërkojnë qasje në kanalizim dhe në shërbime të tjera. Me këtë veprim, përveç që e zgjerojmë atje rrugën, gjithashtu i zhbllokojmë këto parcela. Pra, me këtë veprim i kemi dy qëllime.
**Burim Krasniqi:** Drejtor, parcela 94-0 është pronë komunale? Parcela 95-7 është pronë komunale, e cila ka lidhje me parcelën 94-0. D.m.th sa i përket kanalizimit, ka hapësirë për këtë gjë. Nuk po më bind mjaftueshëm që ne duhet ta shpronësojmë atë pronë, apo ta shpallim interes të përgjithshëm.
**Afrim Oruqi:** Kështu siç po e shohim në projektor del të jetë si e rrafshët, por në terren disniveli është 50 metra, është breg. Kanalizimin nuk mund ta dërgojnë lart, përveç me pompa. Parcela 95-5 është shtëpia e shëndetit. Është terren i vështirë dhe është e pamundshme që parcelat në fjalë të lidhen lart me kanalizim dhe duhet t'i bëjmë këto veprime për ta zhbllokuar këtë gjendje.
**Kryesuesi:** Nëse nuk kemi pyetje tjera rreth kësaj pike, e vendosim në votim. Kush është "për"?... Kundër?... Unanimisht me 19 vota "për", votohet pika e dhjetë e rendit të ditës.
**11. Shqyrtimi i informatës mbi listën e pronave komunale dhe menaxhimin e tyre:**
**Afrim Oruqi:** Me planin e kuvendit, çdo vit ju raportojmë në lidhje me pronat e komunës. Fatmirësisht prona të komunës ka në të gjitha zonat kadastrale. Komuna e Rahovecit i ka 34 zona. Prej vitit të kaluar e kemi vetëm një ndryshim, pronat që po i shpronësojmë po e rrisin sipërfaqen e pronës komunale.
**12. Shqyrtimi i informatës rreth menaxhimit të aseteve komunale:**
**Erhan Morina:** Faleminderit kryesues! I nderuar nënkryetar, kolegë drejtorë, anëtarë të kuvendit, media. Para jush e keni dokumentin mbi menaxhimin e aseteve komunale për vitin 2024. Në Drejtorinë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm gjendet edhe sektori për menaxhimin e aseteve komunale. Gjatë vitit 2024 në këtë sektor janë kryer një mori aktivitetesh. Është bërë regjistrimi i aseteve të reja komunale, inventarizimi i pasurive jofinanciare, janë zhvilluar dy ankande publike për shitjen e aseteve të papërdorshme të komunës dhe punë të tjera të parapara. Në fillim të vitit 2024, me vendim të kryetari të komunës janë formuar 4 komisione: Komisioni për regjistrimin e pasurive jofinanciare, komisioni për inventarizimin e pasurive jofinanciare, komisioni për tjetërsimin e pasurive jofinanciare dhe komisioni për asgjësimin e pasurive jofinanciare. Komisioni për regjistrimin e pasurive jofinanciare ka bërë regjistrimin e aseteve publike në objektet e administratës komunale, objektet kulturore-sportive, në shkolla, QKMF dhe AMF. Në administratë komunale, në objektet kulturore dhe sportive janë evidentuar gjithsej 7394 asete. Në shkolla 21.479 asete dhe në QKMF-AMF janë regjistruar 2792 asete. Komisioni për inventarizimin e pasurive jofinaciare, në arsim janë inventarizuar 21.478 asete, ku 645 prej tyre janë jashtë përdorimit. Në QKMF-AMF, janë inventarizuar 2792 asete dhe prej tyre 28 janë jashtë përdorimit. Në administratë janë inventarituar 7394 asete dhe 120 prej tyre janë jashtë përdorimit. Në raportin përfundimtar të komisioneve për inventarizim të të gjitha objekteve komunale janë evidentuar gjithsej 793 asete që janë jashtë përdorimit. Shumica prej këtyre aseteve u janë nënshtruar dy ankandeve publike. Regjistrimet mbi 1000€ dhe më pak se 1000€ gjatë vitit 2024 kanë qenë 261 regjistrime, në vlerë prej 14.708.428€. Regjistrimet më pak se 1000€ kanë qenë 1272 regjistrime, në vlerë 103.152€.
**13. Shqyrtimi i informatës rreth hotel "Park plaza" – Rahovec:**
**Erhan Morina:** Para jush keni propozim-vendimin e kryetarit për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale përmes procedurës së shprehjes së interesit në periudhë prej 99 viteve. Bëhet fjalë për parcelën me numër 01315-0 në zonën kadastrale Rahovec dhe sipas certifikatës së pronësisë pronar është Komuna Rahovec. Jepet në shfrytëzim hapësira e jashtme e Hotel Park Plazës në sipërfaqe prej 2016m$^2$ nga sipërfaqja e përgjithshme prej 2800m$^2$, duke përfshirë këtu

edhe objektin me sipërfaqe prej 2508m$^2$. Destinimi ka të bëjë me zhvillimin e aktiviteteve biznesore, si hotelieri dhe gastronomi. Qëllimi ka të bëjë me rritjen e vlerës së pronës komunale, rritja e vlerës së aseteve të pronës komunale, vetëpunësimi dhe rritja e numrit të të punësuarve. Çmimi përcaktohet në bazë të rregullores për taksa dhe tarifa. Fillimi i pagesës dhe inkasimi i të hyrave për qera fillon pas 24 muajve.

**Burim Krasniqi:** Dy çështje, që si grup i asambleistëve nuk pajtohemi. E para, 99 vite afati është shumë i gjatë. E dyta, 24 muajshi i mospagesës që qerasë duhet ta ketë një arsyeshmëri, sepse është objekt funksional dhe fillimi i investimit nuk do të fillojë nga zeroja. Propozojmë që afati të jetë 30 vite dhe të jepet një periudhë 6 mujore, ose brenda afatit të përfundimit të sheshit dhe që pas përfundimit të sheshit hoteli mund të funksionojë normal. Nëse sheshi nuk funksionalizohet edhe 24 muaj, atëherë është situatë ndryshe, por nëse sheshi bëhet gati brenda 12 muajve, atëherë mund të jetë 6-12 muaj qeraja pa pagesë. Ndoshta është më mirë që këtë gjë ta lëmë në diskrecion të komisionit, në qoftëse procedurat të dhënies në shfrytëzim shkojnë paralel me periudhën e finalizimit të sheshit qëndror, atëherë nuk ka arsye që mos të ketë pagesë të qerasë, sepse është e gatshme gjithçka.

**Erhan Morina:** Në lidhje me pyetjen e z. Burim Krasniqi, që 99 vite janë afat i gjatë. Prej praktikës së kaluar e kemi pasur në shfrytëzim 15 vite, por, kur është afati i shkurtë investitorëve potencialë u jep pasiguri. Shfrytëzuesi i mëhershëm që e ka pasë për 15 vite, është parë që nuk e ka investuar vlerën e investimit prej 2.7 milionë dhe besoj që aq më e gjatë kontrata, siguria e investitorit është më e madhe. Te pjesa tjetër, grejs periudhën e kemi dhënë me qëllim që aty parashihen investime, sepse gjendja ekzistuese nuk është mjaft e mirë dhe e kemi parë të arsyeshme që në periudhën e investimit të mos ketë pagesë.

**Burim Krasniqi:** Në qoftëse për 15 vite nuk ka pasur rezultat, 30 vite është 100% më shumë. Drejtor, kur e thua këtë, duhet ta kesh një analizë të kostos dhe benefitit, sa është kostoja e investimit dhe sa e kthimit, si dhe kur fillon pjesa e benefitit. Nuk thuhet vetëm "nuk e arsyeton investimit". Thuhet që, i investon 3 milionë €, pritet që kjo të kthehet mas kaq viteteve dhe pjesa tjetër është periudha e fitimit. Nuk besoj që investitorit i duhen 30 vite për ta nxjerrë investimin. Grejs periudha prej 24 muajsh që është pa qera, nuk nënkupton që investitori vetëm pas 24 muajve do ta përfunojë investimin. Financimi ose investimi mund të jetë edhe më afatgjatë. Gjithashtu, objekti nuk është në gjendje të mirë, për këtë arsye iu ka ndërprerë kontrata, por është funskional – ka edhe një restorant që mund të jetë funksional. Kryesues, kërkoj që ta vendosësh si propozim që, periudha të jetë 30 vjet dhe periudha 12 muaj.

**Merisa Sharku:** Paraprakisht është mbajtur një takim publik për fatin që e pret Hotel Parkun. Tani ka ardh vendimi që të jepet me qera në këtë formë siç është. Kjo është çështja më e mirë që mund të ndodh, sepse investitori nëse e sheh të arsyeshme e rrënon dhe vjen me një projekt të ri që i përshtatet edhe konceptit të sheshit, sepse sheshi e ka konceptin rrethor. Në formën e tanishme, objekti i hotelit nuk përfaqëson asgjë. Fasada nuk ka asnjë vlerë vizuele dhe për këtë arsye Rahovecit i duhet një hotel i ri me një pamje të bukur. Nëse ka nevojë, mund t'i ndimoj komunës edhe në rolin e arkitektes. Në vendim të ceket specifikat që duhet bërë dhe jo që investitori të bën çfarë të don. Pajtohemi me Burimin, që 100 vjet është shumë, unë e kam periudhën 30-50 vjeçare. 50 vjet mund të jenë pak më të kapshme për një investim të kushtueshëm. Është mirë të jetë në konsesion me komunën dhe jo t'i ketë të drejtat e plota pronari që e merrë me qera.

**Kryetari:** Përshëndetje kryesues, anëtarë të kuvendit, drejtorë të drejtorive, nënkryetar, përfaqësues të mediave dhe të shoqërisë civile. Sot, po diskutojmë për kohëzgjatjen e vendimit për dhënien në shfrytëzim të një objekti, të cilin e kemi parasysh të gjithë, gjendjen dhe fazën ku jemi. Ju e dini që sivjet janë edhe zgjedhjet lokale dhe një situatë të punimeve në shesh, si dhe ndërkohë e kemi një objekt për të cilin nuk dua të hy në detaje, sepse çdo ditë po e shohim me sy. Nuk bëhet fjalë më për periudhë afatshkurtër, sepse bëhet fjalë një hotel. Kriteret dhe kërkesat besoj që duhet t'i bëjë komisioni, i cili asnjëherë më parë duhet ta ketë vëmendjen më të shtuar. E kam shqyrtuar mundësinë të hyjmë me konsesion, por nuk parashihet nëse është hotel dhe duhet të shkojmë me qera, sepse nuk parashihet që konsesioni t'ia jep komunës 2-3 dhoma, ose diçka tjetër. Asnjëherë nuk po instistoj që të them që duhet të jetë 99 vjet, por, ju lus që

nën 50 vjet mos e lejoni. Neve si komunë, si autoritete dhe si komision që ta shqyrtojmë deri në fund atë që është vizion. Burim, kjo periudha 24 muajshe është diskutabile, por ne si komunë duhet t'i kemi kushtet tona. Në një mënyrë investitori obligohet që brenda dy vitete hoteli duhet të jetë në përdorim. Afati është shumë i rëndësishëm dhe vërtetë duhet të kujdesemi për specifikat, kriteret, standartet, mirëmbajtje dhe afatet investive. Ju ftoj që mos të kufizoheni për 30 vjet, e as për 50 vjet, por edhe të jetë 99 nuk ka asgjë të keqe. Komunat serioze shkojnë me afat më të gjata dhe kemi marrë mësime nga e kaluara që duhet t'ia japim mbi 50 vjet. Besoj që ne kemi kapacitete profesionale, përfaqësuese, ekzekutive dhe përvojë të mjaftueshme, si dhe mësime nga e kaluara që duhet t'ia japim mbi 50 vjet. Kërkoj votim unanim.

**Bejtullah Deliu:** Faleminderit kryesues! Është kruciale të vendosen kriteret sa më të mira. Aty po ndërtohet një shesh dhe jam i pajtimit të rrënohet objekti dhe të bëhet një projekt shumë më i mirë dhe më i madh dhe nëse është diçka serioze, të mos diskutojmë për vite, si dhe 99 vite është një situatë më e sigurt për një investitor serioz. Shembullin e kemi bodrumin e vjetër që ka qenë i shkrumuar, por kur është afati më i gjatë, vullneti për investime është më i madh. Ndoshta është më në rregull të jetë 99 vite dhe kriteret të jenë më të mëdha dhe më serioze, se sa të jetë 50 e kriteret më të vogla. Ndoshta është mirë ta krijojmë një komision të jashtëm, ose në ankand të jetë një interesim më i madh, ai që jep ofertë më të mirë dhe më serioze, i njëjti të fitojë.

**Kryetari:** Jo për herë të parë, pajtohem plotësisht me ty Bejtullah. Krieret i bën komisioni, gjithnjë sipas standardeve ligjore. I ftoj përgjegjësit e grupeve politike që ta ndihmojnë ekzekutivin dhe komisionin në hartimin e kritereve. Nuk po insistoj, por për shkaqe të rrëfimit të sukseseve, le të shkojmë për 99 vjet, sepse është siguri. Është me rëndësi afati, por mbi të gjitha janë më me rëndësi specifikat dhe kërkesat e komunës, në mënyrë që bashkërisht ta kemi një vizion të qartë se çfarë lloj hoteli po dëshirojmë.

**Hasan Përboqi:** Diskutimi ishte i mirë dhe i shëndoshë, veçanërisht kur bëhet pjesë për një territor të komunës që ka vlerë shumë të madhe. Para disa muajve e kemi pasur një dëshmi, duke e shfuqizuar këtu në kuvend një kontratë, e cila si investim nuk ka qenë i mirë. Ideja e këtij investimi duhet të jetë milionësh dhe të jetë në proporcion me sheshin qëndor. Te periudha, mendoj që lidhet shumë ngusht edhe vlera e investimit. Sa më e gjatë të jetë periudha, aq më i madh do të jetë investimi. Propozoj që të shkojmë me një periudhë sa më të gjatë, në mënyrë që t'i tërheqim investitorët më seriozë. Propozoj periudhën 99 vite. Te periudha e inkasimit të qerasë, mendoj që të fillohet pas 24 muajve me inkasim është një propozim i mirë, sepse investimi i madh kërkon edhe kohë. Një shembull: Te Maja e Shkodranit është dashur të ndodh një investim serioz, por investitori është tërhequr, sepse kur ka dashur ta merrë pronën nga Agjencioni i Pyjeve, rregullorja e të cilit thotë që në momentin që investitori e merrë në shfrytëzim pronën, menjëherë fillon inkasimi. Periudha e investimit ka qenë 3-4 vite dhe në këtë rast investitori është dashur të paguaj qera 3-4 vite, duke mos marrë asnjë të hyrë. Aq sa kam dëgjuar unë, kjo ka qenë arsyeja e tërheqjes së investitorit. Në anën tjetër, këtu mendoj që duhet të ketë monitorim të rreptë nga ana e komunës, nëse nuk realizohet diçka në 5 vjeçarin e parë, atëherë të ketë ndonjë penalizim, apo mundësi për shkëputje të kontratës. Mendoj që aty duhe të jetë një objekt i ri dhe nuk duhet të bazohemi në këtë që është tani.

**Burim Krasniqi:** Është pak joserioz diskutimi me vite 50, 30. Mendoj që 99 vite janë shumë. Meqenëse kryetari tha është mirë të jetë mbi 50 vite, atëherë duhet ta kemi një rekomandim të juajin, 55 apo 60 dhe të shkojmë tutje. E dyta, le të jetë në një formë që të pritet të ndërtohet një objekt i ri, jo renovim. E treta, të bëhet një ekip profesional, sepse komisioni është politik, nuk është shumë profesional. Të bëhet një ekip që e ndihmon komisionin në kritere, në vlerësim dhe në proces. Pra, një komision profesinal që e ndihmon komisionin në punën e vet. E fundit, meqenëse periudha kohore po thuhet që të mbetet 24 muaj për mospagesë të qerasë, rekomandoj që të jetë edhe koha e investimit 24 mujore që përfundojë projekti dhe jo të presim 4-5 vite në formë "status quo" si pjesë e sheshit qëndor.

**Kryetari:** Ne nuk po flasim për t'u betonuar te afatet, mirëpo kemi shembuj të suksesshëm, një e përmendi Bejtullahu, tjetrin e kemi investimin humanitar të "Orllatit". Pra, 99 vjet e kanë në shfrytëzim, por asnjëherë nuk bëhet pronar.

Ndoshta kjo periudh na jep të drejtë që investitorit t'i kërkojmë shumë më shumë investim. Grejs periudha në një mënyrë është "presion" ndaj investitorit, presion demokratik që ai ta kuptojë që për dy vjet duhet të fillojë të paguaj. Burim, me mirëkuptim po të them që 99 vjet-shi nuk e lëndon aspak procesin, veç e rrit sigurinë dhe neve ka rritë mundësinë. Sa i përket ekipit profesional, kuvendi i komunës sipas procedurave ligjore e formon një komision. Ma jepni një ide dhe unë si kryetar komune po e formoj një komision profesional dhe nëse keni emra konkretë do t'i vendosim. Komisioni profesional do të flet me komisionin që formohet nga kuvendi.
**Burim Krasniqi:** Kryetar, sa i përket komisionit profesional, i kam dy propozime: njëri të jetë i fushës së arkitekturës dhe njëri i fushës së hotelierisë. Të dytë i caktojnë kriteret e nevojshme.
**Kryetari:** Atëherë, pres nga Burimi, Defrimi, Hasani, Sejfullahut, Rasimit, Bejtullahut apo cilitdo, emra inxhinierësh, arkitektësh, hotelierësh, gastronomësh etj... Do ta bëjë me vendim të kryetarit dhe këtë komision e obligoj të komunikojë me komisionin e kuvendit.
**Bejtullah Deliu:** Po më pëlqen ky propozim për formimin e një komisioni profesional dhe të kemi për qëllim që pas aprovimit të komisionit të kuvendit, të krijohet një komision profesonal jashtë kuvendit. Sa më i zgjeruar komisioni, aq më shumë ide të mëdha dhe pse jo edhe të aplikojnë edhe jashtë komunës. Pra, vitet dhe grejs periudhën nuk e diskutoj fare, fokusi është të bëhet diçka profesionale.
**Kryesuesi:** Atëherë, pikën për të cilën diskutuam e vendosim në votim, që me propozim të kryetarit është në vendim për 99 vite, bashkë me rekomandimin për formimin e një komisioni profesional. Kush është "për"?... Kundër?... Abstenim?... Unanimisht me 24 vota "për", votohet pika e trembëdhjetë e rendit të ditës.
**14. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për formimin e komisiont për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, personave fizikë dhe juridikë, zk – Rahovec:**
**Erhan Morina:** Para jush e keni vendimin për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave për vendimin paraprak që e morëm, për dhënien në shfrytëzim të objektit të Hotel Park Plazës për 99 vjet. Komisioni përbëhet prej 5 anëtarëve, 2 nga ekzekutivi, 2 nga kuvendi dhe 1 nga shoqëria civile.
**Hasan Përboqi:** AAK, propozojmë asamblesitin Feriz Thaqi.
**Burim Krasniqi:** LDK, propozojmë Lirigzon Kastratin.
**Sejfullah Sejfullahu:** PDK, propozojmë Melinda Oruqi Iskën.
**Leonard Morina:** LVV, unë si shef i grupit e propozoj Defrim Kafexhiun.
**Kryesuesi:** Faleminderit! Atëherë, i vendosim në votim veç e veç. Kush është "për" Feriz Thaqin nga AAK?... Për Lirigzon Kastratin nga LDK?... Për Melinda Iska Oruqin nga PDK?... Për Defrim Kafexhiun nga LVV?... Atëherë, Feriz Thaqi i ka 12 vota, Lirigzon Kastrati 14 vota, Melinda Iska Oruqi 14 vota dhe Defrim Kafexhiu 9 vota. Atëherë, përbërja e komisionit nga kuvendi i komunës përbëhet nga Lirigzon Kastrati LDK dhe Melinda Iska Oruqi PDK. Dy përfaqësues tjerë do të jenë nga ekzekutivi dhe një nga sektori joqeveritar. E vendosim në votim këtë përbërje, kush është "për"?... Kundër?... Abstenim?... Me 20 vota "për", asnjë kundër dhe asnjë abstenim, votohet katërmbëdhjetë.
**Merisa Sharku:** Pasi që u votua komisioni, unë po paraqitna vullnetare si profesioniste e fushës që ta jap kontribtin tim.
**15. Shqyrtimi i vendimit për miratimin e raportit të komisionit komunal për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera:**
**Besmirë Bytyqi:** I nderuar kryesues, kryetar, këshiltarë komunalë. Ne emailet e juaja e keni pasur raportin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore për vitin 2024. Fatkeqësisht, ende nuk janë paguar dëmet e vitit 2023 nga qeveria. Dëmet e vitit 2023 dhe tani të vitit 2024 do t'i dërgojmë në qeveri ashtu siç kërkohet. Në vitin e kaluar, si pasojë e fatkeqësive natyrore, breshëri dhe erërat e forta, kemi pasur dëme në serra, konstruksione metalike, në bujqësi, në kulturë të vreshtave, në perime etj... Të gjitha të dhënat e sakta i keni në raport. Vlera e dëmeve ka qenë 59.050€ në bujqësi,

ndërsa në ekonomi familjare, 47.715€. Fatkeqësitë natyrore kanë shkaktuar dëme në qytet, në fshatin Nagac, në Krushë, në Opterushë, Dobidol, Çifllak, Celinë dhe Kramovik.
**Lirigzon Kastrati:** Faleminderit drejtoreshë! Kur pritet të ekzekutohen pagesat për këto dëme?
**Besmirë Bytyqi:** Faza e parë e vlerësimit të fatkeqësive natyrore është nga komisioni komunal, ndërsa faza e dytë vlerësohet nga komisioni qeveritar. Vendimi merret nga qeveria e Kosovës dhe fatkeqësisht ende nuk ka marrë vendim për vitin 2023 dhe nuk besojmë që do të ketë vendim as për vitin 2024. Mirëpo, e kemi obligim që këtë raport ta votojmë dhe ta dërgojmë në AME.
**Kryesuesi:** Faleminderit! Atëherë, e vendosim në votim pikën e fundit për këtë mbledhje. Kush është "për"?... Konstatoj që unanimisht (19) votohet pika e fundit për këtë mbledhje. Ju falënderoj për vëmendje dhe githashtu ju uroj festën e Fitër Bajramit.

**Procesmbajtësi:** 

_______________

**Albion Krasniqi**

**K R Y E S U E S I**

_______________

**Arbër Zenuni**

Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic Of Kosovo

Komuna Rahovec / Opština Orahovac / Municipality Rahovec

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu
Nr. i prot / Br. prot. 1273 Më / Dt. 18.04.2025
RAHOVEC - ORAHOVAC

**Drejtoria për Shërbime Publike**
Odeljenje za Opštinske Javne Usluge
Department of Municipal Public Services

| | |
|---|---|
| Datë/Datum/Date: | 18.04.2025 |
| Referenc-ë | |
| Për/Za/To: | Kuvendin e Komunës së Rahovecit |
| CC: | |
| Përmes/Preko/Through: | |
| Nga/Od/From: | z.Përparim Krasniqi, Drejtor për Shërbime Publike |
| Subjekti/Predmet/Subject: | Informatë |

**Informatë mbi implementimin e projektit të mirëmbajtjes dimërore dhe verore të rrugëve në Komunën e Rahovecit**

Komuna e Rahovecit ka kontraktuar 2 kompani për mirëmbajtje të rrugëve gjatë sezonës dimërore dhe verore.

1. Periudha dimërore llogaritet nga data 15 nëntor deri me 15 mars të vitit që vie,
2. Periudha verore llogaritet nga 15 marsi i atij vitit deri me 15 nëntor.

Gjatë sezonës dimërore parashihen të mirëmbahen rrugët nga bora dhe akulli, si dhe hedhja e kripës industriale, ndërsa momentin qe nuk ka borë kompanitë janë të detyruar të bëjnë pastrimin e rrugëve nga mbeturinat.

Ndërsa gjatë sezones verore parashihen të mirëmbahen rrugët duke përfshirë larjen dhe pastrimin e brezave rrugore dhe trotuareve.

Sa i përket mirëmbajtjes dimërore te rrugëve komuna e Rahovecit e ka ndare ne 2 lote mirëmbajtën e rrugëve urbane dhe atyre lokale;

**Lot-1, 258,501.48** euro, KRM Ekoregjioni, kontrata (02.02.20204) eshte 3 vjeqare, janë ne pozicion 106 segmente rrugore per mirëmbajtje dimerore.

**Lot-2, 416,547.80** euro, Eko Drinia, kontrata (02.02.20204) eshte 3 vjeqare, ktu përfshihen pothuajse 33 pozicione apo me mire me then 33 fshatra.

Sa i përket mirëmbajtjes dimerore kemi pasur aktivitet me 24 dhe 25 dhjetor 2024 ku llogaritet periudhe dimerore, ka pasur te resha te mëdha te bores, e ka vazhdu edhe ne vitin 2025 mirepo me intensitet te ulet.

Vazhdimisht kemi publikime te mirëmbajtjes se rrugëve dhe trotuare te gjitha këto bëhen publike përmes rrjeteve sociale.

**Projekti i mirëmbajtjes së hapësirave publike**

Projekti i mirëmbajtjes së hapësirave publike është i specifikuar në kontratat e komunës së Rahovecit ku në masë të madhe janë të përfshira të gjitha hapësirat tjera duke përfshirë, varreza civile, varreza të Dëshmoreve, lapidare, vegjetacione, breza rrugore apo trotuare, përveç kësaj duke pasur parasysh që komuna e Rahovecit kufizohet edhe me rrugë rajonale, shumë shpesh ka ndodhur që komuna ka mirëmbajtur edhe këto rrugë.

Ne çdo vit ka ndryshime në pozicione të caktuara, specifikisht risi është edhe larja dhe lyerja e lapidareve dhe shtatoreve që janë të vendosur në territorin e komunës se Rahovecit.

Ne specifikime teknike është kërkuar qe edhe deponite ilegale te largohen, vetëm kemi filluar me aksione te gjithmbarshme ne komune për eliminimin e deponive ilegale.

Për me shume detaje dhe sqarime tjera, do te jemi te hapur te diskutojmë gjate mbledhjes së Kuvendit të komunës.

Me respekt,

Drejtoria e Shërbimeve Publike

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 5570 Nr. i faq/Br.str/No.pg 59
Data/Datum/Date 8 / 4 / 25
RAHOVEC / ORAHOVAC

# KOMUNA RAHOVEC

# RAPORTI FINANCIAR JANAR-MARS

## 2025



DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

# RAPORTI FINANCIAR JANAR-MARS 2025

Përmbajtja

HYRJE ..... 1

1.0 TË HYRAT VETANAKE ..... 2

1.1 Të hyra të planifikuara, të realizuara dhe krahasimi i tyre 2025/2024 ..... 2

1.2 Të hyrat e rregullta të planifikuara dhe të realizuara në baza mujore 2025/2024 dhe krahasimi i tyre ..... 2

1.3 Krahasimi i të hyrave të rregullta të realizuara në baza mujore 2018-2024. ..... 2

1.4 Krahasimi i të hyrave të realizuara nga gjobat e trafikut dhe gjobat nga gjykatat 2025/2024. ..... 3

1.5 Të hyrat e rregullta, Gjobat e Gjykatave, Gjobat në trafik 2025/2024. ..... 3

1.6 Krahasimi i të hyrave të realizuara sipas kodeve ekonomike 2025/2024 ..... 5

2.0 TATIMI NË PRONË ..... 6

2.1 Planifikimi dhe realizmi i tatimit në pronë 2025/2024 ..... 6

2.2 Shpërndarja e faturave, regjistrimet dhe verifikimet e objekteve në Tatimin në Pronë ..... 6

3.0 REALIZIMI I BUXHETIT ..... 6

3.1 Shpenzimet sipas programeve (drejtoritë) ..... 6

3.2 Shpenzimet sipas kategorive ekonomike dhe paraqitja grafike ..... 8

3.3 Mallra dhe Shërbime sipas programeve ..... 9

3.4 Mallra dhe Shërbime sipas kodeve ekonomike ..... 12

3.5 Shërbime Komunale ..... 13

4.0 RAPORTI I KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA ..... Error! Bookmark not defined.

4.1 Kontratat e nënshkruara në vitin 2024 ..... Error! Bookmark not defined.

5.0 RAPORTI I OBLIGIMEVE TË PAPAGUARA-FINANCIARE ..... Error! Bookmark not defined.

5.1 Mallra dhe Shërbime (Obligimet Financiare) ..... Error! Bookmark not defined.

5.2 Shpenzimet Kapitale (Obligimet Financiare) ..... Error! Bookmark not defined.

5.3 Obligimet Kontraktuale ..... Error! Bookmark not defined.

## HYRJE

Qëllimi i këtij raporti është që të njoftojë Kryetarin, Bordin e drejtorëve, Komitetin për Politikë dhe Financa si dhe Kuvendin Komunal, për realizimin e buxhetit komunal përfshirë buxhetin e secilës Drejtori – Program buxhetor, duke filluar prej programeve të Administratës së përgjithshme, Shëndetësisë primare, Arsimi dhe Shkencë për periudhën Janar–Mars 2025, duke përfshirë kategoritë ekonomike të pagave & mëditjet, mallra dhe shërbimet, shpenzime komunale, subvencione dhe investimet kapitale,obligimet financiare dhe kontraktuale,gjithashtu edhe raporti mbi kontratat e lidhura brenda vititi fiskal.

Realizimin e të hyrave komunale-vetjake dhe strukturën e tyre sipas burimeve të tyre, në mënyrë analitike, të hyrat nga gjobat e trafikut dhe të gjykatave si dhe krahasimi i tyre në raport me te njëjtën periudhë Janar-Dhjetor të vitit 2025/2024

## RAPORTI FINANCIAR JANAR-MARS 2025

Buxheti i Komunës për vitin 2025, nënkupton Buxhetin e aprovuar nga Ministria e Financave,punës dhe transfereve respektivisht Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës për vitin 2025, për komunën e Rahovecit, të aprovuar paraprakisht edhe nga Kuvendi Komunal dhe organet e tij.

Prezantimi i të dhënave në këtë mënyrë mundëson:

- Prezantimin e raportit financiar në formë transparente dhe të tërësishme,
- Shikimin e realizimit, respektivisht shpenzimin e mjeteve sipas kategorive (pagave & mëditjet, mallra dhe shërbimet, shpenzime komunale, subvencione dhe investimet kapitale.
- Mundësin e krahasimit në mes fondit të planifikuar, të alokuar dhe të shpenzuar sipas kategorive, se a është tejkaluar-shfrytëzuar apo nuk është shfrytëzuar fondi i planifikuar, alokuar,
- Shprehja në përqindje e shfrytëzimit të buxhetit në periudhën vjetore.

Në këtë mënyrë nga aspekti financiar është e arsyeshme të paraqitet:

- Realizimi i të hyrave vetjake-komunale sipas burimeve,
- Shpenzimet e krijuara sipas kategorive buxhetore,
- Përqindja e realizimit të buxhetit për këtë periudhë kohore.
- Kontratat e lidhura mrenda vitit fiskal
- Prëzentimi i obligimeve financiare, dhe kontraktuale

Të dhënat e poshtë shënuara, sa i përket shpenzimeve për paga, mallra & shërbime, shërbimeve komunale, subvencioneve, investimeve kapitale si dhe regjistrimi i të hyrave, sipas klasifikimit ekonomik janë të harmonizuara me Departamentin e thesarit të Ministrisë për Financa dhe raportet që dalin nga SIMFK - Sistemi Informativ i Menaxhimit Financiar të Kosovës.

### 1.0 TË HYRAT VETANAKE

1.1 Të hyra të planifikuara, të realizuara dhe krahasimi i tyre 2025/2024

| Përshkrimi | Realizimi 2024 | Realizimi 2025 | Ndryshimi 2025-2024 | Krahasimi 2025/2024 |
|---|---|---|---|---|
| Të hyrat e rregullta | 378,122.54 | 330,214.63 | -47,907.91 | (12.67) |

**-Vërejtje: në këtë tabelë të hyrat e realizuara për vitet 2024 dhe 2025 janë pa gjobat e trafikut dhe gjykatave.**

1.2 Të hyrat e rregullta të planifikuara dhe të realizuara në baza mujore 2025/2024 dhe krahasimi i tyre.
1

1.3 Krahasimi i të hyrave të rregullta të realizuara në baza mujore 2019-2025.

| Periudha | 2019 | 2020 | 2021 | 2022 | 2023 | 2024 | 2025 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Janar | 67,441.16 | 73,433.20 | 79,206.53 | 66,546.55 | 102,903.74 | 108,957.89 | 86,787.87 |
| Shkurt | 101,728.36 | 90,756.67 | 85,381.57 | 68,403.67 | 98,383.47 | 84,560.42 | 91,136.08 |
| Mars | 77,787.87 | 80,321.71 | 116,898.68 | 119,714.06 | 157,671.40 | 184,604.23 | 142,290.68 |
| Totali | 246,957.39 | 244,511.58 | 281,486.78 | 254,664.28 | 358,958.61 | 378,122.54 | 320,214.63 |

1.4 Krahasimi i të hyrave të realizuara nga gjobat e trafikut dhe gjobat nga gjykatat 2025/2024.

**Gjobat në trafik në baza mujore**

| Muajt | Gjobat e trafikut | Gjobat nga e trafikut | Ndryshimi 2025-2024 | % 2025/2024 |
|---|---|---|---|---|
| Janar | 16,295.00 | | -16,295.00 | (100.00) |
| Shkurt | 14,940.00 | | -14,940.00 | (100.00) |
| Mars | 14,940.00 | | -14,940.00 | (100.00) |
| Totali | 46,175.00 | 0.00 | -46,175.00 | -100.00 |

**Vërejtje: në këtë tabelë të hyrat e realizuara për vitin 2025.**

**Gjobat e gjykatës baza mujore**

| Muajt | Gjobat e gjykatave 2024 | Gjobat e gjykatave 2025 | Ndryshimi 2025-2024 | %2025/2024 |
|---|---|---|---|---|
| Janar | 2,382.00 | | -2,382.00 | (100.00) |
| Shkurt | 4,098.66 | | -4,098.66 | (100.00) |
| Mars | 944.33 | | -944.33 | (100.00) |
| **Totali** | **7,424.99** | - | **(7,424.99)** | **(100.00)** |

**Vërejtje: në këtë tabelë të hyrat e realizuara për vitin 2025.**

1.5 Të hyrat e rregullta, Gjobat e Gjykatave, Gjobat në trafik 2025/2024.

| Përshkrimi | Realizimi 2024 | Realizimi 2025 | Ndryshimi 2025-2024 | Krahasimi në %2025/2024 |
|---|---|---|---|---|
| Të hyrat e rregullta | 378,122.54 | 320,214.63 | -57,907.91 | (15.31) |
| Gjobat e gjykatave | 7,424.99 | | -7,424.99 | (100.00) |
| Gjobat e trafikut | 45,545.00 | | -45,545.00 | (100.00) |
| Të hyrat nga pyje | 27.00 | | -27.00 | (100.00) |
| **Totali** | **431,119.53** | **320,214.63** | **-110,904.90** | **(25.72)** |

**Paraqitja Grafike të hyrat 2025/2024**

## RAPORTI FINANCIAR JANAR-MARS 2025



1.6 Krahasimi i të hyrave të realizuara sipas kodeve ekonomike 2025/2024

| | Përshkrimi | Planifikimi 2025 | Realizimi 2024 | Realizimi 2025 | Ndryshimi 2025-2024 | Krahasimi në % 2025/2024 | Realizim/Planifikim 2025 në % |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 40110 | Tatimi në pronë | 567,464.00 | 225,539.57 | 78,036.60 | -147,502.97 | (65.40) | 627.18 |
| 40110 | Tatimi në Tokë | 133,979.00 | - | 82,850.21 | 82,850.21 | #DIV/0! | 61.71 |
| 50001 | Taksa per Regjistrimin e Automjeteve | 140,000.00 | 23,920.00 | 18,160.00 | -5,760.00 | (24.08) | 670.93 |
| 50002 | Taksa rrugore | | 2,630.00 | 9,725.00 | 7,095.00 | 269.77 | (100.00) |
| 50009 | Taksa komunale për leje ndërtimi | 86,000.00 | 6,071.36 | 1,918.52 | -4,152.84 | (68.40) | 4,382.62 |
| 50010 | Taksa për demolim | 34,000.00 | 1,019.00 | 1,813.00 | 794.00 | 77.92 | 1,775.34 |
| 50011 | Taksa regjistrimin e trashigimisë | 40,000.00 | 8,125.00 | 6,895.00 | -1,230.00 | (15.14) | 480.13 |
| 50012 | Taksa për ndrrimin e destinimit të shfrytëzir | 2,000.00 | - | 95.57 | 95.57 | #DIV/0! | 1,992.71 |
| 50013 | Taksa për certifikatat e lindjes | 22,000.00 | 368.00 | 907.00 | 539.00 | 146.47 | 2,325.58 |
| 50014 | Taksa për certifikatat e kurorzimit | 12,000.00 | 2,360.00 | 1,095.00 | -1,265.00 | (53.60) | 995.89 |
| 50015 | Taksa për çertifikatat e vdekjes | 2,000.00 | 399.00 | 195.00 | -204.00 | (51.13) | 925.64 |
| 50016 | Taksa për çertifikatat e tjera të ofiqarisë | 55,000.00 | 10,936.00 | 9,386.40 | -1,549.60 | (14.17) | 485.95 |
| 50017 | Taksa per verifikimin e dokumenteve te nd | 10,800.00 | 6,430.00 | 6,144.00 | -286.00 | (4.45) | 75.78 |
| 50019 | Taksa të tjera administrative | 107,500.00 | 7,528.00 | 7,289.65 | -238.35 | (3.17) | 1,374.69 |
| 50020 | Taksë për pjesëmarrje në tender | 200.00 | - | | 0.00 | #DIV/0! | #DIV/0! |
| 50026 | Takse për legalizimin e objekteve | - | 551.00 | 2,535.32 | 1,984.32 | 360.13 | (100.00) |
| 50029 | Takse për ushtrimin e veprimtarisë | 110,000.00 | 15,102.50 | 8,492.00 | -6,610.50 | (43.77) | 1,195.34 |
| 50032 | Taksa për certicikata të Pronsisë | 25,000.00 | 4,159.00 | 2,561.00 | -1,598.00 | (38.42) | 876.18 |
| 50045 | Leje mjedisore komunale | 20,000.00 | 898.64 | 1,372.60 | 473.96 | 52.74 | 1,357.09 |
| 50103 | Largimi dhe deponimi i automjeteve | 1,500.00 | - | | 0.00 | #DIV/0! | #DIV/0! |
| 50104 | Gjobat nga inspektoriati | 60,000.00 | 8,750.00 | 7,900.00 | -850.00 | (9.71) | 659.49 |
| 50201 | Licencat për aktivitete individuale dhe të lira | 1,500.00 | 170.00 | 175 | 5.00 | 2.94 | 757.14 |
| 50205 | Licencat për pranim teknik të lokalit | 2,000.00 | 375.00 | 300.00 | -75.00 | (20.00) | 566.67 |
| 50206 | Licencat për shërbimet profesionale | 100.00 | 11.00 | 10 | -1.00 | (9.09) | 900.00 |
| 50290 | Licencat tjera për afarizëm | 668.00 | - | | 0.00 | #DIV/0! | #DIV/0! |
| 50401 | Shitja e sherbimeve | 4,800.00 | 248.00 | 250.00 | 2.00 | 0.81 | 1,820.00 |
| 50405 | Shfrytzimi i pronës publike | 12,000.00 | 291.56 | 142.96 | -148.60 | (50.97) | 8,293.96 |
| 50406 | Prona publike për tregti të hapur | | - | | 0.00 | #DIV/0! | #DIV/0! |
| 50407 | Qiraja për vendosjen e objektit tregtar | 112,000.00 | 19,689.79 | 17,510.06 | -2,179.73 | (11.07) | 539.63 |
| 50407 | Qiraja nga objektet e përkoshme (Sh.Publike) | | - | | 0.00 | #DIV/0! | #DIV/0! |
| 50408 | Qiraja nga objektet publike | 5,000.00 | 94.62 | 3,120.74 | 3,026.12 | 3,198.18 | 60.22 |
| 50408 | Qiraja nga objektet publike (Bujqesia) | | - | | 0.00 | #DIV/0! | #DIV/0! |
| 50409 | Participimet-Bujqësia | 30,000.00 | - | 12,800.00 | 12,800.00 | #DIV/0! | 134.38 |
| 50409 | Participimet-Shëndetësia | 85,000.00 | 13,751.50 | 23,260.00 | 9,508.50 | 69.15 | 265.43 |
| 50409 | Participimet-Qerdhja e Femijeve | 80,000.00 | 11,730.00 | 19,531.00 | 7,801.00 | 66.50 | 309.61 |
| 50503 | Inspektimi rrespektimit të planit urbanistik | 10,000.00 | - | | 0.00 | #DIV/0! | #DIV/0! |
| 50504 | Taks për matjen e tokës në teren | 29,000.00 | 6,974.00 | 5,743.00 | -1,231.00 | (17.65) | 404.96 |
| | Taks për mbeturina | 200,000.00 | - | | | | |
| | **Të hyrat pa gjobat** | **2,001,511.00** | **378,122.54** | **330,214.63** | **-47,907.91** | **(12.67)** | **506.12** |
| | Gjobat e gjykatave | | 7,424.99 | | -7,424.99 | (100.00) | #DIV/0! |
| | Gjobat e trafikut | 0 | 45,545.00 | | -45,545.00 | (100.00) | #DIV/0! |
| | Të hyrat nga pyje | 200.00 | 27.00 | | -27.00 | (100.00) | #DIV/0! |
| | **Totali** | **2,001,711.00** | **431,119.53** | **330,214.63** | **-100,904.90** | **(23.41)** | **506.18** |

## 2.0 TATIMI NË PRONË

2.1 Planifikimi dhe realizmi i tatimit në pronë 2025/2024

| Periudha | Të planifikuara | Të realizuara | Të planifikuara | Të realizuara | Përqindja e realizimit | Përqindja e realizimit | Krahasimi në % | Nr. çert të lëshuara | Nr.çert. të lëshuara | Nr faturave të paguara | Nr faturave të paguara |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 2024 | 2024 | 2025 | 2025 | 2024 | 2025 | 2025/2024 | 2024 | 2025 | 2024 | 2025 |
| Janar | 59,034.91 | 57,988.27 | 58,453.58 | 36,774.92 | 98.23 | 62.91 | (36.58) | 831 | 189 | 2323 | 4440 |
| Shkurt | 59,034.91 | 35,143.73 | 58,453.58 | 46,942.16 | 59.53 | 80.31 | 33.57 | 639 | 86 | 1761 | 8113 |
| Mars | 59,034.91 | 132,407.57 | 58,453.58 | 77,169.73 | 224.29 | 132.02 | (41.72) | 732 | 692 | 3920 | 14448 |
| Totali | 177,104.73 | 225,539.57 | 175,360.74 | 160,886.81 | 382.04 | 275.24 | -44.73 | 2,202.00 | 967.00 | 8,004.00 | 27,001.00 |

### Paraqitja grafike 2025/2024




2.2 Shpërndarja e faturave, regjistrimet dhe verifikimet e objekteve në Tatimin në Pronë

| Viti | Nurmi i faturave të shpërndara | Vlera e faturuar | Numri objekteve të reja | Regjistrimet e reja m2 | Numri objekteve të verifikuara | Verifikimi i objeketeve m2 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **2024** | 12,048.00 | 1,468,003.56 | 89 | 13,913 | 1148 | 191,725 |
| **2025** | | 1,267,862.08 | 150 | 29,450 | 0 | 0 |

## 3.0 REALIZIMI I BUXHETIT

3.1 Shpenzimet sipas programeve (drejtoritë)

**Raporti i shpenzimeve sipas programeve (drejtoritë) Janar-Mars 2025**

RAPORTI FINANCIAR JANAR-MARS 2025

| Programet (Drejtoritë) | Pagat dhe mëditjet | Mallrat dhe shërbimet | Shpenzimet komunale | Subvencionet dhe transferet | Shpenzimet kapitalet | Totali i shpenzimeve |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Totali 10+21+22+31-99+04** | **2,779,815.46** | **1,338,551.36** | **90,129.28** | **150,423.77** | **3,332,326.01** | **7,691,245.88** |
| | | | | | | |
| **HUAMARRJA 04** | - | - | - | - | - | - |
| Shendetësia | - | - | - | - | - | - |
| Arsim dhe Shkencë | - | - | - | - | - | - |
| **GRANDI QEVERITAR (10)** | **2,779,815.46** | **1,338,551.36** | **90,129.28** | - | **3,308,673.92** | **7,517,170.02** |
| Zyra e Kryetarit | 49,447.71 | 11,423.86 | - | - | - | 60,871.57 |
| Administrata | 73,945.29 | 40,866.43 | - | - | 29,444.58 | 144,256.30 |
| Çështje Gjinore | 1,921.47 | 281.48 | - | - | - | 2,202.95 |
| Inspekcioni | 26,656.62 | 3,336.53 | - | - | - | 29,993.15 |
| Zyra e Kuvendit Komunal | 64,166.10 | 2,581.39 | - | - | - | 66,747.49 |
| Buxhet dhe Financa | 32,434.29 | 50,402.00 | - | - | 63,388.40 | 146,224.69 |
| Shërbime Publike | 10,260.96 | 508,566.80 | 61,930.53 | - | 915,744.58 | 1,496,502.87 |
| Zjarrëfiksat | 52,744.12 | 4,418.21 | - | - | - | 57,162.33 |
| Zyra për Komunitete | 23,344.32 | 2,691.17 | - | - | - | 26,035.49 |
| Bujqësia | 12,554.34 | 20,200.02 | - | - | 359,716.52 | 392,470.88 |
| Zhvllimi Ekonomik | 15,577.62 | 9,326.35 | - | - | - | 24,903.97 |
| Kadastra dhe Gjeodezia | 21,895.11 | 1,652.03 | - | - | - | 23,547.14 |
| Urbanizmi | 15,416.36 | 280,779.73 | - | - | 823,142.40 | 1,119,338.49 |
| Shëndetësia | 454,601.83 | 208,153.53 | 14,441.38 | - | 119,321.49 | 796,518.23 |
| Shërbimet sociale | 25,139.72 | 3,000.00 | 231.72 | - | 125,000.00 | 153,371.44 |
| Kulturë, Rini dhe Sport | 23,362.08 | 22,339.30 | - | - | 219,007.29 | 264,708.67 |
| Administrata e arsimit | 16,429.46 | 14,994.27 | - | - | - | 31,423.73 |
| Arsimi Parafillor & Qerdhe | 62,513.31 | 11,369.93 | 2,713.75 | - | - | 76,596.99 |
| Arsimi Fillor | 1,452,824.30 | 120,142.49 | 7,041.57 | - | 653,908.66 | 2,233,917.02 |
| Arsimi i Mesëm | 344,580.45 | 22,025.84 | 3,770.33 | - | - | 370,376.62 |
| **TË HYRAT VETANAKE--21** | - | - | - | **150,423.77** | **3,500.00** | **153,923.77** |
| Zyra e Kryetarit | - | - | - | 820.21 | - | 820.21 |
| Administrata | - | - | - | - | - | - |
| Inspekcioni | - | - | - | - | - | - |
| Financa | - | - | - | - | - | - |
| Shërbime Publike | - | - | - | 30,497.71 | - | 30,497.71 |
| Zyra për Komunitete | - | - | - | - | - | - |
| Bujqësia | - | - | - | 89,787.87 | - | 89,787.87 |
| Zhvllimi Ekonomik | - | - | - | - | - | - |
| Kadastra dhe Gjeodezia | - | - | - | - | - | - |
| Urbanizmi | - | - | - | - | 3,500.00 | 3,500.00 |
| Shëndetësia | - | - | - | 14,867.98 | - | 14,867.98 |
| Kulturë, Rini dhe Sport | - | - | - | 14,450.00 | - | 14,450.00 |
| Arsim dhe Shkencë | - | - | - | - | - | - |
| **TE HYRAT E BARTURA-22** | - | - | - | - | - | - |
| Zyra e Kryetarit | - | - | - | - | - | - |
| Administrata | - | - | - | - | - | - |
| Shërbime Publike | - | - | - | - | - | - |
| Bujqësia | - | - | - | - | - | - |
| Zhvllimi Ekonomik | - | - | - | - | - | - |
| Shendetësia | - | - | - | - | - | - |
| Kultur, Rini dhe Sport | - | - | - | - | - | - |
| Arsim dhe Shkencë | - | - | - | - | - | - |
| **DONACIONE 31-99** | - | - | - | - | **20,152.09** | **20,152.09** |
| Zyra e Kryetarit | - | - | - | - | - | - |
| Shërbime Publike | - | - | - | - | 20,152.09 | 20,152.09 |
| Zlk-ja | - | - | - | - | - | - |
| Zhvllimi Ekonomik | - | - | - | - | - | - |
| Shëndetësia | - | - | - | - | - | - |
| Arsim dhe Shkencë | - | - | - | - | - | - |

3.2 Shpenzimet sipas kategorive ekonomike dhe paraqitja grafike

| Kategoritë Ekonomike | Buxheti sipas planifikimit | Buxheti final | Alokimet SIMFK | Shpenzimet | Shpenzim/ Planifikim | Shpenzim/ Alokim |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Pagat dhe mëditjet | 10,746,449.00 | 10,746,449.00 | 2,779,815.46 | 2,779,815.46 | 25.87 | 100.00 |
| Mallrat dhe Shërbimet | 2,761,006.00 | 2,761,100.03 | 2,590,502.03 | 1,338,551.36 | 48.48 | 51.67 |
| Shpenzimet komunale | 390,000.00 | 390,000.00 | 390,000.00 | 90,129.28 | 23.11 | 23.11 |
| Subvencionet dhe transfere | 1,010,000.00 | 1,010,000.00 | 167,787.87 | 150,423.77 | 14.89 | 89.65 |
| Shpenzimet kapitale | 6,075,341.00 | 6,141,464.22 | 5,340,551.30 | 3,332,326.01 | 54.85 | 62.40 |
| TOTALI | 20,982,796.00 | 21,049,013.25 | 11,268,656.66 | 7,691,245.88 | 36.66 | 68.25 |

**Sqarim: Për arsye se kalkulimi është bërë Shpenzim/Planifikim dhe jo Shpenzim/Buxhetin Final, përqindja e shpenzimit e kalon totalin prej 100%**

## Përqindja e realizimit dhe planifikimit të buxhetit për periudhen raportuese




| | Pagat dhe mëditjet | Mallrat dhe Shërbimet | Shpenzimet komunale | Subvencionet dhe transferet | Shpenzimet kapitale | GJITHSEJ |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Buxheti sipas planifikimit | 10,746,449.00 | 2,761,006.00 | 390,000.00 | 1,010,000.00 | 6,075,341.00 | 20,982,796.00 |
| Shpenzimet | 2,779,815.46 | 1,338,551.36 | 90,129.28 | 150,423.77 | 3,332,326.01 | 7,691,245.88 |
| Progresi ne % me planifikim | 25.87 | 48.48 | 23.11 | 14.89 | 54.85 | - |
| Progresi % me alokim | 100.00 | 51.67 | 23.11 | 89.65 | 62.40 | - |

3.3 Mallra dhe Shërbime sipas programeve

| Kodet | Përshkrimi | Zyra e Kryetarit | | Administrata | | Çështje Gjinore | | Inspekcioni | | Kuvendit Komunal | | Buxhet dhe Financa | | TOTALI | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Tabela A | 2024 | 2025 | 2024 | 2025 | 2024 | 2025 | 2024 | 2025 | 2024 | 2025 | 2024 | 2025 | 2024 | 2025 |
| 13140 | Shpenzimet e Udhetimit zyrtar jasht vendit | | 679.00 | | | | | | | | | | | - | 679.00 |
| 13143 | Shpenzimet tjera te udhëtimit zyrtar jasht vendit | | 158.40 | | | | | | | | | | | - | 158.40 |
| 13320 | Shpenzimet e telefonisë mobile | 113.96 | 15.14 | | 208.78 | | | | | | | 40.00 | 50.00 | 153.96 | 273.92 |
| 13330 | Shpenzimet postare | | | | 251.20 | | | | | | | | | - | 251.20 |
| 13340 | Shpenzimet e përdorimit të kabllit optik | | 600.00 | | | | | | | | | | | - | 600.00 |
| 13420 | Shërbimet e përfaqësimit dhe avokatures | 2,081.40 | | | | | | | | | | - | 10,823.33 | 2,081.40 | 10,823.33 |
| 13420 | Shërbimet e përfaqësimit dhe avokatures 21 | | | | | | | | | | | 15,177.50 | | 15,177.50 | - |
| 13440 | Shërbime te ndryshme intelektuale dhe këshilldhënëse | 350.00 | | | | 300.00 | 150.00 | | | | 979.00 | | | 650.00 | 1,129.00 |
| 13445 | Shërbimet e veqanta-konsulentë dhe kontraktorë individual | 1,416.24 | 450.00 | | | | | 708.12 | | 650.00 | | 1,416.24 | 2,250.00 | 4,190.60 | 2,700.00 |
| 13450 | Shërbime shtypje- jo marketing | 169.58 | | 344.82 | 5,033.81 | | | | - | | | 31.25 | | 545.65 | 5,033.81 |
| 13460 | Shërbime Kontraktuese Tjera | | 5,908.04 | 1,409.00 | | | | | 1,060.00 | | | 4,754.58 | 18,040.96 | 6,163.58 | 25,009.00 |
| 13470 | Shërbime Teknike | | | | | | | | | | | 278.57 | | 278.57 | - |
| 13475 | Sigurimi fizik I objekteve publike | | | 611.20 | 3,014.82 | | | | | | | | | 611.20 | 3,014.82 |
| 13480 | Shpenzimet për Antarësim | 3,000.00 | | | | | | | | | | 5,000.00 | | 8,000.00 | - |
| 13504 | Harduer për teknologji informative (me pak se 1000 euro) | | | 2,956.50 | | | | | | | | | | 2,956.50 | - |
| 13610 | Furnizime për zyrë | 2,403.00 | 144.44 | 1,082.50 | 294.10 | | | | | 275.40 | | 344.98 | 605.42 | 4,105.88 | 1,043.96 |
| 13620 | Furnizime me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare) | 63.50 | | 194.90 | 590.33 | | | | | | 57.60 | 63.00 | 52.20 | 321.40 | 700.13 |
| 13720 | Nafte per ngrohje qendrore | | | 5,343.15 | | | | | | | | | | 5,343.15 | - |
| 13760 | Dru | | | | 1,696.00 | | | | | | | | | - | 1,696.00 |
| 13780 | Karburant per vetura | 1,584.14 | 1,359.19 | 224.85 | 1,314.47 | | 131.48 | 898.13 | 730.72 | | | 882.96 | 490.44 | 3,590.08 | 4,026.30 |
| 13950 | Regjistrimi i automjeteve | | | | 75.00 | | | | | | | | | - | 75.00 |
| 13951 | Sigurimi i automjeteve | 373.85 | 374.65 | | 127.02 | | | 440.81 | 440.81 | | 313.79 | 233.10 | 233.10 | 1,047.76 | 1,489.37 |
| 13953 | Sigurimi i ndertesave tjera | | | | 2,268.27 | | | 611.20 | | | | | | 611.20 | 2,268.27 |
| 13954 | Kontrollimi teknik I automjeteve | 30.00 | 30.00 | 30.00 | 60.00 | | | 60.00 | 60.00 | | 30.00 | 60.00 | 30.00 | 180.00 | 210.00 |
| 14010 | Mirembajtja dhe riparimi i automjeteve | 940.00 | 550.00 | 714.00 | 743.00 | | | 550.00 | 1,045.00 | 397.00 | 364.00 | 206.00 | 520.00 | 2,807.00 | 3,222.00 |
| 14022 | Mirembajtja e ndertesave administrative afariste | | | 20,520.53 | 16,616.08 | | | | | | | 98.00 | | 20,618.53 | 16,616.08 |
| 14022 | Mirembajtja e ndertesave administrative afariste--21 | | | | | | | | | | | | 69.60 | - | 69.60 |
| 14024 | Mirembajtja e objekteve shendetesore | | | | 8,087.55 | | | | | | | | | - | 8,087.55 |
| 14060 | Mirembajtja rutinore | | | | | | | | | | | 22,920.00 | | 22,920.00 | - |
| 14220 | Botimet e publikimeve | | 1,155.00 | | | | | | | | | | | - | 1,155.00 |
| 14230 | Shpenzimet per informim publik | | | | | | | | | 1,850.00 | 837.00 | | | 1,850.00 | 837.00 |
| 14310 | Drekat zyrtare | 474.10 | | 1,568.27 | 486.00 | | | | | | | 379.00 | | 2,421.37 | 486.00 |
| 14410 | Shpenzime-vendimet e gjykatave | | | | | | | | | | | | 17,236.95 | - | 17,236.95 |
| | **Totali** | **12,999.77** | **11,423.86** | **34,999.72** | **40,866.43** | **300.00** | **281.48** | **3,268.26** | **3,336.53** | **3,172.40** | **2,581.39** | **51,885.18** | **50,402.00** | **106,625.33** | **108,891.69** |

| Kodet | Përshkrimi | Shërbime Publike | | Zjarrëfikësat dhe Inspektimet | | Zyra për Komunitete | | Bujqësia | | Ekonomia | | Kadastra dhe Gjeodezia | | TOTALI | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Tabela B | 2024 | 2025 | 2024 | 2025 | 2024 | 2025 | 2024 | 2025 | 2024 | 2025 | 2024 | 2025 | 2024 | 2025 |
| 13320 | Shpenzimet e telefonisë mobile | | | 110.49 | 14.07 | | | | | | | 19.98 | 19.98 | 130.47 | 34.05 |
| 13440 | Shërbime te ndryshme intelektuale dhe këshilldhënëse | | | 450.00 | 200.00 | 2,245.00 | 2,053.00 | | | | | | | 2,695.00 | 2,253.00 |
| 13445 | Shërbimet e veqanta-konsulentë dhe kontraktorë individual | | | | | | | 2,124.36 | 3,600.00 | 708.12 | 870.00 | 708.12 | 870.00 | 3,540.60 | 5,340.00 |
| 13450 | Shërbime shtypje- jo marketing | | | | | | | 12.74 | | 25.17 | | 21.27 | | 59.18 | - |
| 13460 | Shërbime Kontraktuese Tjera | 1,000.00 | | | | | | 36,179.96 | 3,000.00 | 3,691.28 | | | | 40,871.24 | 3,000.00 |
| 13470 | Shërbime Teknike | | | | | | 185.00 | | | | | | | - | 185.00 |
| 13480 | Shpenzimet për Antarësim | 7,000.00 | | | | | | | | | | | | 7,000.00 | - |
| 13504 | Harduer për teknologji informative (me pak se 1000 euro) | | 62,585.37 | | | | | | | | | | | - | 62,585.37 |
| 13610 | Furnizime për zyrë | 64.00 | | | | | 182.00 | | 1,050.55 | 98.00 | 1,071.38 | 962.10 | 96.30 | 1,124.10 | 2,400.23 |
| 13620 | Furnizime me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare) | | | | | | | 217.94 | 55.00 | | 1,429.79 | | | 217.94 | 1,484.79 |
| 13760 | Dru | | | | 375.73 | | | | | | | | | - | 375.73 |
| 13780 | Karburant per vetura | 241.28 | 69.15 | 999.95 | 1,513.35 | 339.39 | 271.17 | 274.53 | 180.66 | 198.99 | 80.71 | 299.41 | 366.73 | 2,353.55 | 2,481.77 |
| 13950 | Regjistrimi i automjeteve | 75.00 | | 85.00 | | | | | | 75.00 | | | | 235.00 | - |
| 13950 | Regjistrimi i automjeteve - 21 | | 150.00 | | | | | | | | 75.00 | | | - | 225.00 |
| 13951 | Sigurimi i automjeteve | 440.81 | 440.81 | 795.23 | 795.23 | | | 440.81 | 440.81 | | | 127.02 | 127.02 | 1,803.87 | 1,803.87 |
| 13954 | Kontrollimi teknik I automjteve | 60.00 | 60.00 | 160.00 | 50.00 | | | 30.00 | 80.00 | | | 30.00 | 30.00 | 280.00 | 220.00 |
| 14010 | Mirembajtja dhe riparimi i automjeteve | 345.00 | | 760.00 | 45.00 | 121.00 | | 548.00 | 793.00 | | 114.00 | 149.00 | 142.00 | 1,923.00 | 1,094.00 |
| 14020 | Mirembajtja e ndertesave | | | | | | | 95.00 | | | | 98.00 | | 193.00 | - |
| 14022 | Mirembajtja e ndertesave administrative afariste | - | | | | | | | | 804.60 | 1,609.52 | | | 804.60 | 1,609.52 |
| 14022 | Mirembajtja e ndertesave administrative afariste--21 | 10,000.00 | | | | | | | | | | | | 10,000.00 | - |
| 14032 | Mirembajtja e auto rrugeve lokale | 91,832.88 | 84,281.78 | | | | | | | | | | | 91,832.88 | 84,281.78 |
| 14050 | Mirembajtja e mobileve dhe paisjeve | | | | 1,424.83 | | | | | | | | | - | 1,424.83 |
| 14060 | Mirembajtja rutinore-21 | 43,962.95 | | | | | | | | | | | | 43,962.95 | - |
| 14060 | Mirembajtja rutinore | | 182,490.62 | | | | | | | | 1,652.95 | | | - | 184,143.57 |
| 14310 | Drekat zyrtare | 74.10 | | | | | | | | | | | | 74.10 | - |
| 14410 | Shpenzime-vendimet e gjykatave | | | | | | | | 11,000.00 | | 2,423.00 | | | - | 13,423.00 |
| 14410 | Shpenzime-vendimet e gjykatave-21 | | 178,489.07 | | | | | | | | | | | - | 178,489.07 |
| | | 155,096.02 | 508,566.80 | 3,360.67 | 4,418.21 | 2,705.39 | 2,691.17 | 39,923.34 | 20,200.02 | 5,601.16 | 9,326.35 | 2,414.90 | 1,652.03 | 209,101.48 | 546,854.58 |

| Kodet | Përshkrimi | Urbanizmi | | Shëndetësia dhe Mirëqenie sociale | | Qendra për punë sociale | | Kulturë,Rini dhe Sport | | Arsimi | | Totali | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Tabela C | 2024 | 2025 | 2024 | 2025 | 2024 | 2025 | 2024 | 2025 | 2024 | 2025 | 2024 | 2025 |
| 13130 | Shpenzimet e Udhetimit zyrtar brenda vendit | | | | | | | | | 8,570.13 | 11,003.00 | 8,570.13 | 11,003.00 |
| 13310 | Shpenzimet për internet | | | | | | | | | 307.63 | 492.26 | 307.63 | 492.26 |
| 13320 | Shpenzimet e telefonisë mobile | | | | | | | 260.08 | | | | 260.08 | - |
| 13420 | Shërbimet e përfaqësimit dhe avokatures | | 10,052.67 | | | | | | | | | - | 10,052.67 |
| 13430 | Shërbime te ndryshme shendetësore | | | 60.00 | 120.00 | | | | | | | 60.00 | 120.00 |
| 13440 | Shërbime te ndryshme intelektuale dhe këshilldhënëse | | | | | | 50.00 | 1,416.24 | | 200.00 | 100.00 | 1,616.24 | 350.00 |
| 13445 | Shërbimet e veçanta-konsulentë dhe kontraktorë individual | | | | | | | | 1,800.00 | | 1,800.00 | - | 3,600.00 |
| 13450 | Shërbime shtypje- jo marketing | 40.26 | | | | | | 6.70 | | | | 6.96 | - |
| 13460 | Shërbime Kontraktuese Tjera | 64,784.54 | 81,910.42 | | 413.30 | | 826.60 | 72.00 | | 1,380.00 | | 66,236.54 | 83,150.32 |
| 13475 | Sigurimi fizik I objekteve publike | | | | 3,047.59 | | | | | | | - | 3,047.59 |
| 13470 | Shërbime Teknike | 109.74 | 16,200.00 | | 170.00 | | | 800.00 | 7,616.00 | | | 909.74 | 23,986.00 |
| 13480 | Shpenzimet për Antarësim | | 8,431.20 | | | | | | | | | - | 8,431.20 |
| 13508 | Pajisje trafiku (me pak se 1000 euro) | 10,010.00 | | | | | | | | | | 10,010.00 | - |
| 13509 | Pajisje tjera (me pak se 1000 euro) | | | 19,624.75 | | | | | | | 693.00 | 19,624.75 | 693.00 |
| 13610 | Furnizime për zyrë | 2,074.50 | | 19,675.25 | 6,926.68 | 494.38 | 1,000.00 | 1,472.90 | | 5,901.85 | 5,047.99 | 29,618.88 | 12,974.67 |
| 13620 | Furnizime me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare) | | | 237.60 | | | 390.03 | | | 3,881.41 | 7,620.83 | 4,119.01 | 8,010.86 |
| 13630 | Furnizime mjekësore | | | 10,646.33 | 53,227.63 | | | | | | | 10,646.33 | 53,227.63 |
| 13640 | Furnizime pastrimi | | | 141.00 | 541.22 | | | | | 99.00 | 1,190.70 | 240.00 | 1,731.92 |
| 13720 | Nafte per ngrohje qendrore | | | 7,598.60 | | 633.50 | | | | | | 8,232.10 | - |
| 13760 | Dru | | | 17,968.00 | 5,154.00 | | | 1,950.00 | 740.00 | 212,127.10 | 133,071.84 | 232,045.10 | 138,965.84 |
| 13780 | Karburant per vetura | 245.51 | 26.49 | 12,428.74 | 18,062.10 | 652.01 | 223.37 | 297.54 | 214.88 | 295.45 | 493.84 | 13,919.25 | 19,120.68 |
| 13950 | Regjistrimi i automjeteve | | | 225.00 | 330.00 | 75.00 | 310.00 | | | | | 300.00 | 640.00 |
| 13951 | Sigurimi i automjeteve | 127.02 | 127.02 | 268.96 | 3,671.14 | | | | | 127.02 | 127.02 | 523.00 | 3,925.18 |
| 13953 | Sigurimi i ndertesave tjera | | | 2,750.40 | 6,095.18 | | | | | | | 2,750.40 | 6,095.18 |
| 13954 | Kontrollimi teknik I automjteve | 30.00 | 30.00 | | | | | | | 30.00 | 30.00 | 60.00 | 60.00 |
| 14010 | Mirembajtja dhe riparimi i automjeteve | 312.00 | 786.00 | 4,619.40 | 8,625.20 | 123.00 | | 67.50 | 330.00 | | | 5,121.90 | 9,741.20 |
| 14020 | Mirembajtja e ndertesave | | | | | | | 1,038.14 | | | | 1,038.14 | - |
| 14022 | Mirembajtja e ndertesave administrative afariste | 4,090.00 | 6,028.50 | | | | | | | | | 4,090.00 | 6,028.50 |
| 14023 | Mirembajtja e shkollave | | | | | | | | | 964.90 | 2,993.20 | 964.90 | 2,993.20 |
| 14024 | Mirembajtja e objekteve shendetesore | | | 23,961.95 | 48,603.95 | | | | | | | 23,961.95 | 48,603.95 |
| 14026 | Mirembajtja e objekteve sportive | | | | | | | | 883.92 | | | - | 883.92 |
| 14027 | Mirembajtja e objekteve kulturore | | | | | | | 2,087.00 | 6,221.00 | | | 2,087.00 | 6,221.00 |
| 14040 | Mirëmbajtja e Teknologjisë Informative | | | | | | | | | 99.00 | 99.00 | 99.00 | 99.00 |
| 14050 | Mirembajtja e mobileve dhe paisjeve | | | 8,317.00 | | | | | | | 387.00 | 8,317.00 | 387.00 |
| 14050 | Mirembajtja e mobileve dhe paisjeve-21 | | | | | | | | | | | - | - |
| 14060 | Mirembajtja rutinore | | 18,267.72 | | | | | | | | | - | 18,267.72 |
| 14210 | Reklamat dhe konkurset | | | | | | | | | | 98.00 | - | 98.00 |
| 14310 | Drekat zyrtare | 101.80 | | | 158.60 | | | 651.90 | 533.50 | | | 753.70 | 692.10 |
| 14410 | Shpenzime-vendimet e gjykatave | | 138,819.71 | 10,108.28 | 53,006.94 | | | | | | 3,284.85 | 10,108.28 | 195,111.50 |
| 14410 | Shpenzime-vendimet e gjykatave---22 | | | | | | | | 4,000.00 | | | - | 4,000.00 |
| | | 81,925.37 | 280,779.73 | 138,631.26 | 208,153.53 | 1,977.89 | 3,000.00 | 10,120.00 | 22,339.30 | 233,983.49 | 168,532.53 | 466,638.01 | 682,805.09 |
| | Tabela A+B+C | | | | | | | | | | | 782,364.82 | 1,338,551.36 |
| | Krahasimi 2025/2024 | | | | | | | | | | | 71.09 | |

3.4 Mallra dhe Shërbime sipas kodeve ekonomike

| Kode | Përshkrimi | 2024 | 2025 | Diferenca | Krahasimi ne % |
|---|---|---|---|---|---|
| 13130 | Shpenzimet e Udhetimit zyrtar brenda vendit | 8,570.13 | 11,003.00 | 2,432.87 | 28.39 |
| 13140 | Shpenzimet e Udhetimit zyrtar jasht vendit | 0.00 | 679.00 | 679.00 | #DIV/0! |
| 13143 | Shpenzimet tjera te udhëtimit zyrtar jasht vendit | 0.00 | 158.40 | 158.40 | #DIV/0! |
| 13310 | Shpenzimet për internet | 307.63 | 492.26 | 184.63 | 60.02 |
| 13320 | Shpenzimet e telefonisë mobile | 544.51 | 307.97 | (236.54) | (43.44) |
| 13330 | Shpenzimet postare | 0.00 | 251.20 | 251.20 | #DIV/0! |
| 13340 | Shpenzimet e përdorimit të kabllit optik | 0.00 | 600.00 | 600.00 | #DIV/0! |
| 13420 | Shërbimet e përfaqësimit dhe avokatures | 2,081.40 | 20,876.00 | 18,794.60 | 902.98 |
| 13420 | Shërbimet e përfaqësimit dhe avokatures 21 | 15,177.50 | 0.00 | (15,177.50) | (100.00) |
| 13430 | Shërbime te ndryshme shendetësore | 60.00 | 120.00 | 60.00 | 100.00 |
| 13440 | Shërbime te ndryshme intelektuale dhe këshilldhënëse | 4,961.24 | 3,732.00 | (1,229.24) | (24.78) |
| 13445 | Shërbimet e veqanta-konsulentë dhe kontraktorë individual | 7,731.20 | 11,640.00 | 3,908.80 | 50.56 |
| 13450 | Shërbime shtypje- jo marketing | 651.79 | 5,033.81 | 4,382.02 | 672.31 |
| 13460 | Shërbime Kontraktuese Tjera | 113,271.36 | 111,159.32 | (2,112.04) | (1.86) |
| 13470 | Shërbime Teknike | 1,188.31 | 24,171.00 | 22,982.69 | 1,934.07 |
| 13475 | Sigurimi fizik I objekteve publike | 611.20 | 6,062.41 | 5,451.21 | 891.89 |
| 13480 | Shpenzimet për Antarësim | 15,000.00 | 8,431.20 | (6,568.80) | (43.79) |
| 13504 | Harduer për teknologji informative (me pak se 1000 euro) | 2,956.50 | 62,585.37 | 59,628.87 | 2,016.87 |
| 13508 | Pajisje trafiku (me pak se 1000 euro) | 10,010.00 | 0.00 | (10,010.00) | (100.00) |
| 13509 | Pajisje tjera (me pak se 1000 euro) | 19,624.75 | 693.00 | (18,931.75) | (96.47) |
| 13610 | Furnizime për zyrë | 34,848.86 | 16,418.86 | (18,430.00) | (52.89) |
| 13620 | Furnizime me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare) | 4,658.35 | 10,195.78 | 5,537.43 | 118.87 |
| 13630 | Furnizime mjekësore | 10,646.33 | 53,227.63 | 42,581.30 | 399.96 |
| 13640 | Furnizime pastrimi | 240.00 | 1,731.92 | 1,491.92 | 621.63 |
| 13720 | Nafte per ngrohje qendrore | 13,575.25 | 0.00 | (13,575.25) | (100.00) |
| 13760 | Dru | 232,045.10 | 141,037.57 | (91,007.53) | (39.22) |
| 13780 | Karburant per vetura | 19,862.88 | 25,628.75 | 5,765.87 | 29.03 |
| 13950 | Regjistrimi i automjeteve | 535.00 | 715.00 | 180.00 | 33.64 |
| 13950 | Regjistrimi i automjeteve-21 | 0.00 | 225.00 | 225.00 | #DIV/0! |
| 13951 | Sigurimi i automjeteve | 3,374.63 | 7,218.42 | 3,843.79 | 113.90 |
| 13953 | Sigurimi i ndertesave tjera | 3,361.60 | 8,363.45 | 5,001.85 | 148.79 |
| 13954 | Kontrollimi teknik I automjeteve | 520.00 | 490.00 | (30.00) | (5.77) |
| 14010 | Mirembajtja dhe riparimi i automjeteve | 9,851.90 | 14,057.20 | 4,205.30 | 42.69 |
| 14020 | Mirembajtja e ndertesave | 1,231.14 | 0.00 | (1,231.14) | (100.00) |
| 14022 | Mirembajtja e ndertesave administrative afariste | 25,513.13 | 24,254.10 | (1,259.03) | (4.93) |
| 14022 | Mirembajtja e ndertesave administrative afariste--21 | 10,000.00 | 69.60 | (9,930.40) | (99.30) |
| 14023 | Mirembajtja e shkollave | 964.90 | 2,993.20 | 2,028.30 | 210.21 |
| 14023 | Mirembajtja e shkollave 21 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | #DIV/0! |
| 14024 | Mirembajtja e objekteve shendetesore | 23,961.95 | 56,691.50 | 32,729.55 | 136.59 |
| 14024 | Mirembajtja e objekteve shendetesore 31 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | #DIV/0! |
| 14026 | Mirembajtja e objekteve sportive | 0.00 | 883.92 | 883.92 | #DIV/0! |
| 14027 | Mirembajtja e objekteve kulturore | 2,087.00 | 6,221.00 | 4,134.00 | 198.08 |
| 14030 | Mirembajtaj e auto rrugeve | 0.00 | 0.00 | 0.00 | #DIV/0! |
| 14032 | Mirembajtja e auto rrugeve lokale | 91,832.88 | 84,281.78 | (7,551.10) | (8.22) |
| 14040 | Mirëmbajtja e Teknologjisë Informative | 99.00 | 99.00 | 0.00 | 0.00 |
| 14050 | Mirembajtja e mobileve dhe paisjeve | 8,317.00 | 1,811.83 | (6,505.17) | (78.22) |
| 14050 | Mirembajtja e mobileve dhe paisjeve- 21 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | #DIV/0! |
| 14060 | Mirembajtja rutinore | 22,920.00 | 202,411.29 | 179,491.29 | 783.12 |
| 14060 | Mirembajtja rutinore-21 | 43,962.95 | 0.00 | (43,962.95) | (100.00) |
| 14210 | Reklamat dhe konkurset | 0.00 | 98.00 | 98.00 | #DIV/0! |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 14220 | Botimet e publikimeve | 0.00 | 1,155.00 | 1,155.00 | #DIV/0! |
| 14230 | Shpenzimet per informim publik | 1,850.00 | 837.00 | (1,013.00) | (54.76) |
| 14230 | Shpenzimet per informim publik 21 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | #DIV/0! |
| 14310 | Drekat zyrtare | 3,249.17 | 1,178.10 | (2,071.07) | (63.74) |
| 14410 | Shpenzime-vendimet e gjykatave | 10,108.28 | 225,771.45 | 215,663.17 | 2,133.53 |
| 14410 | Shpenzime-vendimet e gjykatave----21 | 0.00 | 178,489.07 | 178,489.07 | #DIV/0! |
| 14410 | Shpenzime-vendimet e gjykatave----22 | 0.00 | 4,000.00 | 4,000.00 | #DIV/0! |
| | **Totali** | **782,364.82** | **1,338,551.36** | **556,186.54** | **71.09** |
| | **Diferenca e shprehur ne %** | 71.09 | | | |

Paraqitja grafike e raporti për Mallra dhe Shërbime sipas kodeve ekonomike Janar-Dhjetor 2024/2025 dhe krahasimi i tyre në përqindje.




3.5 Shërbime Komunale

| | Rryma (13210) | | Uji (13220) | | Mbeturinat (13230) | | Telefon Internet 13250 | | Pagesat Gjzqesore 13260 | | Totali | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Programet (drejtoritë)** | **2024** | **2025** | **2024** | **2025** | **2024** | **2025** | **2024** | **2025** | **2024** | **2025** | **2024** | **2025** |
| Shërbime Publike | 48,083.87 | 36,830.21 | 1,460.65 | 36.00 | 455.48 | 294.40 | | | | 24769.92 | **50,000.00** | **61,930.5** |
| Shëndetësia | 18,624.54 | 7,313.38 | 1,073.67 | 0.00 | 128.00 | 128.00 | 173.79 | | | 7000.00 | **20,000.00** | **14,441.3** |
| Qendra per pune Sociale | 426.06 | 0.00 | 339.67 | 0.00 | 0.00 | | 234.27 | 231.72 | | | **1,000.00** | **231.72** |
| Arsim dhe Shkencë | 7,565.03 | 8,781.32 | 3,288.44 | 3,069.63 | 1,510.42 | 1,588.08 | 328.73 | 86.62 | | | **12,692.62** | **13,525.6** |
| **Totali** | **74,699.50** | **52,924.91** | **6,162.43** | **3,105.63** | **2,093.90** | **2,010.48** | **736.79** | **318.34** | **0.00** | **31,769.92** | **83,692.62** | **90,129.2** |

**Drejtoria për Buxhet dhe Financa:** ____________________

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Kuvendi i Komunës Rahovec***
*Skupština Opštine Orahovac / Municipal Assambly of Rahovec*

---

# Raporti nga procesi i organizimit të konsultimit publik për Rregulloren për Transparencë për Komunën e Rahovecit

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 5488 Nr. i faq/Br.str/No.pg 51
Data/Datum/Date 27/03/25
RAHOVEC / ORAHOVAC

**Mars 2025**

## Hyrje

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës së Rahovecit. Nr. 1005 i datës, 29.3.2017 si dhe nenit 31 të Udhëzimit Administrativ MAPL Nr.04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna, Zyra për Informim organizoi konsultimin publik për Rregulloren për transparencë për Komunën e Rahovecit.

Zyra për informim e ka bërë njoftimin sa i përket organizimit të konsultimin publik për Rregulloren për transparencë për Komunën e Rahovecit, në linkun https://rahovec.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/03/Njoftim-per-organizimin-e-konsultimit-publik-per-Rregulloren-per-Transparence-per-Komunen-e-Rahovecit.pdf

Ftesat dhe njoftimet për mbajtjen e dëgjimit buxhetor janë shpërndarë me kohë (14 ditë) para mbajtjes së dëgjimit, përmes email adresave, në facebook zyrtar të Komunës https://www.facebook.com/share/p/1BMsAUx3ua/ dhe në ueb faqen zyrtare u publikua njoftimi https://rahovec.rks-gov.net/news/lidhur-me-organizimin-e-konsultimit-publik-per-rregulloren-per-transparence-per-komunen-e-rahovecit/ si dhe u rikujtua disa herë https://www.facebook.com/share/p/16N17qspgH/ .

Disa nga anëtarët e grupit punues kanë qenë pjesëmarrës në konsultim, por, **për shkak të mospjesëmarrjes së qytetarëve, ky dëgjim konsultim publik, ka dështuar, të bashkangjitur e gjeni lajmin për mosmbajtje të konsultimit publik:** https://rahovec.rks-gov.net/news/deshton-konsultimi-publik-per-rregulloren-per-transparence/

Poashtu personat përgjegjës të cekur në njoftim nuk kanë pranuar asnjë kërkesë në emalat e tyre.

Blerta Gashi
______________________

Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo

*Komuna e Rahovecit*

*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 12.2 pika c) dhe nenit 40 paragrafi 40.2 pika a) të Ligjit Nr. 03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 10 paragrafi 2 pika 2.3 dhe nenit 40 paragrafi 2 pika 2.1 Statutin e Komunës së Rahovecit. Nr. 1005 i datës, 29.3.2017 si dhe Udhëzimit Administrativ MAPL Nr.04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna, në mbledhjen e mabjtur me datë 00.00.2025 Kuvendi i Komunës së Rahovecit, miraton këtë:

# RREGULLORE PËR TRANSPARENCË NË KOMUNËN E RAHOVECIT

## KAPITULLI I

## DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

### Neni 1

### Qëllimi

1. Kjo Rregullore përcakton rregullat që sigurojnë transparencë të punës së organeve komunale, kryetarit të komunës, drejtorive, kuvendit, trupave të kuvendit si dhe mekanizmave të tjerë ligjor, si dhe rregullat, parimet dhe format e përfshirjes së qytetarëve, shoqërisë civile dhe grupeve të interesit në proceset vendimmarrëse

### Neni 2

### Fushëveprimi

1.Dispozitat e kësaj Rregulloreje zbatohen për të gjitha organet e komunës që ushtrojnë autorizime publike sipas ligjit.

### Neni 3

### Përkufizimet

1.Shprehjet dhe shkurtesat e përdorura në këtë Rregullore kanë këto kuptime:

1.1.**Transparencë** - Transparenca është veprimtari e hapur e organeve të komunës që siguron publikim, informim, qasje në dokumente publike dhe përfshirjen e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes dhe punës së organeve komunale.

1.2. **Akte normative të komunës** – nënkupton akte normative të karakterit të përgjithshëm të tilla si: Statuti i Komunës, rregulloret e Kuvendit të Komunës, planet hapësinore në nivel lokal, aktet të tjera që parashihen me ligjet sektoriale.

1.3. **Llogaridhënie** – nënkupton procesin ku institucionet komunale japin përgjegjësi për ushtrimin e kompetencave të tyre

1.4. **Vendim** – nënkupton akt normativ që nxirret nga organi kompetent i komunës sipas dispozitave ligjore me të cilin vendoset për çështje të caktuar.

1.5. **Konsultim publik** – nënkupton përfshirjen e qytetarëve dhe palëve të interesuara në procesin konsultues para vendimmarrjes

1.6. **Buxhetim me pjesëmarrje** - nënkupton një proces demokratik dhe gjithpërfshirës, i cili u mundëson qytetarëve të kenë rol të drejtpërdrejtë vendimmarrës, për të planifikuar shpërndarjen e buxhetit të komunës, sipas prioriteteve të qytetarëve.

1.7. **Dëgjim buxhetor** – nënkupton konsultimet publike të mbajtura nga komunat në procesin e hartimit të buxhetit dhe projeksioneve afatmesme buxhetore.

1.8. **Dokument publik** – nënkupton çdo akt, fakt apo informatë në formë elektronike apo me zë, formë të shtypur, në incizime vizuale apo audiovizuale të prodhuara apo mbajtura nga institucioni publik.

1.9. **Grupi punues** – është ekipi përgjegjës për hartimin e projekt propozimit, i caktuar nga organi kompetent i komunës.

1.10. **Live meeting office comunicator apo transmetime direkte në youtube apo rrjetet sociale** – nënkupton aplikacione përmes së cilave mundësohet komunikimi në distancë.

1.11. **Sesion i teleprezencës** - nënkupton akceptimin i e - mailit të dërguar nga komunat për qasje në formatin përkatës. -

1.12. **Sistemi operativ** MS Windows 7nënkupton sistem operativ i teknologjisë së Microsoftit.-

1.13. **MAPL** – nënkupton Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal. -

1.14. **Monitorim i kuvendit të komunës përmes teleprezencës** - nënkupton të drejtën dhe mundësinë e MAPL-së që përmes pajisjeve të teleprezencës të siguroj mbikëqyrjen e mbarëvajtjes së mbledhjeve të kuvendeve të komunave pa praninë fizike të zyrtarëve në komunë.

1.15. **Pajijse për transmetim dhe monitorim të mbledhjeve** - nënkupton kamerë e përshtatshme për teleprezencë që mundëson transmetimin e mbledhjeve me pamje të kompletuar përmes video dhe audio përmbajtjes;

1.16. **Palë e interesuar** – nënkupton çdo person fizik dhe juridik, organizatë e shoqërisë civile, grupe të ndryshme të interesit, si dhe subjekte të tjera që ndikohen apo janë të interesuara të ndikojnë drejtpërdrejt apo tërthorazi në procesin e vendimmarrjes.

1.17.**Projekt-propozim apo Projekt-akt** - nënkupton të gjitha dokumentet dhe aktet normative të cilat janë në proces të hartimit dhe që i nënshtrohen procesit të konsultimit publik para aprovimit të tyre.

1.18. **Propozues i akteve nënligjore të komunës dhe politikave lokale** – nënkupton: kryetarin e komunës, drejtoritë komunale, kryesuesin e kuvendit të komunës, komitetet e kuvendit të komunës, pesëmbëdhjetë për qind (15%) e qytetarëve të komunës përkatëse me të drejtë vote.

1.19. **Politika lokale** – i referohet, planeve, dokumenteve strategjike, buxhetit të komunës, Korniza Afatmesme Buxhetore, planeve hapësinore në nivel lokal, akteve komunale, strategjive të zhvillimit në kuadër të fushave specifike zhvillimore, udhëzuesve dhe veprimeve të cilat ndikojnë në vendimmarrjen komunale, planeve të punës së kuvendit dhe ekzekutivit, si dhe programeve të tjera të rëndësishme me interes publik.

1.20. **Pronë komunale** - nënkupton pronën e luajtshme dhe të paluajtshme të regjistruar dhe në posedim të komunës.

1.16. **Standardet minimale të konsultimit** - janë rregulla procedurale minimale që kanë për qëllim zhvillimin e konsultimeve publike efikase gjatë procesit të hartimit të politikave dhe akteve normative nga komunat, me përfshirje të palëve të interesuara dhe qytetarëve, përveç nëse parashihet ndryshe me legjislacionin në fuqi.

1.21. **Takim publik me qytetar** – nënkupton takime të rregullta publike të karakterit informues me qytetarë sipas nenit 68 parag.1 të Ligjit Nr.03L-040 për Vetëqeverisje Lokale.

1.22. **Zyrtar përgjegjës për qasje në dokumente publike** - nënkupton zyrtar administrativ në kuadër të institucionit publik, i caktuar për pranimin dhe regjistrimin e kërkesave të pranuara për qasje në dokumente publike, për kryerjen e shqyrtimit fillestar të këtyre kërkesave, për ruajtjen dhe mbajtjen e evidencave të këtyre kërkesave dhe për raportimin rreth këtyre kërkesave.

1.23. **Zyrtari për Monitorim** - nënkupton zyrtarin përgjegjës për monitorim të komunave në MAPL.

2. Shprehjet e përdorura në shumës e kanë të njëjtin kuptim edhe në njëjës, dhe shprehjet e përdorura në një gjini e kanë kuptimin e njëjtë edhe për gjininë tjetër.

## KAPITULLI II

## TRANSPARENCA E PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS

### Neni 4

### Transparenca në mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe komiteteve

1. Të gjitha mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe komiteteve janë publike, përveç rasteve kur kufizimi është përcaktuar me ligj.

2. Kryesuesi i Kuvendit ose kryesuesi i komitetit, përmes shërbimit të administratës ofron kushtet, mjetet, materialet dhe vendin e caktuar për të garantuar pjesëmarrjen e publikut.

3.Kryesuesi i Kuvendit ose Komitetit, përmes Njësisë për Komunikim Publik obligohet të publikoj në ueb faqen zyrtare të gjitha aktet dhe vendimet e Kuvendit dhe trupave të tjera.

## Neni 5

## Informimi për mbledhjet e kuvendit dhe komiteteve

1. Kryesuesi i Kuvendit ose Komitetit, përmes Njësisë për Komunikim me Publikun, publikon njoftimin për mbledhje së paku 7 (shtatë) ditë pune para mbledhjeve të rregullta, 3 (tre) ditë pune para mbledhjeve të jashtëzakonshme, si dhe brenda ditës për mbledhjet urgjente.

2. Njoftimi për mbledhje nga paragrafi 1 i këtij neni bëhet përmes:

2.1. Ueb-faqes zyrtare të komunës dhe tabelat e shpalljeve.

2.2. Me qëllim të arritjes së audiencës komuna promovon agjendën në rrjete sociale, dhe forma alternative të komunikimit me publikun.

3. Njoftimi publik sipas paragrafit 2 të këtij neni përmban:

3.1. Datën, kohën vendin, rendin e ditës, materialet e mbledhjes për mbajtje të takimit.

3.2. Komuna publikon edhe të dhëna të tjera të cilat përcaktohen me Statut dhe Rregullore të Punës së Komunës.

4. Kryesuesi i Kuvendit me shkresë zyrtare me informacionet sipas paragrafit 1 dhe 3 të këtij neni e njofton Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal për mbledhje të kuvendit.

5. Komuna përveç informimit për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit dhe të Komiteteve vazhdimisht duhet ti njoftojë që qytetarët kanë të drejtë të jenë pjesë e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.

## Neni 6

## Monitorimit elektronik i mbledhjeve të Kuvendeve të Komunave

1. Organet e Komunës janë të obliguara të sigurojnë qasje aktive në përdorimin e sistemit të teleprezencës, me qëllim të krijimit të kushteve për monitorim dhe vlerësim të proceseve për mekanizmat monitoruese të MAPL-së, palëve të interesuara dhe institucioneve tjera në mbledhjet e Kuvendit të Komunës, përmes stafit të autorizuar të komunës.

2. Komuna mund të përdorë aplikacione si live meeting office comunicator apo transmetime direkte në you-tube apo rrjetet sociale për të garantuar publicitet, si dhe çfarëdo platforme të ligjshme për të transmetuar drejtpërdrejtë ngjarjen.

3. Kryesuesi, anëtarët e Kuvendit të Komunës, Kryetari, dhe pjesëmarrësit e tjerë janë të obliguar që gjatë rrjedhës së punimeve të Kuvendit të përdorin mikrofonin i cili mundëson lidhjen me sistemin e zërimit dhe transmetimin e audio – përmbajtjes në sistem.

## Neni 7

## Përdorimi dhe mirëmbajtja e sistemit të Teleprezencës

1. Komuna është e obliguar të sigurojë kushtet për funksionimin e teleprezencës gjatë mbajtjes së mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.

2. Sekretaria e Kuvendit të Komunës është përgjegjëse për menaxhimin e llogarisë së formës vc.komuna@rks-gov.net, gjatë mbajtjes së mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.

3. Zyrtari përgjegjës për monitorim të komunave ka të drejtën e qasjes në sistem në çdo kohë kur mbahen mbledhjet e Kuvendeve të Komunave.

4. Komuna është e obliguar të caktoj një pikë kontaktuese për komunikim me Zyrtarin Monitorues të Ministrisë.

5. Zyrtari përgjegjës i komunës duhet të vendos lidhjen e teleprezencës, 15 minuta para fillimit të mbledhjes së Kuvendit të Komunës, përmes pranimit të e-mailit ose linjave të tjera zyrtare nga Zyrtari Monitorues i Ministrisë.

6. Në vendin e mbajtjes së mbledhjes, organet e komunës duhet të sigurojnë prezencën dhe funksionimin e pajisjeve të teleprezencës.

7. Zyrtari përgjegjës për informim në Komunë, obligohet të siguroj lidhjen e transmetimit të drejtpërdrejtë të mbledhjes së Kuvendit të Komunës në sistemin e integruar të faqes zyrtare të Komunës, për t'i mundësuar qasjen qytetarëve dhe palëve të interesuara për përcjelljen e mbledhjes së Kuvendit të Komunës.

8. Sekretaria e Kuvendit të Komunës obligohet të arkivoj videot dhe audiot nga mbledhjet e mbajtura të Kuvendeve të Komunave në arkivën elektronike të komunës.

9. Kryetari i Komunës dhe Kryesuesi i Kuvendit të Komunës janë përgjegjës për të siguruar kushtet për Monitorimin elektronik të mbledhjeve të Kuvendeve të Komunave.

## Neni 8

## Njoftimi për mbledhjet e Kuvendeve të Komunave për monitorim elektronik

1. Komuna obligohet të dërgoj në Ministri ftesën dhe materialet shtesë të mbledhjes së Kuvendit në formë elektronike të paktën shtatë (7) ditë pune para mbajtjes së mbledhjeve të rregullta, si dhe tri (3) ditë pune para mbajtjes së mbledhjeve të jashtëzakonshme.

2. Njoftimi duhet të përmbajë vendin, datën, rendin e ditës, kohën e saktë të mbledhjes, materialet e mbledhjes, ashtu siç është paracaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

## Neni 9

## Kufizimi i qasjes në mbledhjet e kuvendit apo komitetit

1. Mbledhjet e Kuvendit apo komiteteve mund të jenë të mbyllura pjesërisht apo tërësisht, vetëm për shkaqet e parashikuara me legjislacionin në fuqi.

2. Kuvendi i Komunës dhe komitetet e kuvendit me vendim të arsyetuar shpallin mbledhjet e plotësisht apo pjërisht të mbyllura për publikun.

## KAPITULLI III

## TRANSPARENCA E EKZEKUTIVIT

### Neni 10

### Transparenca e ekzekutivit

1. Kryetari i komunës ofron transparencë për procesin vendimmarrës të tij, drejtorive dhe administratës.

2. Kryetari i komunës është përgjegjës për zbatimin e legjislacionit në publikim të akteve të ekzekutivit, dhe dokumenteve zyrtare në pajtim me Ligjin Nr. 06/L-82 për mbrojtën e të dhënave personale dhe Ligjin Nr. 06/L-081 për qasje në dokumente Publike.

3. Kryetari i komunës raporton para kuvendit të komunës për situatën ekonomiko-financiare të komunës dhe për zbatimin e planeve investuese të komunës, së paku njëherë në gjashtë muaj apo kurdoherë që kërkohet nga kuvendi i komunës.

4. Kryetari i komunës me vendim të veçantë ka të drejtë të përcaktoj rregullat e hapjes dhe menaxhimit të rrjeteve sociale, si dhe platformave të transmetimit.

## KAPITULLI IV

## PUBLIKIMI I AKTEVE, DOKUMENTEVE ZYRTARE DHE FINANCIARE DHE AKTEVE TË TJERA TË KUVENDIT TË KOMUNËS DHE EKZEKUTIVIT

### Neni 11

### Publikimi i Akteve të Komunës

1. Komuna publikon të gjitha aktet e aprovuara nga kuvendi i komunës në ueb-faqen zyrtare pas plotësimit të kushteve ligjore për publikim.

2. Komuna publikon në ueb-faqen zyrtare vendimet, urdhëresat e nxjerra nga kryetari i komunës.

3. Aktet dhe dokumentet e nxjerra nga drejtorit e komunës duhet të publikohen me qëllim të rritjes së transparencës.

4. Aktet dhe dokumentet e nxjerra nga paragrafi 1, 2 dhe 3 duhet të publikohen duke respektuar legjislacionin në fuqi përfshirë Ligjin Nr. 06/L-82 për mbrojtën e të dhënave personale dhe Ligjin Nr. 06/L-81 për qasje në dokumente Publike.

5. Aktet dhe dokumentet nga parag.1, 2 dhe 3 të këtij neni publikohen nga njësia përgjegjëse për komunikim në komunë, në formë elektronike, në pajtim me dispozitat e legjislacionin Ligjin për përdorimin e gjuhëve.

6. Komuna mund të shfrytëzoj edhe platforma të tjera për të publikuar aktet dhe dokumentet e nxjerra veçanërisht ato me karakter informues dhe vetëdijusese.

**Neni 12**

**Publikimi i dokumenteve zyrtare**

1. Komuna obligohet të publikoj të gjitha dokumentet zyrtare, përfshirë por duke mos u kufizuar në:

1.1. Planin vjetor të punës së Kryetarit dhe drejtorive;

1.2. Planin Vjetor të punës së Kuvendit të Komunës;

1.3. Strategjitë dhe dokumentet e tjera të politikave;

1.4. Planet hapësinore komunale: Planin Zhvillimor të Komunës, Hartat Zonale, Planet Rregulluese të Hollësishme;

1.5. Raportet periodike zyrtare të Kuvendit dhe Ekzekutivit;

1.6. Dokumentet e prodhuara nga Kuvendi i Komunës përfshirë procesverbalet e takimeve të kuvendit të komunës, komiteteve obligative, komiteteve të tjera konsultative, si dhe materialet e tjera publike të prodhuara nga Kuvendi i Komunës.

1.7. Të gjitha dokumentet e prodhuara gjatë proceseve të thirrjeve publike si grante, subvencione, konkurse publike, ankande, si dhe dokumente të tjera.

1.8. Video-incizimet e mbledhjeve të kuvendeve të komunës dhe materialet tjera të teleprezencës me linqet përcjellëse.

1.9. Komuna obligohet që dokumentet e kërkuara sipas dispozitave të kësaj Rregullore, t'i publikoj në formatin që ofron mundësinë e përpunimit të përmbajtjes. Përveç në rastet e kërkuara me ligj dokumentet nuk do publikohen në formatin PDF Scan.

**Neni 13**

**Publikimi i dokumenteve financiare**

1. Komuna publikon në ueb-faqen zyrtare të saj dokumentet financiare si vijon por nuk kufizohet në:

1.1. Buxhetin vjetor të Komunës;

1.2. Listën e projekteve kapitale;

1.3. Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB);

1.4. Raportet financiare vjetore dhe tremujore siç parashihen me legjislacionin sektorial për financat publike;

1.5. Raportet vjetore të punës së kuvendit dhe ekzekutivit;

1.6. Raportin e zyrës kombëtare të auditimit dhe rekomandimet përcjellëse;

1.7. Çdo dokument tjetër financiar të kërkuar me akte ligjore dhe nënligjore në fuqi.

## Neni 14

## Transparenca e aktiviteteve të prokurimit

1. Komuna publikon në ueb-faqen zyrtare çdo aktivitet të prokurimit, publikimi i të cilave është i përcaktuar me legjislacionin sektorial, përfshirë por duke mos u kufizuar në:

1.1 Planin e prokurimit,

1.2. Raportin e prokurimit,

1.3. Njoftimet paraprake; Njoftimet për kontratë; Njoftimet për dhënie të kontratës, Njoftimet për konkurs të projektimit; Njoftim për rezultatet e konkursit të projektimit; Njoftim për anulim; Njoftim për informata shtesë; Anulim të dhënies së kontratës; Njoftim për nënshkrimin e kontratës; Ankandet Publike; Vendimet e Komunës ndaj kërkesave për rishqyrtim; Vendimet e Organit Shqyrtues të Prokurimit,

1.4. Vendimet, dokumentet dhe të dhënat e tjera të nevojshme të përcaktuar me legjislacionin sektorial dhe në pajtim me Ligjin Nr. 06/L-82 për mbrojtën e të dhënave personale dhe Ligjin Nr. 06/L-081 për qasje në dokumente Publike.

2. Për çdo projekt, komuna vendos pano informuese për aktivitetin e prokurimit, në të cilin shkruhet emri i projektit, investitori, kompania implementuese dhe kohëzgjatja.

3. Me qëllim të rritjes së transparencës komuna do vendosë emrin dhe mbiemrin dhe kontaktet për menaxherin, mbikëqyrësin apo kompaninë mbikëqyrëse të projektit

## Neni 15

## Transparenca në menaxhimin e pronës komunale

1. Komuna duhet të garantoj proces transparent në procedurat dhe dokumentet e hartuara gjatë menaxhimit të pronës komunale bazuar në dispozitat e legjislacionit në fuqi.

2. Komuna publikon listën e pronave komunale, pronave të cilat planifikohen të jepen në shfrytëzim, pronave të dhëna në shfrytëzim dhe aseteve të tjera të rëndësishme të komunës.

3. Të dhënat që do të publikohen përfshijnë por nuk kufizohen në të dhëna për njësi kadastrale, zona kadastrale vendi i pronës dhe qëllimi.

4. Publikimi i listës sipas legjislacionit në fuqi duhet të përmbyllet deri me 31 dhjetor të vitit kalendarik.

5.Proceset e ankandit, shprehjes së interesit, dhënies në shfrytëzim, këmbimit dhe procedurat tjera të tjetërsimit pronës komunale janë publike.

6. Për çështje të interesit publik informacione mbi menaxhimin e pronës së luajtshme dhe aseteve të tjera të komunës do jenë publike.

### Neni 16

### Transparenca e ndërmarrjeve publike

1. Komuna kujdeset të siguroj kushtet për procese transparente gjatë ushtrimit të funksionit të vet në menaxhimin dhe realizimin e funksioneve të ndërmarrjeve komunale dhe përfaqësimit në ndërmarrjet rajonale.

2. Në rastet ku shërbimet komunale ofrohen nga ndërmarrjet komunale, ato ndërmarrje duhet t'ia dorëzojnë buxhetet e tyre kuvendit të komunës për miratim. Propozimet buxhetore duhet të përfshijnë strukturën e propozuar të tarifës për ofrimin e shërbimeve dhe duhet të dorëzohen para datës 15 nëntor të vitit të ardhshëm fiskal.

3. Raportet të cilat do i dorëzohen kuvendit të komunës do të jenë publike në ueb faqen zyrtare të komunës.

4. Me qëllim të rritjes së transparencës raporte të mbikëqyrjes dhe të auditimit të punës së ndërmarrjeve do të i ofrohen publikut.

5. Aktet nënligjore dhe dokumentet tjera zyrtare të hartuara nga ndërmarrjet publike komunale duhet të jenë publike dhe lehtë të qasshme për publikun në pajtueshmëri me Ligjin Nr. 06/L82 për mbrojtën e të dhënave personale dhe Ligjin Nr. 06/L-081 për qasje në dokumente Publike.

## KAPITULLI V

## FORMAT E PËRFSHIRJES AKTIVE TË QYTETARËVE NË VENDIMMARRJE

### Neni 17

### Takimet publike gjithëpërfshirëse me qytetarë

1. Komuna duhet të siguroj përfshirjen e qytetarëve në konsultime dhe vendimmarrje duke përdorur por duke mos u kufizuar në mbajtjen e:

1.1 Takimeve publike;

1.2 Konsultim publik për projekt aktet normative dhe dokumente të politikave;

1.3 Takime konsultative me qytetarë;

1.4 Dëgjime buxhetore.

2. Trajtimin e kërkesave peticioneve dhe kërkesave individuale e grupore të qytetarëve.

3. Me qëllim të marrjes së pikëpamjeve të qytetarëve në procesin vendimarrës, komuna siguron zbatimin e standardeve minimale të konsultimit publik të përcaktuara në këtë Rregullore.

4. Me qëllim të dokumentimit të mbajtjes së takimeve, konsultimeve publike, dëgjimeve buxhetore dhe takimeve tjera, komuna siguron ftesat, materialet, sigurimin e kushteve, mbajtjen e procesverbalit dhe hartimin e raportit nga takimet dhe aktivitetet e përfshirjes së qytetarëve në diskutime dhe konsultime publike, gjatë hartimit të akteve dhe dokumenteve lokale.

5.Ueb faqja e komunës dhe platforma qeveritare për konsultime publike do përdoren si platforma për realizimin e qëllimeve të këtij neni.

6. Zyra për Komunikim me Publikun, është përgjegjëse për njoftimin e qytetarëve për vendin, datën, kohën vendin, rendin e ditës, se kur do të mbahen takimet, dëgjimet buxhetore, konsultimet publike dhe takime tjera shtesë.

**Neni 18**

**Takimet publike**

1. Çdo vit komuna mban së paku dy takime publike për çështje të interesit të përgjithshëm, në të cilën mund të marr pjesë secili person apo organizatë me interes në Komunë. Takimi i parë obligativ mbahet në gjashtëmujorin e parë të vitit, ndërsa takimi i dytë në gjashtëmujorin e dytë.

2. Përveç takimeve publike të cekura më lartë, komunat janë të obliguara t'i informojnë qytetarët e komunës për çfarëdo planesh apo programesh të rëndësishme me interes publik, siç rregullohet me statutin e komunës.

3. Komuna mundet të organizojë edhe takime shtesë, dhe të jetë sa më pranë qytetarëve për çështje që lidhen me buxhetin komunal, zhvillimin ekonomik lokal, përdorimin e pronës komunale, planifikimin hapësinor, investimet, të hyrat komunale si dhe çështje të tjera në interes të përgjithshëm.

4. Njoftimi për takime publike duhet të publikohen dy javë para mbajtës së takimit.

5. Njoftimi për takime publike duhet bëhet përmes:

5.1 Ueb-faqes zyrtare të komunës dhe hapësirat publike në komuna;

5.2 Me qëllim të arritjes së audiencës komuna promovon agjendën në rrjete sociale, dhe forma alternative të komunikimit me publikun.

6. Zyra për Komunikim me Publikun në komuna është përgjegjëse për njoftimin e qytetarëve për vendin, datën, kohën kur do të mbahen takimet dhe materialet.

7. Komuna siguron hapësirat e mjaftueshme brenda territorit të komunës për pjesëmarrje të gjerë dhe aktive të publikut.

8. Në takimet publike marrin pjesë zyrtarët e lartë të komunës, si: Kryetari i Komunës, Kryesuesi i Kuvendit, Drejtorët e Drejtorive përkatëse, Kryesuesit e komiteteve dhe Zyrtarët kompetent për çështje në takimin publik.

9. Mekanizmat përfaqësues të komunitetit të themeluar sipas Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr. 02/2019 për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunim e komunave me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet publike, duhet të jenë të njoftuar zyrtarisht për takimet.

10. Nëse gjatë takimit qytetarët dhe palët e interesit nuk kanë marrë përgjigje në pyetjet e parashtruara, komuna obligohet që në raport brenda 30 ditësh të ofroj përgjigje me shkrim. Në procesverbal konstatohet që përgjigja do të ofrohet me shkrim duke e përcaktuar zyrtarin përgjegjës dhe hapësirën ku do të publikohet përgjigja.

11. Në kuadër të kompetencave të tyre drejtorët e drejtorive mbajnë takime informuese me grupe të tjera përfaqësuese si shoqata, sindikata, këshilla grupe të interesit dhe qytetarë me qëllim të përfshirjes së tyre në vendimmarrje. Takimet e kësaj natyre janë publike dhe për të njëjtat do të respektohet paragrafi. 4 dhe 5 e këtij neni.

**Neni 19**

**Konsultimet publike**

1. Organet përgjegjëse të komunës duhet të sigurojnë zbatimin e procesit të konsultimit publik, gjatë hartimit të politikave dhe akteve nënligjore të komunës për të cilat konsultimi publik është i obligueshëm.

2. Komuna siguron ndërmarrjen e të gjitha veprimeve të nevojshme që të siguroj një partneritet aktiv në mes palëve të ndryshme gjatë procesit të konsultimit publik.

3. Komuna organizon konsultimet publike me qytetarë në përputhje me parimin; Ligjshmërisë, Transparencës, Barazisë, mosdiskriminimit dhe Efikasitetit në procesin e konsultimit publik.

**Neni 20**

**Planifikimi i konsultimeve publike**

1. Planifikimi i përgjithshëm i konsultimeve publike bëhet që në fazën e hershme gjatë hartimit të planit të punës së komunës për vitin e ardhshëm kalendarik, si dhe me rastin e hartimit të planit për komunikim me publikun.

2. Zyrtari përgjegjës për konsultim publik koordinim me iniciuesit harton plan të veçantë, për të gjitha project propozimet e organit propozues të akteve nënligjore dhe politikave lokale, të cilat i nënshtrohen procesit të konsultimit publik për vitin e ardhshëm kalendarik.

3. Plani i konsultimeve publike duhet të jetë pjesë përbërëse e planit për komunikim me publikun dhe duhet të publikohet.

4. Planifikimi i konsultimit merr për bazë afatet kohore, kostot financiare, resurset njerëzore, indentifikimin e palëve të përfshira në procesin e konsultimit publik, si dhe format dhe teknikat e konsultimit publik.

**Neni 21**

**Fazat e Konsultimit Publik**

1. Procesi i konsultimit publik në komunë ndahet në tri faza:

1.1.Planifikimi i konsultimeve;

1.2.Mbajtja e konsultimeve;

1.3.Mbledhja e komenteve, komunikimi dhe adresimi i tyre në organet përgjegjëse.

**Neni 22**

**Aktet obligative për konsultime publik**

1. Aktet e komunës që i nënshtrohen procesit të konsultimit publik janë:

1.1 Draft-Statuti i komunës,

1.2. Projekt-Rregulloret komunale,

1.3. Aktet tjera që parashihen me ligjet sektoriale,

1.4. Projekt buxhetin e komunës për vitin vijues, si dhe rishikimin buxhetor,

1.5. Korniza afatmesme buxhetore për 3 vitet e ardhshme,

1.6. Strategjitë zhvillimore dhe planet e veprimit në nivel lokal në kuadër të fushave sektoriale,

1.7. Të gjitha projekt-planet hapësinore në nivel lokal, konform legjislacionit për planifikim hapësinor.

2. Komuna ka të drejtë të vendosë në konsultim publik edhe dokumente dhe procese të tjera në kuadër të kompetencave të saja, apo politikat e parapara me legjislacionin në fuqi.

**Neni 23**

**Mbajtja dhe procesi i konsultimeve publike**

1. Iniciuesi apo propozuesi i akteve dhe politikave të parapara në nenin 22 të kësaj Rregullore, është përgjegjës për zhvillimin e procesit të konsultimit publik.

2. Rregulla të njëjta procedurale të konsultimit publik vlejnë edhe në rastet kur projekt propozimet paraqiten nga grupet e jashtme punuese, apo iniciativat qytetare dhe nga komitetet konsultative, konform nenit 70 dhe 73 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale. Në këto raste, procedurat e konsultimit udhëhiqen nga sektori/drejtoria në kompetencë e së cilës është fusha e propozuar e politikës apo propozimit.

3. Para aprovimit të një projekt propozimi, organi propozues vendos për hapjen e procesit të konsultimit publik.

4. Organi propozues siguron zbatimin e teknikave dhe formave obligative të përcaktuara me nenin 26 të kësaj Rregullore.

5. Procesin e konsultimit publik e zhvillon organi përgjegjës apo drejtoria në kuadër të fushëveprimtarisë që rregullon projekt aktin e caktuar.

6. Zyrtari përgjegjës për konsultim publikë njofton palët e interesuara për konsultimin me shkrim, elektronik dhe format e tjera të konsultimit.

7. Njoftimi për konsultime publike publikohet

8 deri në 14 ditë kalendarike, duke ndjekur procedurën sipas nenit 5 paragrafit 2 të kësaj Rregullore.

8. Zyrtari përgjegjës për konsultim publik para mbajtjes së konsultimeve publike njofton grupin e jashtëm punues, qytetarët dhe komitetin konsultativ që ka propozuar ose hartuar projekt aktin, këto raste, procedurat e konsultimit udhëhiqen nga sektori/drejtoria në kompetencë të së cilës është fusha e propozuar e politikës apo propozimit.

**Neni 24**

**Mbarëvajtja e procesit të konsultimeve publike dhe përgjegjësit e zyrtarit për konsultime publike**

1. Kryesuesi apo udhëheqësi i grupit punues të dokumentit apo aktit të vënë në konsultim publik, është përgjegjës për procesin e njoftimit për takimet publike, përfshirë vënien në diskutim me anëtarë të grupit, shqyrtimi i komenteve nga projekt propozimi duke respektuar afatet e parapara në këtë Rregullore.

2. Për të lehtësuar procesin administrativ të konsultimit publik, kryetari i komunës me vendimin cakton një apo më shumë zyrtarë përgjegjës për konsultim publik.

3. Kryetari i Komunës e njofton me shkresë të veçantë MAPL-në dhe Zyrën për Qeverisje të Mirë, me emrin e zyrtarit i cili është përgjegjës për menaxhimin e platformës së konsultimeve publike.

4. Zyrtari për konsultime publike është përgjegjës për publikimin e dokumenteve në ueb-faqe dhe platformën e konsultimeve publike, përgatitjen e raportit vjetor të konsultimeve publike dhe hartimin e planit të konsultimit publik.

5. Kryetari mund të përcaktoj edhe detyra shtesë për zyrtarin për konsultime publike.

**Neni 25**
**Identifikimi i palëve të interesuara**

1. Komuna varësisht nga lloji i projekt propozimit identifikon qytetarët dhe palët e interesuara të cilat mund të ndikohen nga politika e caktuar, në mënyrë që t'i ftoj të marrin pjesë në procesin e konsultimit publik.
2. Komuna duke respektuar ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, harton dhe mirëmban bazën e të dhënave për grupet e interesuara të cilat duhet të përshihen në procesin e konsultimit publik.

3. Komuna mund të përfshijë palët e interesuara në grupet punuese përgjegjëse për hartimin e projekt propozimeve.
4. Identifikimi i palëve të interesuara bëhet nga organi propozues, i cili bën thirrje publike për përfshirjen e përfaqësuesve të grupit të interesuar.

**Neni 26**

**Format dhe Teknikat e konsultimit publik**

1. Komuna obligohet të zhvilloj procesin e konsultimeve publike duke përdorur publikimin në ueb-faqen e komunës dhe në Platformën e Qeverisë për Konsultime publike, si dhe së paku një takim konsultativ me palët e interesuara. Gjatë procesit palët e interesuara mund të adresojnë edhe shkresa fizike në adresë të komunës.

2. Me qëllim të rritjes së përfshirjes së qytetarëve dhe grupeve të interesit komuna mund të përdorë edhe forma alternative përfshirë rrjetet sociale, takimet me qytetarët, diskutimet publike etj.

**Neni 27**

**Konsultimet me shkrim dhe elektronike**

1. Organi propozues siguron kushte për zhvillimin e konsultimit me shkrim dhe në formë elektronike, duke përfshirë informimin me kohë për mënyrat dhe afatet e konsultimit publik.
2. Zyrtari përgjegjës për hartim të projekt propozimit në bashkëpunim me zyrtarin për konsultime publike njofton palët e interesuara për konsultimin me shkrim dhe elektronik.
3. Njoftimi me shkrim dhe elektronik, përmban:
3.1. Projekt propozimin për të cilin kërkohen komentet;
3.2. Adresën e saktë ku duhet të dërgohen komentet me shkrim dhe elektronike;
3.3. Informatat (emrin, mbiemrin dhe e-mailin) për personin përgjegjës për pranimin e komenteve;
3.4 Afatin për dorëzimin e komenteve;
3.5. Komuna obligohet të krijoj meny/rubrikë të veçantë brenda ueb-faqes zyrtare për procesin e konsultimit publik, e cila përmes vegëzes së veçantë bënë ndërlidhjen me Platformën e Qeverisë për Konsultime Publike.
4. Përmes ueb-faqes zyrtare dhe Platformës së Qeverisë për Konsultimet publike, komuna siguron shpalljen e njoftimeve për konsultim të projekt propozimeve, afatet e konsultimit, memorandumet shpjeguese, projekt propozimet për konsultim, adresën për pranimin e komenteve dhe publikimin e raporteve/rezultateve të konsultimit publik.

**Neni 28**

**Afatet e konsultimit publik**

1. Konsultimi publik zgjat jo më pak se 15 ditë kalendarike dhe jo më shumë se 30 ditë kalendarike nga data e shpalljes së njoftimit publik për mbajtje të konsultimeve.
2. Organi propozues më një arsyetim të shkruar mund të zgjas afatin e konsultimit publik deri në 30 ditë kalendarike jashtë afatit të rregullt, në ato raste kur:
2.1. Procesi i konsultimit publik nuk ka rezultuar me komente të mjaftueshme për të marrë opinionin e qytetarëve dhe palëve të interesuara;

2.2. Përmbajtja e projekt propozimit është më komplekse dhe kërkon kohë shtesë për konsultim publik.

## Neni 29

## Takimet konsultative me publikun

1. Brenda afatit të konsultimit publik, përveç konsultimit me shkrim dhe elektronik, komuna organizon takime konsultative me qytetarë dhe palët e interesuara për projekt propozimin gjatë afatit të shpallur për konsultim publik.
2. Njoftimi për konsultim publik shpallet së paku tetë (8) ditë dhe maksimum katërmbëdhjetë (14) ditë kalendarike para mbajtjes së takimit në ueb-faqen zyrtare të komunës, tabelën e shpalljeve, si dhe në çdo formë tjetër që siguron njoftimin e duhur të palëve të interesuara.
3. Në ftesën për takim publik, zyrtari përgjegjës për konsultim në koordinim me zyrtarin përgjegjës për hartim të projekt propozimit njofton palët e interesuara për:
3.1. Datën, vendin dhe kohën e matjes së takimit publik;
3.2. Projekt propozimin që është objekt i konsultimit publik;
3.3.Një memorandum shpjegues për përmbajtjen e projekt propozimit;

3.4. Informatat (emrin, mbiemrin dhe emailin) për personin përgjegjës për pranimin e komenteve.
4. Në takimin publik marrin pjesë zyrtari apo grupi punues përgjegjës për hartimin e projekt propozimit, drejtori i drejtorisë propozues, drejtorët e drejtorive relevante, zyrtarët tjerë të deleguar nga drejtoritë përkatëse, si dhe zyrtari përgjegjës për konsultim publik.
5. Zyrtari përgjegjës për hartimin e projekt propozimit i caktuar nga organi propozues, kryeson takimet konsultative me qytetarë, shpjegon përmbajtjen e projekt-propozimit para publikut dhe në bashkëpunim me zyrtarin përgjegjës për konsultim publik, evidenton propozimet e dhëna nga publiku gjatë konsultimeve.

## Neni 30

## Mbledhja e komenteve, komunikimi dhe adresimi i tyre

1. Zyrtari përgjegjës për hartim të projekt- propozimit gjatë mbajtjes së konsultimit publik mbledh komentet dhe përgatit raport për rezultatet e konsultimit publik.

2. Shqyrtimi i komenteve bëhet nga grupi punues i projekt propozimit i cili vendos për pranimin ose refuzimin e rekomandimeve të marra nga palët e interesuara.

3. Të gjitha propozimet, vërejtjet dhe sugjerimet që janë paraqitur nga publiku brenda mënyrës dhe afatit kohor të përcaktuar me dispozitat e kësaj Rregullore, përfshihen në raportin mbi shqyrtimin publik.

4. Afati për përgatitjen e Raportit është më së paku pesëmbëdhjetë (15) ditë dhe jo më shumë se tridhjetë (30) ditë kalendarik, për projekt propozimin që nga dita e përfundimit të afatit për paraqitjen e propozimeve dhe vërejtjeve me shkrim.

5. Brenda pesë (5) ditëve kalendarike pas përfundimit të raportit nga grupi punues mbi shqyrtimin publik, raporti dërgohet tek zyrtari përgjegjës për konsultim publik i cili obligohet të siguroj publikimin ueb faqen zyrtare të komunës dhe në platformë për Konsultime publike të qeverisë.

## Neni 31

## Dëgjimet buxhetore

1. Komuna obligohet të mban dëgjime buxhetore me qytetarë të përcaktuar sipas Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësive.

2. Dëgjimet buxhetore mbahen duke përdorur format dhe teknikat e konsultimit publik përfshirë: thirrjet, afatet, procesverbalet dhe hartimin e raporteve sipas dispozitave të kësaj Rregullore.

3. Në procesin e planifikimit buxhetor kryetari i komunës themelon një grup punues për përgatitjet dhe realizimin e dëgjimeve buxhetore. Grupi punues udhëhiqet nga drejtoria përkatëse e ekonomisë dhe financave. Organi propozues siguron zbatimin e standardeve minimale të procesit të konsultimit.

4. Organet përgjegjëse të komunës janë të obliguar të planifikojnë kalendarin e dëgjimeve buxhetore për projekt buxhetin e komunës dhe KAB-in, dhe të organizojnë dëgjime buxhetore të përcaktuar sipas Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësive.

5. Raporti nga dëgjimet buxhetore i adresohet kuvendit së bashku me propozim buxhetin. Kuvendi i Komunës do njoftohet me vegëzat e procesverbaleve online të publikuara.

6. Njoftimi për diskutime buxhetore së bashku me propozim-buxhetin dhe dokumentet shpjeguese, publikohet së paku tetë (8) ditë dhe maksimum katërmbëdhjetë (14) ditë kalendarike para mbajtjes së takimit duke ndjekur procedurën sipas nenit 5 paragrafit 2 të kësaj Rregullore.

## Neni 32

## Mbikqyrja e procesit të konsultimit publik dhe raportimi

1. Komuna siguron ofrimin e përgjigjeve për statusin e propozimeve të marra nga diskutimet publike, përmes një raporti të veçantë i cili bëhet publik në ueb-faqen zyrtare të komunës, si dhe në Platformën e Qeverisë për Konsultime Publike.

2. Kryetari i komunës siguron që projekt propozimet e dorëzuara për aprovim në Kuvendin e Komunës i përmbushin standardet minimale për procesin e konsultimit publik.

3. Kuvendi i komunës refuzon aprovimin e projekt propozimeve në rastet kur nuk janë përmbushur standardet minimale të konsultimit publik sipas kritereve, të përcaktuara në këtë Rregullore.

4. Komunat Raportin vjetor për zbatimin e standardeve minimale të konsultimit publik, e dërgon në Zyrën për Qeverisje të Mirë dhe në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal.

## Neni 33

## Buxhetimi me pjesëmarrje

1. Me qëllim të rritjes së përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje në procesin e buxhetimit komunat mund të përdorin metodologjinë e buxhetimit me pjesëmarrje.

2. Kryetari i komunës inicon dhe menaxhon buxhetimin me pjesëmarrje në bashkëpunim me kuvendin e komunës, qytetarët, aktivistët lokal, përfaqësuesit e shoqërisë civile, përfaqësuesit e

grupeve joformale të qytetarëve, përfaqësuesit e organizatave të bizneseve, grupet e margjinalizuara, këshillat lokal, si dhe palët tjera të interesit.

## KAPITULLI VI

## INICIATIVAT E QYTETARËVE, PETICIONET DHE KËRKESAT PËR REALIZIMIN E TË DREJTAVE

### Neni 34

### Kërkesat për informimin, iniciativat qytetare dhe peticionet

1. Çdo subjekt fizik ose juridik ka të drejtë të parashtrojë kërkesë për realizimin e ndonjë të drejte, iniciative qytetare dhe peticion për çështje që janë përgjegjëse organet e Komunës.

2. Kërkesat, iniciativat qytetare dhe peticionet shqyrtohen nga Kuvendi i Komunës brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditësh, siç është e përcaktuar në nenin 70 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale.

3. Pas diskutimit në Kuvendin e Komunës Kryetari i Komunës ose njësia/zyrtari për komunikim me qytetarët, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e shqyrtimit njofton me shkrim parashtruesin e kërkesës ose peticionit.

4. Në raste kur kërkesat për realizimin e ndonjë të drejte, iniciativat qytetare ose peticione lidhen me çështjet për të cilat komuna nuk është drejtpërdrejt kompetente, Kryetari i Komunës ose njësia/zyrtari për komunikim me qytetarë, brenda afatit të përcaktuar e njofton me shkrim parashtruesin e kërkesës ose peticionit se është jo kompetente, si dhe procedon atë tek organet kompetente duke njoftuar edhe parashtruesin e kërkesës.

### Neni 35

### Parashtrimi i iniciativave dhe peticioneve

1. Çdo subjekt fizik grup i përfaqësuar apo person juridik ka të drejtë të parashtroj kërkesë për realizimin e ndonjë të drejte, iniciative qytetare dhe peticioni, për çështje që janë në kompetencë të komunës.

2. Peticionet/iniciativat nga paragrafi 1 i këtij neni shqyrtohen nga Kuvendi i Komunës në pajtim me Statutin e Komunës dhe Rregulloren e Punës.

### Neni 36

### Procedura e shqyrtimit

1. Peticioni paraqitet në formë të shkruar dhe i drejtohet kryesuesit të kuvendit të komunës.

2. Organet përgjegjëse të komunës realizojnë procesin e verifikimit të të dhënave të peticionit apo iniciativës dhe pas këtij verifikimi nisë procesin e trajtimit të kërkesave.

3. Peticioni shqyrtohet nga kuvendi i komunës brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditësh, siç është e përcaktuar në nenin 70 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale.

4. Pas diskutimit në Kuvendin e Komunës, kryesuesi, jo më vonë se 15 ditë nga dita e shqyrtimit, njofton me shkrim parashtruesin e kërkesës apo peticionit.

5. Të dhënat përfshirë peticionin ruhen dhe arkivohen komfor ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

### Neni 37

### Iniciativat qytetare

1. Qytetarët mund të ndërmarrin iniciativë për të propozuar rregullore, brenda kompetencave të komunës.

2. Iniciativa qytetare realizohet sipas standardeve të ligjit për vetëqeverisje lokale dhe duhet të përfshijë 15 % të votuesve të komunës të regjistruar në KQZ.

3. Pas marrjes së nënshkrimeve iniciuesit dorëzojnë iniciativën në kuvendin e Komunës.

4. Kuvendi i komunës inicon procesin e verifikimit të nënshkrimeve të dorëzuara.

5. Pas verifikimit Kërkesat dhe iniciativat qytetare shqyrtohen nga kuvendi i komunës në afat prej 60 ditësh, siç përcaktohet me nenin 70 të LVL-së.

6. Të dhënat përfshirë nënshkrimet e përfaqësuesve të iniciativës ruhen dhe arkivohen konform ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

### Neni 38

### Nisma për bashkëpunim ndërkomunal

1. Procedura për themelimin e bashkëpunimit ndër-komunal fillohet përmes nismës.

2. Nisma për themelimin e bashkëpunimit ndër-komunal parashtrohet me shkrim nga:

2.1. Kryetari i Komunës;

2.2. 1/3 e anëtarëve të Kuvendit të Komunës.

2.3. së paku 5 % e qytetarëve të komunës me të drejtë vote;

2.4. Qeveria e Republikës së Kosovës, kur themelimi i bashkëpunimit ndër-komunal konsiderohet të jetë me interes të veçantë publik dhe lokal.

## KAPITULLI VII

## QASJA NË DOKUMENTET PUBLIKE, INFORMATAT PËR SHËRBIME DHE KOMUNIKIMI

### Neni 39

### Trajtimi dhe raportimi për kërkesat për qasje në dokumentet publike

1. Komuna, garanton qasjen në dokumentet publike në pajtim me ligjin për qasje në dokumentet publike, ligji për Mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar

l dhe ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.

2. Komuna publikon kontaktet dhe të dhënat e zyrtarit përgjegjës si dhe raportin vjetor të qasjes në dokumente publike.

## Neni 40

## Informatat për shërbime

1. Komuna obligohet që informacionet për shërbimet të cilat i ofron të publikohen në hapësirat e institucioneve komunale dhe në ueb faqen zyrtare. Për informacione të rëndësishme komuna mund të përdorë edhe në hapësira të tjera publikimi përfshirë rrjetet sociale.

2. Për të lehtësuar qasjen e qytetarëve në shërbime, komuna publikon të dhënat për strukturën organizative të administratës, detyrat dhe përgjegjësitë e secilës njësi, adresat dhe numrat kontaktues.

3. Komuna publikon të dhënat e udhëheqësve të lartë të organeve të komunës, si dhe personave përgjegjës në njësitë e shërbimeve të administratës, adresat elektronike të tyre dhe numrat kontaktues.

4. Të dhënat për adresën dhe shërbimet e ofruara nga secila njësi organizative e komunës përfshirë: listën e shërbimeve të ofruara, licencat, lejet, autorizimet, certifikatat, vërtetimet, shërbimet e tjera, kohën e marrjes së shërbimit, procedurat, afatet dhe detajet e personave përgjegjës zyrtar të autorizuar për dhënien e shërbimit.

5. Komuna është e obliguar që informatat dhe dokumentet t'i publikoj në linkun adekuat duke përdorur emërtimin zyrtar.

## Neni 41

## Procedura e komunikimit

1. Në ueb faqen e komunës dhe kanalet e tjera të komunikimit komuna publikon e-mail adresa apo forma të tjera të pranimit të kërkesave, ankesave apo parashtresave të tjera nga qytetarët.

2. Komuna siguron që të gjitha kërkesat që adresohen në emailat zyrtarë të publikuar në faqet e komunës të marrin përgjigje brenda një periudhe të arsyeshme kohore dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Zyrtarët që menaxhojnë emailat zyrtar publik të komunës do të ofrojnë përgjigje përmes komuniukimit elektronik.

4. Në momentin kur emali vendoset në ueb faqe, zyrtari do të njoftohet për obligimin që të përgjigjet dhe të adresoj kërkesat e pranuara në emalin zyrtarë.

5. Nëse zyrtari publik nuk është përgjegjës apo nuk ka kompetencë për të ofruar përgjigje në kërkesat e pranuara me e-mail ai obligohet të njoftoj parashtruesin me adresën ku duhet të kërkohet përgjigje.

6. Në bashkëpunim me zyrtarët e IT-së zyrtarët që menaxhojnë e-maila do ndërmarrin hapa për të identifikuar dhe bllokuar adresa të cilat dërgojnë materiale promovuese apo e-maila të krijuar nga "bots'.

7. Me qëllim të informimit më të mirë të qytetarëve për çështje të caktuara komuna do të krijoj lista të e-mailave lista të numrave të telefonave dhe aplikacioneve të cilat përdoren për komunikim.

8. Të dhënat e e-mailave, kontakteve të telefonave apo aplikacioneve do të ruhen dhe mirëmbahen sipas dispozitave të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

## KAPITULLI VIII

## PLANI I VEPRIMIT PËR TRANSPARENCË NË KOMUNË

### Neni 42

### Procedurat e hartimit të Planit të Veprimit për Transparencë

1. Komuna harton Planin e veprimit për transparencë në komunë, në pajtueshmëri me dispozitat Udhëzimi Administrativ për Administratë të Hapur si dhe në pajtim me këtë Rregullore.

2. Plani i veprimit për transparencë hartohet për një periudhë katër (4) vjeçare.

3. Plani i veprimit për transparencë aprovohet nga kuvendi i komunës dhe publikohet në uebfaqen zyrtare.

4. Plani i veprimit për transparencë përfshinë veprime që promovojnë: Mbledhjet e Kuvendit të Komunës; Komiteteve; Takimet publike; Takimet konsultative për projektakte; Transparencën në planifikimin dhe shfrytëzimin e buxhetit të komunë; Qasje të shpejtë në shërbime; Procedurat transparente të Prokurimit; Procedurat të punësimit; Përditësimin e aktiviteteve ditore në faqe zyrtare; Përfshirjen aktive të qytetarëve në proceset e vendimmarrjes etj.

## KAPITULLI IX

## DISPOZITAT PËRFUNIDTARE

### Neni 43

### Respektimi i gjuhëve zyrtare

1.Komuna gjatë publikimit të akteve normative, vendimeve, dokumenteve dhe informatave, obligohet të respektoj ligjin për përdorimin e gjuhëve zyrtare si dhe Rregulloren komunale për përdorimin e gjuhëve zyrtare në Komunën e _________.

### Neni 44

### Funksionimi i faqes zyrtare elektronike të Komunës

1. Komuna duhet të përditësojë dhe mirëmbajë faqen zyrtare elektronike të saj, ashtu siç është e përcaktuar në Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2015 për Ueb Faqet e Institucioneve Publike.

2. Të gjitha dokumentet publike të komunës vendosen në faqen zyrtare, në bazë të fushës përkatëse, në mënyrë që të lehtësohet qasja e shpejtë e qytetarit dhe grupeve tjera të interesit.

3. Arritja deri tek informacioni në ueb faqet zyrtare të jetë me sa më pak hapa-klikime.

### Neni 45

### Përgjegjësia për zbatim

1.Për zbatimin e kësaj Rregullore është përgjegjësi e Kuvendit Komunal dhe Kryetarit të Komunës përmes organeve kompetente të autorizuara me ligj.

**Neni 46**

**Shfuqizimi**

1.Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohet Rregullorja komunale për Transparencë në Komunën e Rahovecit me nr Protokoli 2697 e datës 30.8.2019.

**Neni 47**

**Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës, si dhe publikimit në gjuhët zyrtare në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe ueb-faqen e Komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**

________________________

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Kuvendi i Komunës Rahovec***
*Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec*

Në mbështetje të nenit 12 pika 1 dhe pika 2 shkronja d), nenit 17 shkronja (h) dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 5 të Ligjit Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës, nenit 14 paragrafi 8 pika 8.1 të Rregullores (QRK) Nr. 19/2024 për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesional, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese (IEAA) të arsimit parauniversitar, nenit 2, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 paragrafi 2 pika 2.11, nenit 57 paragrafi 1 pika 1.8 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, propozimit të Drejtorisë për Arsim në Komunën e Rahovecit me Nr. Reference 04/554 të dt. 07.04.2025, Kuvendi i Komunës së Rahovecit, në mbledhjen e mbajtur më datë 00.04.2025, miraton këtë:

**V E N D I M**
**Për caktimin e komisionit për përzgjedhjen e drejtorit/eshës dhe zëvendësdrejtorit/eshës së institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese të arsimit parauniversitar (IEAA-AP)**

1. **Caktohet** komisioni për përzgjedhjen e drejtorit/eshës dhe zëvendësdrejtorit/eshës së institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese të arsimit parauniversitar (IEAA-AP) në komunën e Rahovecit, të cilët konkurrojnë në konkurset e shpallura nga Drejtoria për Arsim, në këtë përbërje:

    **1.1.** Lulzim Krasniqi, udhëheqës i Sektorit për Arsim, në Drejtorinë për Arsim, kryesues,
    **1.2.** Vjollca Vuçitërna, drejtoreshë në IAAP "Selajdin Mullabazi – Mici" në Rahovec, anëtare,
    **1.3.** Anëtari i tretë është nga MAShTI-i, sipas Rregullores (QRK) Nr. 19/2024.

2. Detyra e komisionit është intervistimi i kandidatëve që kanë konkurruar në konkurset e cekura në pikën 1 të këtij vendimi dhe në bazë të pikëve të fituara, bën ranglistën e kandidatëve dhe i rekomandojnë Kryetarit të Komunës emërimin e kandidatëve më të suksesshëm për drejtor/eshë apo zëvendësdrejtor/eshë e IEAA-AP sipas konkursit.
3. Obligohet komisioni përzgjedhës që punët t'i kryejë duke u bazuar në ligjet dhe në aktet nënligjore në fuqi në Republikën e Kosovës.
4. Mandati i komisionit përzgjedhës të cekur në pikën 1 të këtij vendimi është 1 (një) vjet.
5. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose faqen ueb zyrtare të Komunës.

***Vendimi u dërgohet:***
- ***Anëtarëve të komisionit,***
- ***Drejtorisë për Arsim,***
- ***MAPL-së, dhe***
- ***Arkivit.***

**K U V E N D I I K O M U N Ë S N Ë R A H O V E C**

**01Nr.___/25**
**Datë:00.04.2025**

**Arbër Zenuni**

**Kryesues i Kuvendit**

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac / Municipality Rahovec*

**Drejtoria Komunale e Arsimit-Odeljenje za Obrazovanje-Department of Education**

| | |
|---|---|
| Datë/Datum/Date: | 07.04.2025 |
| Referenc-ë | 04/554 |
| Për/Za/To: | Asambleнё Komunale- Rahovec |
| CC: | Arbër Zenuni, Kryetar |
| Përmes/Preko/Through: | DKA |
| Nga/Od/From: | Avni Morina, Drejtor |
| Subjekti/Predmet/Subject: | **Kërkesë për caktimin e anëtarëve të komisionit për Zgjedhjen e Drejtorave të Institucioneve Edukativo-arsimore të komunës së Rahovecit** |

Të nderuar/a Asambleistë Komunal.

DKA, kërkon aprovimin nga ju për dy kandadidatë të Komisionit Përzgjedhës për Drejtorë/ zv Drejtorë në Institucionet edukativo-arsimore të komunës sonë (SHFMU-SHML- dhe Institucionet e Edukimit në Fëmijërinë e Hershme).

Kandidatë për komision janë:

1. **Lulzim Krasniqi, Udhëheqës i Sektorit për Arsim, dhe**
2. **Vjollca Vuçitërna, Drejtoreshë në IAAP "Selajdin Mullaabazi-Mici".**

Me këtë kërkesë konfirmojë se personat e lartëshënuar, i përmbushin kriteret të jenë anëtarë të Komisionit sipas Rregullores, **(QRK) Nr,19/2024**, për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesional, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese (IEAA) të arsimit parauniversitar.

Kërkesa e Parashtruar nga:
Avni Morina, Drejtor i DKA-së

Datë, 07.04.2025

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Kuvendi i Komunës Rahovec***
*Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec*

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 17 dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008")*, nenit 253 të Ligjit Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 57/2009")*, nenit 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 20/2016")*, nenit 10 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.4, nenit 40 dhe nenit 57 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, kërkesës me Nr. Prot. 1045 e datës 07.04.2025 të Jonuz Shehu përfaqësues i "Esra Palace" SH.P.K., Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 29.04.2025 merr këtë:

**VENDIM**
**Për konstituimin e të drejtës së kalimit (servitutit sendor)**

1. Me këtë vendim miratohet kërkesa me Nr. Prot. 1045 e datës 07.04.2025 të Jonuz Shehu përfaqësues i "Esra Palace" SH.P.K. për konstituimin e të drejtës së servitutit sendor (të drejtës së kalimit) në pjesën e parcelës publike kadastrale sipas certifikatës së pronësisë P-71510057-01355-4 në zonën kadastrale Rahovec në sipërfaqe prej 7$m^2$ (shtatë metra katror), e cila ndahet nga sipërfaqja e përgjithshme prej 6880$m^2$ (gjashtëmijë e teteqind e tetëdhjetë metra katror), e evidentuar në posedim të Komuna e Rahovecit.

2. Krijimi i të drejtës së kalimit në pjesën e parcelës kadastrale të cekur në nenin 1 të këtij vendimi i dedikohet të lartpërmendurit në nenin 1 të këtij vendimi, i cili është posedues i pronës private me Nr. P-71510057-01355-9 në sipërfaqe të përgjithshme prej 481$m^2$ (katërqind e tetëdhjetë e një metra katror), i cili nuk ka qasje në rrugën publike "Xhelal Hajda – Toni" në Rahovec dhe si bartës i të drejtës së kalimit sipas këtij vendimi do të ketë mbrojtjen e të drejtës së autorizuar dhe në kohë të pacaktuar për shfrytëzimin e të drejtës së kalimit, e cila rrjedh nga e drejta e pronësisë në paluajtshmërinë shërbyese publike komunale.

3. Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit që sipas detyrës zyrtare të bëjë regjistrimin e të drejtës së kalimit në librat kadastral.

4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit.

5. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Kryetarit të Komunës,***
- ***Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,***
- ***MAPL-së, dhe***
- ***Arkivit.***

**KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC**

**01-Nr.____/25**
**Me datë:29.04.2025**

**Arbër Zenuni**

______________
**Kryesues i Kuvendit**

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 17 shkronja a) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008")*, nenit 5, nenit 6 paragrafi 1 pika 1.1 dhe nenit 8 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 5 paragrafi 1 pika 1.2, nenit 6, nenit 8 dhe nenit 17 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenit 10 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.4, nenit 40, nenit 57 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 29.04.2025 merr këtë:

# V E N D I M
## Për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër

1. **Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës Nr. 02/5563/25 i datës 07.04.2025 dhe merret vendimit paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim personave fizik dhe juridik dhe zhvillimin e procedurave të ankandit publik për dhënie në shfrytëzim afat shkurtër nga 1 (një) deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vite.

2. Prona e paluajtshme për dhënie në shfrytëzim, e cekur në pikën **1** të këtij vendimi është në zonën kadastrale Rahovec, në vendin e quajtur RIMNIK, me kulturë Arë e klasës 4, e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë P-71510057-08152-0, në sipërfaqe prej 2762 $m^2$ (dy mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e dy metra katror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komuna e Rahovecit.

3. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim i pronës së paluajtshme të Komunës, të cekur në pikën **1** dhe **2** të këtij propozimi, është ruajtja dhe rritja e vlerës së pronës publike komunale, për zhvillimin dhe kultivimin e bujqësisë si dhe dhënia e mundësisë qytetarëve të vetëpunësohen, ku rritja e aseteve ekzistuese ndihmon në rritjen e vlerës së asaj prone.

4. Afati kohor për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim, të cekur në pikën **1** dhe **2** të këtij vendimi, është afatshkurtër në periudhën prej __ (____________) vite.

5. Prona e paluajtshme në fjalë nuk e ndërron titullarin juridik, pronarë i saj mbetet Kuvendi Komunal i Rahovecit dhe si e tillë ajo nuk mund t'i jepet personit të tretë në shfrytëzim nga ana e shfrytëzuesit, nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë.

6. Çmimi fillestar i pronës komunale të cekur në pikën **1** dhe **2** të këtij vendimi mbi baza mujore, përcaktohet nga **komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës** sipas vlerës së përcaktuar në Rregulloren 01 Nr. 80/20 e datës 29.06.2020 për Taksa Komunale në Komunën e Rahovecit.

7. Obligohen Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Zyra e Prokurimit që në bashkëpunim me komisionin vlerësues të ofertave për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në Shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë që të zhvilloj procedurat e ankandit publik në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

8. Obligohet Kryetari i Komunës që pas përfundimit të procedurave të ankandit publik nga Komisioni për zhvillimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale afatshkurtër dhe afatgjatë, të përcaktoj me kontratë të veçantë të drejtat dhe përgjegjësitë e Komunës dhe përfituesit të pronës së dhënë në shfrytëzim.

9. Procedura për dhënien e pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër, realizohet përmes ankandit publik.

10. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L/284, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, publikuar në "Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.24/2024 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Shërbimit të Kuvendit,***
- ***Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm,***
- ***Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,***
- ***MAPL-së, dhe***
- ***Arkivit.***

**K U V E N D I I K O M U N Ë S N Ë R A H O V E C**

**01-Nr. ____/25**
**Me datë:29.05.2025**

**Arbër Zenuni**

______________

**Kryesues i Kuvendit**

**Republika e Kosovës**

Republika Kosovo / Republic of Kosovo

***Komuna e Rahovecit***

*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*

**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 5563 Nr. i faq/Br.str/No.pg 59
Data/Datum/Date 07 / 04 / 25
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 shkronja (h) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 14 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10/2019")*, nenit 5 paragrafi 1 pika 1.2, nenit 6 dhe nenit 8 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 74 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 pika 2.9 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, të datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, u:

## PROPOZON

1. Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës së Rahovecit miratimin e vendimit paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim personave fizikë dhe juridikë dhe zhvillimin e procedurave të ankandit publik për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër nga 1 (një) deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vjet.
2. Prona e paluajtshme për dhënie në shfrytëzim, e cekur në pikën **1** të këtij propozimi është në zonën kadastrale Rahovec, në vendin e quajtur RIMNIK, me kulturë: Arë e klasës IV, e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë P-71510057-08152-0, në sipërfaqe prej 2762 $m^2$ (dy mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e dy metra katror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komunës së Rahovecit.
3. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim i pronës së paluajtshme të Komunës, të cekur në pikën **1** dhe **2** të këtij propozimi, është ruajtja dhe rritja e vlerës së pronës publike komunale, për zhvillimin dhe kultivimin e bujqësisë, si dhe dhënia e mundësisë qytetarëve të vetëpunësohen, ku rritja e aseteve ekzistuese ndihmon në rritjen e vlerës së asaj prone.
4. Afati kohor për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim, të cekur në pikën **1** dhe **2** të këtij propozimi, është afatshkurtër në periudhën prej 15 (pesëmbëdhjetë) vjet.
5. Çmimi fillestar i pronës komunale të cekur në pikën 1 dhe 2, përcaktohet në përputhje me Rregulloren për Taksa Komunale në baza mujore.
6. Të drejtat dhe përgjegjësitë e Komunës dhe përfituesit të pronës së dhënë në shfrytëzim, do të rregullohen me kontratë të veçantë të nënshkruar nga kryetari i Komunës dhe përfituesi i marrjes në shfrytëzim të pronës së paluajtshme
7. Procedura për dhënien e pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër, realizohet përmes ankandit publik.

***Me propozim të njoftohen:***

- ***Kryesuesi i Kuvendit të Komunës,***
- ***Sekretaria e Kuvendit, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**

**Kryetar i Komunës**

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*
*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture / Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

# CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

## NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71510057-08152-0

| | |
|---|---|
| **Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:** | **08-942/03-0011777/25** |
| **Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:** | 07.04.2025 - 11:12 |
| **Komuna / Opština / Municipality:** | RAHOVEC / ORAHOVAC / RAHOVEC |
| **Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:** | Rahovec / Orahovac / Rahovec |
| **Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:** | RAHOVEC / ORAHOVAC / RAHOVEC |

## A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

| Numri i njësisë kadastrale<br>Broj katastarske jedinice<br>Cad. Unit. No. | Lloji i njësisë<br>Vrsta Jedinice<br>Unit Type | Lloji i pronës<br>Vrsta imovine<br>Property Type | Zona<br>U/R<br>G/S<br>U/R | Sipërfaqja<br>Površina<br>Area<br>($m^2$) | Përshkrim<br>Opis<br>Description | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhurruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **P-71510057-08152-0** | **PARCELË / PARCELA / PARCEL** | Pronë shoqërore / Drushtvena Imovina / Socially owned Land | Rural | **2762** | | | |

## A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE /CADASTRAL UNIT ADDRESS

| Vendi i quajtur<br>Mesto zvano<br>Called place | Kodi Postal<br>Poštanski Kod<br>Postal Code | Emri i rrugës<br>Naziv ulice<br>Street name | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhurruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|
| RIMNIK- | | | | |

Printuar nga / Odštampani od / Printed by: Arbnor.Kabashi | P-71510057-08152-0 |

Zyrtari përgjegjës / Odgovorno lice / Official person

## A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

| Numri<br>Broj<br>Number | Lloji i shfrytëzimit të parcelës<br>Vrsta koriscenja parcele<br>Parcel Type Of Use | Shfrytëzimi aktual i parcelës<br>Trenutno koriscenje parcele<br>Parcel Current Use | Kualiteti i klasës<br>Kvalitet klase<br>Quality Class | Sipërfaqja (m²)<br>Površina (m²)<br>Area (m²) |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Bujqësore/Poljoprivredno/Agriculture | Arat/Njive/Arable | Arë E Klasës 4/Njiva 4 Klase/4th Class Arable Land | 2762 |

## B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

| Të drejtat<br>Prava<br>Rights | Emri<br>Ime<br>Name | Nr. personal<br>Licni broj<br>ID. No. | Vendbanimi<br>Prebivaliste<br>Resident | Kodi postal<br>Poštanski kod<br>Postal code | Hollësitë e adresës<br>Pojedinosti adrese<br>Address details | Pjesa e pronës<br>Deo imovine<br>Share quota | Pershkrimi<br>Opis<br>Description | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor | **Komuna e Rahovecit** | 600535233 | RAHOVEC / ORAHOVAC / RAHOVEC / | | DËSHMORËT E PASHTRIKUT | 1/1 | | |

Printuar nga / Odštampani od / Printed by: Arbnor.Kabashi | P-71510057-08152-0 |

Zyrtari përgjegjës / Odgovorno lice / Official person

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

## KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : RAHOVEC
Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Rahovec

| Njësia/Jedinica/Unit | Tipi/Vrsta/Type | Sipërfaqja/Povšina/Area m² |
|---|---|---|
| P-71510057-08152-0 | Parcelë / Parcela / Parcel | 2762 |




Shkalla/Razmera/Scale: 1:733

Punoi/Obradio/Created: Albina Durguti
Nënshkrimi/Potpis/Signature:
Shënim/Beleška/Note:

Data/ Data/Date: 07.04.2025
Koha/ Vreme/ Time: 11:17:24

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Kuvendi i Komunës Rahovec***
*Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec*

---

